Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar - Primljeno Me Dat: 19-11-2026			
Nr. Protokolit Org. Broj	Numri Broj	Klasifikimi	Viera Vrednost
01-	060/01-1433		

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15, Qershor 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL), Nr 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunës, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës se Vitisë, nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **XI** të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datë **26.11.2026, (e Enjte),** duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë, në shtëpinë e kulturës, "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit Komunal.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për emërtimin e sallës së teatrit në Viti me emrin Jakup Jahiri.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm publik të paluajtshmërisë (pronës private), e cila evidentohet në emër të Afrim (Latif) Zenelit.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat në zonën kadastrale në Kabash.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2027.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-278, të datës 02.03.2026, për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**
7. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr. 013/5549, të datës 27.11.2006, për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtëshmerisë tokës në pronësi shoqërore op "Agromorava" në Viti bartësin e ri kryqi i kuq Komunal në Viti.**
8. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për heqjen e kalldrëmit ekzistues në rrugën "UÇK" dhe shtruarjen e saj me asfalt.**
9. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e memorandum mirekuptimi në mes të Komunës së Gjilanit, Kamenicës, Vitisë dhe qendrës për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve Liria Gjilan.**
10. **Rishqyrtimi i Ligjshmërisë së vendimit që vihet në shqyrtim publik Projekt Harta Zonale Komunale e Vitisë 2026–2034.**
11. **Pyetje dhe përgjigjeje.**

Viti, më 19.11.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË DHJETË TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi kryetari, z.Bekim Azizi, kryesues i seancës së Kuvendit Komunal. Mbledhja është mbajtur më 26.10.2026, (e hënë), në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar punën në orën 10:00. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu, drejtorët komunal, mediat elektronike, si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Basri Aliu, z.Ramadan Deliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Ilir Zuka, z.Ekrem Ymeri, znj.Yllka Qamili, zn.Djellza Fejzullahu, z.Sokol Shaqiri, z.Faruk Shabani, z.Bekim Azizi, z.Hajdin Ademi, z.Visar Demiri, z.Nuhi Ramadani, z.Selim Sejdiu, znj.Elsa Jahija, znj.Ardita Hajdari, zn.Mirjeta Hamiti, z.Ekrem Abazi, z.Lulzim Haxhiu, znj.Majlinda Shabani, zn.Liridona Bislimi. zn. Lindita Demelezi, z.Remzi Salihu z.Elham Emërllahu, ndërsa munguan: z.Bekim Rama, z.Labinot Bislimi, z.Jakup Demiri.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dhjetë të rregullt. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit që janë në këtë seancë, veçanërisht përshëndetje për z. Alutrim Dermaku, përfaqësues i OJQ-së GYEK, i cili e monitoron seancën, që e kemi marrëveshjen me GAP-in. Gjatë kësaj periudhe nuk kemi konfirmimin e ligjshmërisë të akteve të miratuara, të shumicës së akteve, deri më tani nuk kemi asnjë akt negativ që na është kthyer; gjatë kësaj periudhe janë 1 ose 2 vendime që janë ende në shqyrtim. Materialin e keni marrë me kohë, vazhdojmë me rend të ditës. Për pos pikave që keni marrë, i kemi 9 pika, kemi dhe një kërkesë prej Liridonës në KPF, që është kërkuar një informatë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për informatë mbi aktivitetet e realizuara gjatë muajit të ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit, tetor 2026, dhe për këtë është sjellë materiali, falënderojmë drejtorin. Domethënë, a jeni që kjo informatë të hyjë si pikë e dhjetë e rendit të ditës? Pra, e qes në votim; me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, hyn dhe kjo pikë e rendit të ditës. Pra, tani e qes në votim rendin e ditës.

R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit Komunal.**
2. **Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-shtator 2026.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e raportin për vlerësimin e dëmëve nga fatkeqësitë natyrore dhe dëmeve tjera në territorin e Komunën së Vitisë.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien e pëlqimit institucional dhe mbështetjen komunale për zhvillimin e projektit investues në fushën e teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturës së të dhënave në lokalitetin e Sllatinës, Komuna e Vitisë.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ngritjen e obeliskut "Dëshmorët dhe Martirët" e Verbanit.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vitisë 2026-2028.**
7. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nismën e Kryetarit të Komunës se Vitisë, për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunën e San Cosmo Albanese.**

8. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunën e San Cosmo Albanese.**
9. **Informatë mbi ndarjen e subvencioneve në DKRS gjatë vitit 2026.**
10. **Pyetje dhe përgjigje.**

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Hapi debat për rendin e ditës. Pasi që nuk ka për debat, a jeni që të miratohet rendi i ditës? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të dites:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit Komunal**

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë. Pra, me këto ndryshimet nga z.Ekremi, a jeni që të miratohet edhe procesverbali? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të dites:

2. **Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-shtator 2026**

zn.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasi që materialin e keni marrë me kohë, do të mundohem të bëj prezantimin në pika të shkurtura. Buxheti i aprovuar për vitin 2026 në total për të gjitha kategoritë ekonomike është 18 milionë e 792 mijë e 151.60 cent. Buxheti i alokuar për periudhën janar-shtator 2026 për të gjitha kategoritë ekonomike është 16 milionë e 760 mijë e 26 euro, ndërsa shpenzimet për të gjitha kategoritë ekonomike janë 16 milionë e 258 mijë e 876 euro. Shpenzimet për kategorinë "paga dhe shtesa" janë shpenzuar 99.99%, shpenzimet për kategorinë "mallra dhe shërbime" 95.05%, shpenzimet për "shërbime komunale" 90.94%, shpenzimet për "subvencione" 65.43% dhe shpenzimet për "investime kapitale" 96.67%. Në pasqyrat financiare i kemi të aprovuar buxhetin e aprovuar, të alokuar dhe të shpenzuar për të gjitha programet buxhetore: Zyra e Kryetarit ka shpenzuar 97.36%, Administrata dhe Personeli 96.97%, Inspekcioni 99.24%, Zyra e Kuvendit 97.94%, Buxheti dhe Financa 96.45%, Shërbimet Publike 98.30%, Zyra e Komiteteve 95.95%, Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi 39.39%, Gjeodezia dhe Kadastri 98.85%, Planifikimi Urban 97.03%, Shëndetësia 97.96%, Shërbimet Sociale 87.93%, Kultura, Rinia dhe Sporti 97.46%, Arsimi dhe Shkenca 99.42%. Të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikuara dhe të realizuara (janar-shtator 2026): të hyrat e planifikuara për vitin 2026 janë 1 milion e 294 mijë e 660, kurse të hyrat e realizuara për periudhën janar-shtator 2026 janë 1 milion e 115 mijë e 746 euro, apo në përqindje 86.18%. Krahasimi i të hyrave vetanake për periudhën janar-shtator 2026 me të hyrat janar-shtator 2025: të hyrat janar-shtator 2026 janë 1 milion e 115 mijë e 746, ndërsa më 2025 kanë qenë 1 milion e 176 mijë e 544 euro; të hyrat e vitit 2026 janë më të ulëta për 60 mijë e 797 euro. Materialin e keni marrë me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

znj.Elsa Jahija: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! E nderuar drejtoreshë, pas shqyrtimit të materialit, te pasqyrat financiare dua të ndalem tek pagesat për vendimet gjyqësore dhe mënyra se si ato janë paraqitur në raportin financiar. Për pagesën e këtyre detyrimeve janë marrë mjete nga investimet kapitale dhe kategoritë e tjera buxhetore, ndërsa pagesat figurojnë si shpenzime brenda kodeve përkatëse pa u dalluar qartë nga shpenzimet për qëllimet e planifikuara. Andaj, e konsideroj të arsyeshme të jemi të informuar se sa është shuma e paguar përmes vendimeve gjyqësore gjatë periudhës së raportimit, në cilat kode buxhetore janë marrë këto mjete dhe, nëse ka mundësi, të na paraqitni një ndarje të qartë të këtyre pagesave për të kuptuar se sa është shpenzuar realisht për investimet dhe shërbimet e planifikuara e sa për detyrimet gjyqësore. Gjithashtu, në këtë sqarim kërkoj të përfshihet edhe ndikimi në projekte dhe në shërbimet për qytetarët, nëse janë vonuar apo kanë mbetur pa u realizuar për shkak të marrjes së këtyre mjeteve dhe cilat janë ato. Kur mjetet e parapara për një projekt përdoren për pagesën e detyrimeve gjyqësore, qytetarët meritojnë të informohen qartë se sa mjete janë marrë dhe çfarë do të ndodhë me projektet që presen. Kjo ndarje mendoj se na duhet që raporti financiar të tregojë jo vetëm sa para janë shpenzuar, por edhe çfarë është realizuar me to për qytetarët.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Gjatë periudhës janar-shtator 2026 janë inkasuar 1 milion e 115 mijë e 746 euro; shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor, është 86.18%, domethënë është një shkallë e kënaqshme e inkasimit gjatë këtij 9-mujori. Ndërsa, krahasuar me periudhën janar-shtator të vitit 2025, të hyrat e vitit 2026 janë më të ulëta për 60 mijë e 797 euro; këtu ka ndikuar pak te tatimi në pronë, fakturat nuk janë shpërndarë me kohë, por kjo prapë është e kënaqshme. Dua të filloj me pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësitë buxhetore. Buxheti i shpenzuar për mallra dhe shërbime komunale: 3 milionë e 167 mijë e 764 euro. Po ndalem te disa shpenzime: transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendit, 16 mijë e 690 euro; nuk e di për këto harxhime që janë bërë vetëm transport jashtë vendit, çka ka përfituar komuna jonë? Telefonia fikse, 5.561 euro; që disa herë e kërkoj unë dhe delegatët e tjerë, këtë përgjigje kurrë nuk na e keni dhënë. Shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale, kjo është turp që jeni duke e bërë: 839 mijë euro. Shërbimet e shtypjes dhe të printimit, 48 mijë e 730 euro; për me u bë ky printim, është dashur me bë shumë punë të mëdha kjo komunë, puna është bërë pak, por shpenzimet kanë shkuar shumë të mëdha. Pajisjet e trafikut, 34 mijë e 988 euro; ku janë bërë këto pajisje, çka është bërë aty? Pajisje të tjera, 49 mijë euro. Furnizimi për zyrë, 51 mijë e 684 euro. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, 26 mijë e 136 euro. Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste, 183 mijë e 115 euro; ku janë bërë këto mirëmbajtje, vetëm një objekt që është financiar, ku p.sh. mirëmbajtja e rrugëve lokale 267 mijë euro, mirëmbajtja e orendive dhe e pajisjeve 78 mijë e 519 euro. Këtu duhet një sqarim me u dhënë: te investimet kapitale, nga 3 milionë e 561 mijë euro, 1 milion e 194 mijë e 816 janë investime kapitale, kurse pagesa sipas vendimeve gjyqësore, 1 milion e 671 mijë euro, domethënë, ju kanë marrë vetëm te investimet kapitale, pagesa gjyqësore ju kanë marrë 1 milion e 571 mijë e 220 euro. Te buxheti dhe financa, tatimi në pronë dhe tokë: janë planifikuar 47 mijë e 870 euro, janë realizuar 492 mijë e 758 euro. Te regjistrimi i automjeteve: janë planifikuar 88 mijë e 500 euro, janë realizuar 112 mijë euro; domethënë, është tejkaluar kjo, por nuk është meritu e askujt kjo, domethënë që njerëzit i kanë regjistruar veturat e tyre. Te inspekcioni: pranimi teknik i lokaleve, janë planifikuar 1.500 euro, janë realizuar 866 euro; është një shumë e vogël e realizimit. Gjobat nga inspekcioni: këtu janë planifikuar 975 euro, janë realizuar 4.100 euro; domethënë, njerëzit që duhet me qenë në terren e jo në zyrë kanë punuar kësaj here, jam i kënaqur me këto, edhe pse janë dënuar qytetarët, besoj që dënimet janë bërë me vend. Te urbanizmi: leje ndërtimi, janë planifikuar 75 mijë euro, janë realizuar 70 mijë euro; domethënë, këtu është dashur me u realizu më tepër, se ndërtim në vit është duke u bërë rend e pa rend, ligj e pa ligj, është duke u ndërtuar kush ku është duke dashtë, domethënë janë të vogla këto realizime. Taksa për leje të rrënimit: vjen mirë që kjo nuk ka figuruar para, po domethënë janë dhënë do taksa tash, 1.365 euro, një shumë simbolike, po domethënë që ka filluar edhe për rrënim me iu dhënë qytetarëve taksë me pagu, kjo është punë e mirë. Leje mjedisore: janë planifikuar 1.500 euro, janë realizuar 31 mijë e 754 euro. Prezantimi analitik i investimeve (janar-shtator 2026): rregullimi i hapësirave gjelbëruse, 57 mijë e 604 euro, dhe këtu kisha thënë me cekë vetëm një realizim ku është bërë për hapësira gjelbëruse që ka pasë një shumë më të madhe. Ndërtimi i kanalizimit, mbi 200 mijë euro, edhe këtu një sqarim, se jemi duke kërkuar përherë, kurrfarë sqarimesh nuk jeni duke dhënë. Ndërtimi i rrugëve me zhavorr, Stubëll-Stanqiq, 95 mijë euro; Remnik i Ri, Sodovinë e Çerkezve, Sllatinë e Poshtme, 100 mijë euro. Po ku janë 120 mijë euro të tjera që janë rregulluar rrugë me zhavorr, cilat rrugë janë që kanë kushtuar 120 mijë euro? Rregullimi i rrugëve me kalldrëm, 83 mijë e 320 euro; kryetari ka thënë që nuk kemi dhënë asnjë pare për këtë, duhet me dhënë përgjegjësi për këtë dikush. Asfaltimi i rrugëve rurale, 305 mijë e 476 euro; ku janë asfaltuar këto rrugë? Asfaltimi i rrugës Sllatinë e Epërme - Pozheran, lagjja e Korranëve, 30 mijë euro; kjo mirë që sa kanë shkuar për këtë asfaltim, por 300 mijë euro nuk po i dimë ku janë asfaltuar. Riparimi nëpër shkolla, 124 mijë e 400 euro; nga kjo shumë, tregoni ku është riparuar një shkollë me një shumë më të madhe, te cila shkollë p.sh. është bërë riparimi më i madh i asaj pune. Krahasimi i shpenzimeve të vitit 2026 me vitin 2025: Transport për udhëtime zyrtare jashtë vendit: në vitin 2025 kanë qenë 9.233, në vitin 2026 16.693, gati dyfish më shumë; Shërbime këshilldhënëse dhe profesionale: në vitin 2025, 412 mijë e 679 euro; në vitin 2026, 840 mijë euro, domethënë 120% më shumë; pse? Para 1 viti ka qenë vit zgjedhor, borxhi që e kanë për zgjedhje tash i kanë punësuar këto, domethënë 840 mijë i kanë shtuar për 9 muaj për këtë punë, kjo është e patolerueshme; Shërbime të shtypjes dhe printerë: në

vitin 2025, 22 mijë e 640 euro; në vitin 2026, 38 mijë, domethënë janë shtuar 130%; Derivate për automjete, gjeneratorë dhe makineri: në vitin 2025, 19 mijë e 73 euro, kurse në vitin 2026, 50 mijë euro; Regjistrimi i automjeteve: në vitin 2025, 3.700 euro, kurse në vitin 2026, 1.500 euro; domethënë, ju i keni gjysmën e automjeteve pa i regjistruar, por është fatkeqësi që kamionët e zjarrfikësve as nuk janë teknikisht në gjendje të rregullt, as nuk i keni të regjistruara ato. Është turp se çka jeni duke bërë me ata njerëz, domethënë kamionët e zjarrfikësve nuk janë të regjistruar fare, pa u siguruar fare. Kjo është më tepër se skandal.

z.Lulzim Haxhiu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket pasqyrat financiare, kolegu Ekrem pothuajse të gjitha i përfshiu këtu në diskutimin e tij, mirëpo kisha me u ndal te zyra e shëndetësisë, ku te zyra e shëndetësisë figuron mirëmbajtja e rrugëve lokale 32 mijë e 385 euro; ku kanë shkuar këto dhe ku janë mirëmbajtur këto rrugë nga zyra e shëndetësisë?

zn.Liridona Bislimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket pikës për diskutim, pasqyrat financiare për periudhën janar-shtator të vitit 2026: drejtoreshë, materialin e kemi pranuar me kohë, është e vërtetë, por tash fatkeqësisht, po më vjen keq, por mënyra e grumbullimit të materialit në formën që po na sjellni, shumë shpesh e kemi përmendur që kemi kërkuar materiale shtesë. Ne, si përfaqësues institucionalë që merremi me këtë punë gjatë, e lëre më se si e shohin qytetarët e Komunës së Vitisë, prandaj unë diskutimin po mundohem me folë sa më thjesht, jo në mënyrë me elaburu vetëm sa me qenë një prezantim formal, po du me folë ashtu siç po diskutohet prej qytetarëve tanë kjo temë për çdo ditë. Kjo për faktin se qytetari i Komunës së Vitisë që jeton këtu nuk e mat punën e komunës përmes këtyre tabelave financiare që na i keni dërguar, po e mat, po besoj, me rrugën që kalon çdo ditë, me shërbimet që i merr dhe me problemet që mbesin pa u zgjidhur e vazhdimisht po përsëriten. Tabelat financiare që kemi marrë natyrisht se ndërlidhen me problemet që po ballafaqohen qytetarët, edhe ata kanë të drejtë me ditë më detajisht se ku kanë shkuar këto shpenzime dhe çka është përfitimi prej tyre, dhe natyrisht që ju intereson edhe me ditë se qysh janë përcaktuar këto prioritete të buxhetit. Ne i dimë që mbahen diskutimet buxhetore, i kemi përmendur edhe te KPF-ja, që domethënë kërkesat që mbahen përmes diskutimeve publike, kërkesat që bëhen këtu në Kuvendin Komunal përmes neve asamblistëve, vazhdimisht janë të ripërsëritura. Po flas personalisht që jam qe 9 vite në kuvend: ka kërkesa që prej fillimit i kam kërkuar dhe ende nuk janë realizuar, prandaj është mirë me ditë se si po përcaktohen këto prioritete të buxhetit, kush i propozon, a janë konsultuar qytetarët apo asambleistët dhe a janë marrë parasysh problemet që presin me vite, apo si vendoset kjo punë, a bëhet ndonjë analizë? Sipas pasqyrave financiare që kemi marrë për periudhën janar-shtator 2026, buxheti është i ndarë mbi 16 milionë, ndërsa shpenzimet e raportuara janë 16 milionë e 225 mijë euro, që i bjen janë shpenzuar 96.99% e buxhetit. Tash, nëse e shohim përmes këtij dokumenti, përqindja duket e lartë dhe është okej, por tash pyetja që bëhet prej qytetarëve: a janë duke jetuar 96% diçka më mirë qytetarët, apo shohin ndryshim, apo si është duke ndodhur me këtë buxhet? Po du me ditë se sa projekte kanë përfunduar me kohë dhe sa janë me cilësi, sa kanë mbetur në gjysmë dhe a ka dikush që kontrollon punën e kompanive që kryhen në territorin e Komunës së Vitisë? Sepse një send është me i shpenzu paratë publike, e mandej tani tjetër send është me i shpenzu mirë dhe si duhet. Nënkryetar, gjatë debateve të fushatës elektorale, edhe në vazhdimësi gjatë prezantimeve publike të pakta që po i ka Sokol Haliti, ka përmendur investimet e donatorëve që po vijnë falë punës së tij, mirëpo në tabelën hyrëse, drejtoreshë, e kam parë që te donacionet figuron zero, ndërsa te burimet financiare për investimet kapitale figuron shumë prej 134 mijë eurosh. Kërkoj me u sqaruar ky dallim dhe, nëse bën me pasë ne këshilltarët komunalë këtë listë të donatorëve, shumën dhe projektet që janë bërë të marrëveshjeve përkatëse. Sipas këtij raporti, Zyra e Kryetarit i ka shpenzuar mbi 608 mijë euro, e prej këtyre mjeteve mbi 71 mijë euro janë regjistruar për shërbime këshilldhënëse dhe profesionale. Është me u çuditë, se i ka përfunduar 3 mandate Sokol Haliti, dhe po na duhet me ditë se çka i duhen me u shpenzu kaq shumë mjete, kush i ofron këto shërbime dhe çfarë rezultati ka marrë komuna prej këtyre këshillave, prej këtyre pagesave që i paguan njerëzit për me këshilluar kaq shumë Sokol Halitin? Nëse ban me i pasë, mirë kishte me qenë faturat edhe raportet që dëshmojnë se çfarë pune kanë kryer këto persona që kanë marrë kaq shumë mjete. Te Drejtoria e Shërbimeve Publike, në materialin financiar paraqitet shuma prej mbi 79 mijë eurosh për shërbime të veçanta, konsulentë dhe kontraktorë individualë. Nëse bën me ditë, drejtoreshë: kush është angazhuar në këtë pjesë, çfarë pune kanë kryer edhe pse është e nevojshme

me angazhu ekspertë prej jashtë? Për shembull, a ekziston kontrata dhe raportet e punës për këtë pjesë? Për shkak se po shpenzohen dhjetëra mijëra euro, po mendoj që duhet me i pasë ne, si këshilltarë komunalë, dokumentet e qarta për këtë pjesë. Nuk bën pa e përmendur rrugën e famshme në komunën tonë: rruga e shtruar me kalldrëm rreth lumit Morava. Në maj të 2024 është bërë njoftimi i fillimit të punimeve për shtrimin me kubza, i kemi diskutuar që është dhënë një shumë. Nëse bën me ditë, se kjo është pika kryesore që duajnë me ditë qytetarët, bizneset: me ditë saktë se deri tash çfarë shume është shpenzuar për ato punime që janë bërë, vlera e saktë e kontratës, e pagesave zyrtare, për shkak se gjendja e rrugës si është sot është s'më keq? Kush e ka fituar kontratën, kush i ka mbikëqyrur punimet dhe a është bërë pranimi teknik deri sa na po flasim? A ka pasur garancion të projektit dhe a i është kërkuar kompanisë për me i rregulluar këto dëmtime që janë bërë, dhe nëse po, kush ka me i paguar riparimet?

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Ju kisha lutë me qenë në temë në raportin e shpenzimeve financiare, se nuk mundet me dhënë më shumë përgjigje drejtoresha sot, sepse është materiali për raportin e shpenzimeve të pagesave që janë bërë për çdo sektor, për çdo mjet të buxhetit të Komunës së Vitisë, prej 1 janari deri më 30 shtator. Kjo është periudha që mundeni me bë pyetje; nuk mundet me dhënë drejtoresha përgjigje ku janë shpenzuar paratë e kuvendit. Kjo i ka bërë pagesat, por paratë e kuvendit ne e kemi përgjegjësinë; nuk mundet me dhënë drejtoresha përgjigje, kjo jep vetëm raport financiar që çdo pare që ka shkuar me pagu, kjo e ka paguar, se pagesat i bën Drejtoria e Financave, mirëpo informatat, raportet, shënimet i gjeni te pjesa e drejtoreshës.

z.Elham Emërllahu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Shumicën e çështjeve të cilat janë evidentuar dhe u përmendën nga kolegët, i kam evidentuar edhe unë, dhe unë personalisht e shpreh shqetësimin e njëjtë. Të gjithë jemi dëshmitarë që viti 2025, sidomos 2026, ka qenë tepër i vështirë për shkak të obligimeve të komunës për kontratën kolektive dhe pagesat për vendimet gjyqësore. Por, kur po e bëjmë krahasimin e shpenzimeve për shërbime dhe mallra në vitin 2026 me vitin 2025, pothuajse në shumicën e resorëve ka rritje gati 100% të shpenzimeve, edhe ato të cilat i përmendi baca Ekrem, por edhe këtu, të cilat unë po mundohem me i përsëritë: është mirëmbajtja e rrugëve komunale mbi 260 mijë euro. Nuk di çfarë mirëmbajtje e rrugëve; unë për vete nuk kam parë, bile sivjet çuditërisht as vijat ose zebrat e këmbësorëve nëpër qytet e lokalitete afër shkollave nuk janë shtruar. Vitet e kaluar ndodhke bile në kohë të sezonit u shtrojshin, këtë vit nuk janë bërë dhe nuk e di çfarë mirëmbajtje. Një shqetësim tjetër është edhe te telefonia mobile: më kujtohen vitin e kaluar kanë ardhur mbi 6 mijë euro, këtë vit është 14 mijë e 52 euro; nuk e di kujna ia paguan telefoninë mobile Komuna e Vitisë, sa vetë paguhen? Nëse mundesh, drejtoreshë, me na tregu pse, nëse ka mbetur borxh i vitit të kaluar është okej, por prapë është shumë. Pra, krahasimi me krejt vitin 2025: 6 mijë e diçka euro ka qenë për telefoni mobile, këtë vit është 14 mijë euro, me të vërtetë është telashe! Duke marrë parasysh gjithë qatë që e përmenda në fillim, që thashë vështirësitë financiare të komunës për shkak të përmbaruesve dhe kontratës kolektive, ne është dashur me gjetë formë të kursimit nëpër secilin resor, sepse edhe të hyrat vetanake i kemi 60 mijë euro më pak, ndërsa obligimet janë shumë më të mëdha në krahasim me vitin 2025. Edhe te kjo: shërbime mbi 800 mijë euro. Më kujtohet në vitin 2025 ka qenë mbi 500 mijë me shërbime të veçanta ose këshilldhënëse. Unë kam informata që 6 muajt e fundit një pjesë e madhe e punëtorëve që janë të angazhuar me kontrata nuk janë paguar, e që dalin në punë – edhe ata që pastrojnë, edhe ata zjarrfikësit, dhe punëtorët e tjerë – ndërkohë janë mbi 800 mijë euro për shërbime këshilldhënëse etj. A janë aty a jo, se nuk e di, prandaj ky është shqetësimi im: domethënë, këndej i kemi obligimet, këndej i kemi, me theksuar, shpenzimet për kontratën kolektive dhe për vendime gjyqësore, e këndej i kemi dyfishim të shpenzimeve.

z.Basri Aliu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë nuk do të përsëritem në këto çka i thamë, se shumicën i kemi në pasqyra financiare, ato disa vetëm u lexuan, dhe ndoshta përgjigjet drejtoresha, disa po ma merr mendja që edhe ata vetë i dinë, por po e paraqesin si pyetje. Kam edhe një vërejtje te ti, kryesues, sepse rregulloren duhet ta mbash, sepse po zgjaten dhe po përsëriten pyetjet; është mirë secili aq sa ka ta shfrytëzojë kohën e vet, që t'ju jepet mundësi edhe të tjerëve. Pasqyrat financiare paraqesin një shpenzim që tregon se është shpenzuar ai mjete, por në detaje nuk e tregon arsyen pse është shpenzuar për atë. Ne mundemi me kërkuar për secilën aty ku na intereson me ditë ku është shkuar ai shpenzim, por këto pasqyra të sivjetit nuk e paraqesin

gjendjen reale të punëve që janë kryer brenda këtij viti, por për shkak të çrregullimit buxhetor që na ka ndodhur dhe na kanë mbetur obligimet prej viteve paraprake, prandaj është ky ndryshimi i rritjeve mes vitit të kaluar dhe këtij viti. Andaj, këtu është mirë që secili prej juve është mirë ta kuptojë se çka paraqesin, bet gjithsesi duhet me marrë përgjigjen në secilën pyetje që është bërë.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Nga parafolësit dëgjuam radhazi të gjithë, të cilët në këndvështrimin e tyre e paraqitën këtë raport financiar prej janarit deri në shtator 2026, të cilët në shumicën e rasteve i përkrah dhe janë të sakta nga ato që janë thënë. U tha se edhe disa gjëra janë rritur për shkak të borxhit, dhe ne vetvetiu duhet ta kuptojmë, por ne nuk jemi Evlija ta kuptojmë se kush çka ka dashtë me thënë edhe çfarë shume ka përcjellë nga cila anë. Por për ta ditur saktësisht dhe mos me i zgjatë diskutimet, është dashur të shpjegohet, p.sh. kjo shumë ose ky borxh është bartur prej kësaj kategorie te kjo kategori, ose prej këtij viti në këtë vit, dhe ne nuk kemi nevojë të diskutojmë më tutje për këto gjëra. Por këtu po shihet një çrregullim i madh dhe dalin shifra që nuk përputhen, dhe ne duhet t'i diskutojmë ato dhe nuk duhet t'i paragjykojmë, se secili nga këndvështrimi i vet i analizon. Te prezantimi analitik i investimeve për periudhën janar-shtator 2026 dhe kur e shohim këtë tablo që na është dhënë këtu, del se te buxheti që është dhënë gjatë kësaj periudhe është 3 milionë e 656 mijë e 0.21 euro, që domethënë gjatë shikimit apo analizës që ia kam bërë unë, dhe sa kam mujtë me kuptu, sepse ndoshta duhet të kuptohet edhe mes rreshtave. Kam parë se shumica e këtyre investimeve nuk janë të këtij viti, por të bartura nga vitet paraprake, dhe investime kapitale këtë vit, mesa kam lexu, ka shumë pak, apo shumë projekte kanë filluar të realizohen. Por sido që të jetë, shuma është kjo që është, dhe nga kjo shumë, domethënë, është shpenzuar 40% për gjyqësi, shumë e cila është 1 milion e 571 mijë e 422.11 euro, kjo është marrë nga shërbimet kapitale, çka domethënë që 40% e shërbimeve kapitale kanë shkuar sikur kur ta ndezësh zjarrin me letra, po kësaj here me paratë e taksapaguesve të Vitisë! Për shkak se 50% i këtyre është paguar për avokatë, përmbarues etj., që unë mendoj se, po të kishim qenë më vigjilentë, t'i kishim marrë parasysh gjërat që janë thënë më herët, që mundemi ta gjejmë një zgjidhje që e përmendi Elhami më herët, ndoshta do të kishim mujtë me bë një planifikim më të mirë, t'i shmangemi këtyre gjërave, por situata është e tillë dhe ne veç mundemi me diskutu. Kemi pagesa gjyqësore me të cilat unë për vete, siç po i shoh dhe i kam parë, nuk mundem me u përcaktuar se ku kanë shkuar ato pare dhe për çfarë qëllimi; përafërsisht mundem me supozu, por megjithatë është dashur që secili vendim gjyqësor apo secila shumë e mjeteve që është marrë për këtë kategori të na shënohet, ta dimë për çka janë marrë apo dhënë ato të holla. Pasi që nuk janë dhënë këto, kërkoj nga drejtoresha që në mbledhjen e ardhshme të na e sjellë me shkrim për të gjitha vendimet gjyqësore se ku kanë shkuar të hollat e taksapaguesve, të qytetarëve të Komunës së Vitisë, sepse kjo është e patolerueshme.

z.Basri Aliu: Remziu e përmendi që nuk jemi Evlija për me ditë. Jo, nuk ka nevojë me qenë evlija, ne jemi duke e ditë, po e marrim shembull që çmimet çdo herë janë duke u rritur dhe aty bëhet ngritja dhe nuk përputhen viti i kaluar me këtë vit. P.sh. shpenzimet në derivate pothuajse në 100% janë rritur.

z.Remzi Salihu: Unë prapë e them që nuk jemi Evlija, dhe ndoshta mundem edhe ta kuotoj se çka është fjala, por nuk ka nevojë që unë ta arsyetoj punën që duhesh me bë ti. Prandaj unë kërkova që çdo gjë të jetë precize dhe e qartë, dhe te shuma e përmendi Basria naftën me 1.15, 1.10, me 1.90. Po nuk është 1.90, se më herët ka qenë edhe 1.50, por sido që të jetë, nëse bëjmë këtë krahasim, ne duhet ta bëjmë trefishimin e çmimit, sepse vitin e kaluar kanë qenë 19 mijë euro për naftë, kurse këtë vit janë 50 mijë.

z.Elham Emërllahu: Ndoshta është edhe detyrë e tij, por tipik LDK. Problemi është që ato që i përmenden edhe asambleistët e tjerë, por edhe unë, z.Basri, drejtoresha veç duhet me i thënë pse janë shpenzuar ose pse figurojnë 14 mijë e sa euro telefoni mobil. Unë thashë, nëse është shpenzim i vitit të kaluar, thuaje.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: As ky nuk tha mos pyet as mos me ta dhënë përgjigjen.

z.Basri Aliu: Elhami, unë nuk i bie pishman që jam LDK, për atë mburrem, për vlerat që i kam, dhe tjetërkush i vlerëson, por unë me vetveten mburrem. Unë thashë se po përsëriten pyetjet e njëjta: para 3 muajve këto pyetje kanë qenë të njëjta, prapë këto po kthehen të njëjta.

z.Ilir Zuka: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ne nuk jemi duke e ditë vendin, jemi duke i bërë pyetjet në mes vete; ne, si asambleistë, si këshilltarë komunal, jemi të obliguar me bë pyetje konkretisht tash

drejtoreshës së financave, dhe drejtoresha na përgjigjet pyetjeve që i shtrojmë. Edhe më vonë, nëse ne nuk jemi të kënaqur. Kërkojmë replikë me i kërku replikë vetes, veç te na është duke ndodhur!

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Secili ka rolin e vet dhe për këtë është kuvendi; duhet të diskutojmë, një, duhet me kuptu secili dhe ku po diskutojmë. Një pjesë të madhe dimë se çka jemi tu diskutuar: është e çrregulluar qasja e shpenzimeve në nivel vendi, në nivel komunave, këtë duhet me kuptu secili, se është në krizë çështja e menaxhimit. Po ju garantoj, të premten kam shkuar te zyra kryesore financiare, te Berati, nuk ka qasje, as nuk e di, sepse i kanë të mbyllura për shkak të kërkesave që me kryer disa obligime gjyqësore që iu kanë. As ai nuk e di, se shkova me i kqyr sa pare të kuvendit na kanë mbetur, nuk e hap sistemi, dhe ky është sistemi që është duke funksionuar në vendin tonë. Ndërsa shpenzimet bëhen gjatë planifikimit që kemi me miratuar në kuvend, nuk mundet ndryshe; tash ai planifikim është çrregulluar duke i marrë paratë gjyqësori. Tash, qysh mundet me i gjetë tash krejt këto që i bëni pyetjet, janë normale që duhet me i sqaru sfidat që i kanë pasur.

zn.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Elsa, për vitin 2026 mjetet janë ekzekutuar prej përmbaruesit, domethënë prej thesarit, 2 milionë e 151 mijë e 890 euro. Për sa u përket mallrave, subvencioneve, shërbimeve, për momentin nuk i kam, por ndërkohë mundem me ta dhënë përgjigjen edhe me shkrim. Liridona, një përgjigje prej KPF-së: pse nuk janë alokuar të gjitha mjetet e aprovuara? Alokimi i buxhetit është në bazë mujore për të gjitha kategoritë ekonomike nga grandi, andaj alokimi është vetëm për 9-mujorin; shumat e mbetura do të alokohen për muajt e ardhshëm. Subvencionet: pse janë vetëm 65%? Këtu, sa u përket subvencioneve në bujqësi, janë në fazat e përfundimit të procedurave, andaj kjo përqindje rritet sipas shpenzimeve, dhe drejtori jep një sqarim: a janë kryer procedurat që i kanë pasur apo jo? Ekrem Abazi, 13.509 janë shpenzuar për pajisje, furnizim nëpër shkolla, drejtori të tjera, dhe këtu ka hyrë edhe ndriçimi i dekorimit të qytetit, andaj edhe rritet shkaku i saj. Dhe këtu nëpër të gjitha shkollat furnizohen në këtë kod; krejt hynë rrezet, çka prishen këto pajisjet e imta, dhe për këto janë rritur, se janë shumë shkolla dhe drejtori të tjera, çka do që prishet nëpër shëndetësi që çdo ditë është e pamundur mos me u orish diqka, mos mu riparu. Mirëmbajtja e rrugëve lokale në shëndetësi: neve na duhet nganjëherë për shkak se struktura buxhetore është prishur nga kontrata kolektive dhe po na duhet me patjetër me bë rrotacione brenda për brenda, dhe ne kemi shfrytëzuar – në muajin e kaluar ka ndodhur që kemi marrë prej shëndetësisë çdo mjet, por drejtoritë brenda për brenda kemi të drejtë me thënë: "Ma jep kaq, t'ia jap kaq", për mos me mbetur të bllokuar aty, i kemi me prioritet. Edhe për tatimin në pronë, shefin e tatimit në pronë e kemi këtu, që do ta jepë një sqarim. Sa i kemi obligime për vitin 2026, janar-shtator? Deri më tani: Mallra dhe shërbime: 783 mijë e 493; Komunale: 17 milionë e 518 mijë *(vërejtje: shifra e thënë në fjalim);* Subvencione: 15 mijë e 603 euro; Kapitale: 820 mijë. Ta sqaroj edhe këtë: këto obligime i kemi të raportuara deri më tani në thesar, mirëpo pasi që është 9-mujor, deri në muajin dhjetor nuk janë definitive dhe të sigurta, për arsye se është vetëm 9-mujorshi. Remzi Salihu, të premten kemi mbajtë një takim Bordi i Drejtorëve me thesarin. Kemi mbajtë një takim se është e pamundur: para 2 vitesh na janë dhënë kopje fizike të përmbaruesve që kemi mujtur ne me i marrë, me i kompletu dhe me i pa, kush çka ka marrë, ata çka kemi ekzekutuar ne. Mirëpo, prej vitit të kaluar kemi pasur problem edhe me auditorin, që nuk na kanë dhënë dhe nuk kemi qasje, mirëpo na kanë premtuar që javën e ardhshme kanë me na e lëshuar një linjë, kur të bëjmë ne te shpenzimi, aty kemi me pasur një qasje ku kanë me na e skanu kur i çojnë te zyra ligjore e vetja, që ne veç me i pa të gjitha, dhe aty i definojmë se çka kanë marrë, ku jemi dhe sa obligime i kemi. Deri më tani nuk kemi mundësi me i definu; në momentin që na e lejojnë këtë qasje, unë e sjell në kuvend, një nga një i sqaroj të gjitha. Ne, si Drejtori e Financave, jemi të obliguar veç me i përgatitur raportet financiare dhe transferet, ndërsa arsyetimet për shpenzimet janë drejtpërdrejt drejtorët e drejtorive, por janë edhe autorizuesit e buxhetit, përkatësisht drejtoritë e veta.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Opozitën e dimë që ka obligim me i ngritë çështjet, megjithatë ne duhet ta thejmë të vërtetën, e vërteta është në pasqyrat financiare. Pasqyra financiare është një format që është i unifikuar në nivel komunash të Republikës së Kosovës, që paraqet një çështje financiare e cila ka ndodhur në kohë të caktuar dhe është kryer pagesa e saj. Prandaj, si e tillë, unë besoj se e plotëson atë standardin, se çdo pasqyrë financiare i nënshtrohet auditorit të jashtëm dhe

kurrë asnjë vërejtje në drejtim të saj nuk kemi pasur. Nga pasqyrat financiare mund të pasojnë pyetje dhe kërkim i materialit shtesë në sqarim. Po, është e drejta juaja, por pasqyrat financiare si standard e plotësojnë. Ekremi i shtroi disa çështje, të cilat tha: shërbimet këshilldhënëse, dyfishime të pagesave, shtypja me printer, derivatet e të tjera. Basriu në disa u mundua me i sqaru, që është edhe çështja e lëvizshmërisë së çmimeve, por te shërbimet këshilldhënëse është edhe ngritja e pagesave, por edhe numri më i madh i punëtorëve. Te këto shërbime bën pjesë kontrata me Caritasin dhe Kosovamedin, dhe me punëtorët që e pastrojnë qytetin. Ekremi tha: "A i di cilat rrugë, cilat janë asfaltuar" Ndoshta krejt jo, por dy të cilat i di janë edhe çështja e rrugës te shkronjat UCK në Radivojc dhe rruga te pritorja në Smirë, por ka edhe të tjera që nuk mundet me i mbajt në mend cilat janë shtruar. E kam fjalën brenda vitit 2025. Ndërsa për Lulin iu përgjigj drejtoresha për marrjen e parave në mes të drejtorive. Marrja e parave, një realitet që po e jetojmë, është që buxhetin të cilin e keni aprovuar ju dhe e ka propozuar kryetari i komunës, lirisht nuk po kemi mundësi me e realizuar. Mua më është bërë monoton me kontratën kolektive, por burimi i të keqes është kontrata kolektive; tash edhe operatorët ekonomikë kanë me qenë ata të cilët kanë me e realizuar të drejtën e vet përmes gjykatës. Liridona kërkoi material shtesë. E drejta e jotja me u obligu; obligim i drejtorëve është me e sjellë, por duhet saktë se çka kërkon, dhe besoj që kanë me e sjellë. Kush i cakton prioritetet? Prioritetet i cakton kryetari, i merr edhe nga dëgjimet me qytetarët, merr edhe programin e vet dhe të gjitha, dhe u jep prioritete, dhe ju i aprovoni këtu në kuvend. Dhe thua një pyetje që është shumë konfuze: thua 96% e keni harxhuar buxhetin e investimeve kapitale, e është përmirësuar mirëqenia e qytetarëve. Unë besoj në çdo projekt mirëqenia e qytetarëve përmirësohet, por mjerimi më i madh është se te ky 96%, pjesa dërrmuese është ekzekutim që kanë rënë në kategorinë e investimeve kapitale, por që është nga thesari dhe që kanë shkuar në xhepa individualë të individëve! Dhe aty unë besoj e kanë përmirësuar mirëqenien sociale, por individualisht, jo kolektivisht. Dhe pyetja tjetër: sa punë janë kryer dhe cila është cilësia e saj? Nuk është obligim i drejtoreshës, për cilësi janë ekspertë të tjerë, komisioni që caktohet, që e vlerëson cilësinë, dhe janë ekipe profesionale; drejtoresha përgjigjet për pasqyra financiare, sa është paguar dhe a ka obligime. Rruga e famshme me kalldrëm, thua: "A ka pasur garancion". Po, ka pasur. "A ka pranim teknik?" Jo, kompania zbatuese, Kushtrimi N.M. Shërbime dhe mallra: Elhami thotë është dyfishim. Edhe duke e pasur parasysh, Elham, edhe rritjen e kostos, besoj edhe të kontratës edhe të shërbimeve të kryera, ndoshta mund të jetë edhe ndonjë faturë e vitit 2025 e ekzekutuar në 2026, që mundet me e rritë atë shumë të mjeteve. Gjithashtu besoj edhe te telefonia mobile e kemi edhe drejtorin, po besoj që e njëjta çështje është. Është një realitet që kemi ngecur edhe në pagesën e kontratave që kemi; tash nuk e di sa muaj jemi, por jemi mbrapa.

zn.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Elham, te pyetja për telefonat mobilë dhe për tatimin në pronë u adresova te drejtori, besoj që është në ngjarje, më mirë e dine, edhe e kemi shefin e tatimit në pronë, që është duke dashur me dhënë një sqarim, se janë më të ulëta se vitin e kaluar.

z.Arton Musliu, drejtor: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket shpenzimeve për telefoni mobile, unë mundem me folë veç për periudhën për të cilën jam përgjegjës, prej muajit shkurt të vitit 2026 deri më tani, dhe mundem me ju thënë që shpenzimet e telefonisë mobile janë përgjysmuar, nuk janë dyfishuar, por janë përgjysmuar! Edhe deri sa unë jam drejtor aty, ky shpenzim që është përgjysmuar ka me vazhduar deri në vitin 2029, dhe përllogaritjet janë që diku rreth 50 mijë euro kursehen prej këtu, që i kemi bërë bashkë me kryetarin e komunës.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Këtë e kemi diskutuar më herët: që te telefonia mobile hyn edhe çështja e internetit në shkolla; janë disa pjesë të internetit që hyjnë te kjo mobile.

z.Xhelal Veseli, tatimi në pronë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Gjatë këtij raportimi të shkurtër do t'ju njoftoj për ecurinë e inkasimit të tatimit në pronë. Është e vërtetë që vitin e kaluar kemi pasur 72 mijë euro më shumë, për arsye se ka qenë një faktor i cili: kemi udhëhequr procedurat për bllokimin e llogarive bankare sipas ligjit në fuqi, dhe ajo ka rezultuar të jetë inkasimi më i lartë se ky vit. Gjatë këtij viti, në bashkëpunim me drejtoreshën, nënkryetarin e të gjithë, i kemi përgatitur diku 171 lëndë për t'u vendosur barra tatimore mbi parcelat e të cilave nuk i kanë shlyer obligimet e tyre, dhe besoj shumë se në fund të vitit do të arrijmë qëllimin që 100% ta realizojmë planin. Kjo është mangësia që neve na ka munguar. Në fund, e

shfrytëzoj rastin përmes këtij kuvendi t'i thërras të gjithë qytetarët t'i shlyejnë borxhet ndaj tatimit në pronë, për arsye se ka ndëshkime, bllokim të llogarive, si kamata, dënime etj., dhe njëkohësisht kërkoj nga ju që të bëni të njëjtën thirrje, ta përkrahni këtë pjesë, se është për të mirën e qytetarëve, për të mirën e komunës, sepse tatimi në pronë është hyra vetanake kryesore e cila shfrytëzohet më së shumti për infrastrukturë, shkolla, çerdhe etj.

z.Ekrem Abazi: Xhelal, kush e ka obligim me i shpërnda faturat e tatimit në pronë? Po e përmendi lagjen time, që asnjë faturë askush nuk e ka shpërndarë; ajo është obligim që paguhen për me i shpërnda faturat nëpër shtëpi.

z.Xhelal Veseli, tatimi në pronë: Është kontrata e cila bëhet mes komunës dhe Postës së Kosovës, dhe ata e kanë obligim me e pru gjithsecilit faturën me kohë. Po, në këtë vit kemi pasur vonesa për shkak se kanë qenë disa probleme në Departamentin e Tatimit në Pronë, mirëpo gjithsesi fatura duhet me ardhur, sepse paguhet për çdo gjë që qytetarit me i shku te shtëpia.

z.Ekrem Abazi: Jam i pakënaqur me përgjigjen që keni dhënë, edhe drejtoresha edhe nënkryetari. Po më habit fakti: shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale me u paguar punëtorët e pastrimit. Diçka te unë nuk është e kuptueshme kjo punë! Edhe sa punëtorë i paguani prej shërbimeve kontraktuese dhe këshilldhënëse, dhe ku janë ata punëtorë, cilët punëtorë janë? Domethënë, këtu janë 840 mijë euro me Caritasin dhe Kosovamedin; këtu janë njerëz që i paguani vetëm për interesa të juaja personale që keni pasur obligime gjatë vitit 2025 për zgjedhje, dhe ato nuk keni arritur t'i kryeni ato obligime. Unë e shoh këtë si dobësim të buxhetit, harxhim të buxhetit total palidhje. Po më vjen shumë keq prej këtyre qytetarëve, të rinj e të reja që janë punësuar e shkojnë një kohë të gjatë, që është veç një humbje kohe, se nuk kanë bë zgjidhje familjare fare me këto kontrata që i kanë bërë, por vetëm ndikon negativisht te këta të rinj e të reja! I kisha lutur që mos me u marrë me këso punë, se veç kanë me dalë fajtorë, i bëjnë dëm veç vetvetes, jo tjetër kujt.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Fatmirësisht, Ekrem, që jemi në taborre të kundërta: bëjmë keq a bëjmë mirë, ne kemi një çati që thirret LDK. Ky model është i një subjekti politik i cili e ka zgjedhur, e ka votu populli, e ka zgjedhur këtë model të udhëheqjes, të inkuadrimit të njerëzve, të punësimit të njerëzve. A është i mirë apo i keq, ti mos e vra mendjen! Që tu, Ekrem, më vjen keq, ato nuk t'i përmendi, por që tu bëjnë shumë pjesë njerëz të cilët kanë kryer shërbime ndoshta edhe në shtëpinë time edhe në shtëpinë tande, e ti sot e përmend? Ka shumë të cilëri që ka nevojë vetë QKMF-ja sot: po të mos ekzistonte Caritasi, nuk mundet me eksistu. Unë i besoj profesionalizmit të njerëzve të cilët i kam pyetur, dhe nuk mundet me funksionu pa këta punëtorë. Prandaj, çfarë të keqe ka aty? Unë e di që ndoshta nuk të pëlqejnë këto senet, por realiteti është ky.

z.Elham Emërllahu: Me të vërtetë po më vjen keq, edhe shumë qesharak dolën dy drejtorët e drejtoresha e financave: bëjnë një raport si shpenzim 14 mijë e 52 euro shpenzime të telefonisë mobile. Thotë: "Për këtë njofton drejtori i shërbimeve publike". Flet drejtori, thotë: "I kam kursuar, domethënë jam munduar me i kursu", dhe thotë: "I kam kursuar 50 mijë euro". Ti duhesh me ditë sa i ki shpenzimet në 2025, sa i ke pasur shpenzimet e telefonisë mobile të 2025, sa i ke në 2026; nuk mundesh me folë nëse ke kursu në çështje të tjera 50 mijë euro është okej, ta jap dorën. Por në telefoni mobile i paske kursu 50 mijë euro, nuk po e di qysh! Pra, përgjigje nuk morëm: pse është ky shpenzim 14 mijë e 52 euro për janar-shtator 2026 i telefonisë mobile?

z.Arton Musliu, drejtor: I nderuar këshilltar komunal Emërllahu, unë ta shpjegova një herë, edhe nuk e di qysh duhet me ta shpjeguar ndryshe: ose ti nuk je duke marrë vesh, ose unë nuk jam duke ditë me ta shpjeguar. Kështu është puna: prej shkurtit 2026, kur unë e kam marrë detyrën e drejtorit të Shërbimeve Publike, shërbimet e telefonisë mobile janë përgjysmuar. Nëse nuk del kështu, unë, në momentin e parë që vërtetohet e kundërta – raportet qysh janë bërë, unë nuk e di, se s'jam drejtor i financave edhe nuk du me hy anej, por te shpenzimet e telefonisë mobile, nëse nuk janë përgjysmuar edhe nëse nuk kursehen rreth 50 mijë euro në fund të mandatit rreth këtyre shpenzimeve, unë jam dorëheqje automatike! Nëse do me vërtetu, atëherë bëje kërkesën për qasje në dokumente publike, edhe ki me marrë vesh ti, këshilltarët komunalë dhe krejt qytetarët e Komunës së Vitisë.

z.Elham Emërllahu: Përime, nuk jam duke e kuptuar: nëse ne i kemi shpenzuar 50 mijë euro në vit për telefoni mobile, kjo është skandal! As për 4 vite nuk mundet. Jo, nuk është duke ditur, ja ka moskoordinim me drejtoreshën e financave. Të lutem, le të më thotë pse ka ardhur ky shpenzim 14 mijë euro i telefonisë mobile.

A është i vitit të kaluar? Përse, drejtor, vitin e kaluar janë mbi 6 mijë euro, nuk ka më shumë telefoni mobile, ti po thua 50 mijë euro? Domethënë, kjo nuk qëndron absolutisht.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Elham për një buxhet 18 milionë Komunës së Vitisë ose 16 milionë shpenzime, ti je tu u kapë për një vlerë që është shpenzim si postë. Një, po të them: te rryma, te uji, është shërbimi që t'u ka kry, ke me pagu qëta që t'u ka kry. Nëse nuk e ke pagu me kohë, t'u ka mbledh borgji, e ke pagu tash. Atë nuk mundesh me e keqpërdor, se atë që e ke shpenzu ki me e pagu, se ajo është elektronike. Me siguri është një pjesë e borgjit që është pagu prej vitit të kaluar; e ke pasur me siguri në janar, kur kanë ardhur shpenzimet e vitit të kaluar, ka mujt me u përcjell borgji.

z.Elham Emërllahu: Veq në ta thotë drejtoresha dhe është mirë me pa ne si asambleist qat listë të zyrtarëve të komunës, kush është që paguan komuna telefonin mobil. Sa zyrtarë komunalë komuna ua paguan telefonin mobil mujore?

z.Basri Aliu: Dua me e japë një sqarim, pasi që kam qenë në atë dikaster: realisht ka borgje të vitit të kaluar, sepse vetë kam qenë aty dhe kanë mbetur faturat pa u kry. Sigurisht drejtori po thotë shpenzimet janë zvogëlu, për shkak se sigurisht kryetari ka bërë një kontratë tjetër që ka qenë më e ulët se kjo, ose vala i ka zbritur çmimet, kështu që edhe ajo është e mundshme.

zn.Liridona Bislimi: Po më vjen keq që po duhet me u përsërit diskutimet që po mbahen, po kërkoj sqarime për një temë që diskutohet një herë e vetme. Shembull, për pasqyrat financiare janar-shtator 2026, kjo temë më nuk kthehet këtu në Kuvend Komunal, po hapim pika që rrjedhin prej temës. Kërkohet që mos me u zgjeru, që mos me u diskutu shumë, për neve si përfaqësues të qytetarëve që mbajmë një seancë të vetme brenda muajit, dhe në fund përgjigjet që marrim janë në formë të përzier, absolut asnjëherë nuk ka ndodh me pas një përgjigje të qartë. Ajo çka na jemi të thirrur prej qytetarëve është që kërkesat e tyre me i dërgu, pyetjet që i kanë, vërejtjet. Është shumë e thjeshtë: nënkryetar, ta zëmë shembull, që nuk mundet me dhënë drejtoresha për këto pyetje që iu bëra, po unë mendoj që drejtoresha përfaqëson një prej drejtorive më të rëndësishme të nivelit ekzekutiv dhe mendoj që ka komunikim të vazhdueshëm me zyrën e projekteve dhe e ka për obligim që neve me na e sjellë informacionet që i kërkojmë. Unë nuk dua me hy në detaje tjera për secilin fshat, po të garantoj, nuk besoj që është mbajt prej mandatit të parë një diskutim publik me një fshat, po qoftë edhe në qendër të qytetit, që nuk është kërku prej qytetarit të Vitisë për me u furnizu me ujë të pijshëm, dhe ende nuk e eke... Tash unë e pata rastin konkret këtu: këto prioritete që po vendosen tash, përderisa për 9 vite e ke një kërkesë të njëjtë dhe ajo nuk realizohet, dhe prap shkon hap debate, qysh e ka përmend edhe kolegu Ilir në komitet, ne veq po shkojmë po i marrim kërkesat, po i dërgojmë, por përgjigje nuk kemi. Kjo ka qenë interesi jem, që po na pyesin dhe qytetarët: a merret parasysh fjala e tyre? Unë po të kuptoj që po thu i ka vendos kryetari, po në rregull, nuk domethënë tash që ka fitu, edhe krejt mënyrë shabllone duhet me shku në këtë formë. Po më vjen shumë keq, edhe ne jemi të zgjedhurit e dikujt, edhe ke fitu për shumë pak vota, ka qenë diferenca, duhesh me mendu që është një diferencë e madhe që nuk ta preferojnë atë plan-program. Edhe ne jemi përfaqësues të tyre. Tash pjesa e problemit te Lumi i Moravës, unë nuk mendoj që duhet me u kalu kaq lehtë, ndoshta më mirë është me pas një përgjigje se cili është hapi konkret që keni me bë: a kanë me u largu ato kubza a jo? I keni marrë në qafë bizneset komplet, njerëzit që kalojnë aty, dhe tash është shqetësim që për çdo ditë i prek qytetarët, edhe vij unë e hapi si temë diskutimi edhe ti veq thu që nuk ka pranim teknik, kjo kompani e ka shty dhe me qekaq kryhet. Po na po dojmë me ditë më shumë: pse ka ardh deri këtu problemi? E keni një zyrë të projekteve, i keni do njerëz që po i përmendim ne që marrin paga të vazhdueshme, a kanë dalë në terren, a është bërë një analizë? Se kohë keni thënë që kanë me u largu kubzat, dëgjojnë qytetarët që nuk kanë me u largu, ka me u bë rishtrimi. E keni hap tash, çka keni shti në ato kanale gypin? Është bërë më tmerr se që ka qenë, tash veq thu "nuk ka pranim teknik" dhe "filan kompani është tu e kry". Po çka më tutje? Edhe një herë, në muaj kemi një seancë, jemi tu diskutu me një pikë që më nuk vjen, edhe e ka kritika që po e zgjasni shumë. Jemi prej komunave që shumë shpejt i kryejmë seancat e Kuvendit.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Jemi prej kuvendeve komunale që më së shumti diskutoni, kqyrni ku dush! Unë jam prej kryesuesve që kurrë nuk ju kam kufizu për të gjitha çështjet, bile kam pasë kërkesë prej kolegëve tuaj me respektu rregulloren. Kjo pjesa e Kuvendit varet prej meje, pjesa e përgjigjeve prej

ekzekutivit, se i kemi përgjegjësitë e ndara. Unë jam pjesë e juaja, se unë jam njeri prej jush që e kam përgjegjësinë me i udhëheq seancat e Kuvendit në bazë të rregulloreve. Tash, në kuadër të krejt respekteve, kemi mundësi me diskutu, se e dimë që për 3 minuta nuk kemi mundësi me i kry diskutimet, mirëpo kemi mirëkuptim. Te çështja e kubzave: Kuvendi ka marrë një vendim-rekomandim që me u heqë kubzat. Në buxhet e kemi miratu, e kemi nda për me u shtru asfalt, jo kubza, dhe ne presim që në vitin e ardhshëm duhet me u heqë kubzat, me u shtru asfalt në bazë të miratimit të buxhetit.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Për habi, më vjen shumë keq. Për politikë je e ngarkume fund e krye, ti ke bë thirrje edhe për smundejen e deleve, nuk ju drejtove aty ku duhet me u drejtu, në ministri, po nuk po himë aty. Veç një çështje po ta them: nuk ka përgjigje më të saktë kur thu "a ka pasë garancion?", thamë "po". Unë mundem me fol gjashtë javë ditë, bëhesh monoton këtu, edhe për garancion: dëgjo, a ka pasë pranim teknik? Unë them "jo", është e saktë, dhe cila kompani? Ke pyet, ka qenë implementuese, të them: Kushtrimi, në çfarë përgjigje po don tjetër? Përgjigjja tjetër: tash po du edhe unë me u zgjeru, me të thanë saktësinë. Ti po thu, ama arsyeshmërinë me projektin i cili është realizu te kubzat, nuk kemi qenë të kënaqur ne si ekzekutiv, e di që nuk keni qenë të kënaqur edhe ju, edhe qytetarët. Është kërku me përmisu në bazë të standardeve dhe kontratës që ka pasë. Ndërkohë, ka dalë një pjesë e qytetarëve që jetojnë aty, me nënshkrime i janë drejtuar edhe Kuvendit, kanë qenë, kanë biseduar edhe me neve dhe ne kemi ardhur në përfundim mos me u përmisu. Masi paska kaluar ai projekt i cili ti po thu, nuk e di çka keni bë: është heqë gypi i azbestit, që është vendos gypi më cilësor i mundshëm për ujë të pijshëm në atë pjesë, dhe është realizu ajo çështje. Tjetër që po doni: kemi formu dhe komision, vendim, të cilët kanë me dalë me bë prerjen e punëve për punët të cilat i ka kry dhe për ato të cilat nuk i ka kry, dhe me kalkulu shndërrimin në asfalt. Vendimi-rekomandimi është marrë nga ana e juaj, është sugjeru jo përmirësim i kubzave, po Kuvendi ka rekomandu ekzekutivin për me shtru asfalt. Në takimin e fundit të Bordit të Drejtorëve që kemi mbajt, kemi caktuar edhe komisionin me dalë me bë prerjen, me kalkulu, me ia llogarit atij kubzat. Në rast se punën nuk e ka bë cilësore, kubzat i ka ble, i ka pru, që mundet me i shti diku tjetër, me i përdor, dhe me shpall tenderin për me shtru asfalt. Ka qenë rekomandim i juaji, po ti në këtë drejtim nuk pyet, se unë mundem sadush me tu përgjigj. Këto nuk jam që nuk i di, që nuk jam përgatit. Po thu "kush po i cakton prioritetet?". Nuk është me rëndësi, Liridonë, nuk është me rëndësi, veç një votë e përcakton fituesin, dhe programi, strategjia e fituesit harmonizohet me partnerin e koalicionit, por jo edhe me ata të cilët kanë qenë konkurrentë dhe që nuk janë. Tash unë thashë shumë sinqertë: gjithherë kryetarit i shkon raporti të cilin e formon komisioni për dëgjime buxhetore, që mjerisht këtu dalin pak dhe i shton kërkesat e qytetarëve të cilët kanë dalë nga tubimet me qytetarë, e ka dhe strategjinë e vetë dhe të partnerit të koalicionit, dhe tash në pamundësi të futjes së gjithë atyre, iu jepet prioritet atyre projekteve të cilët konsideron që janë më të domosdoshme. Kështu ishte përgjigjja, nuk ka përgjigje tjetër. E shtrove çështjen e ujit të pijes: është duke u punuar në atë drejtim pa ndërpre, është duke u punu tash, kjo vonesë ndoshta e shumë fshatrave që janë në përfundim të realizimit të projektit për me pasë ujë të pijshëm. Është burimi i vetëm që na po e thirrim. Edhe kontrata kolektive: tash po të tregoj se kontratës kolektive jemi në gjyq para dy viteve. Kur e kemi bë padinë, ne si komunë e Vitisë, vlera në padi ka qenë veç 1 mijë e 500 euro; tash po ta dokumentoj, e nderuar, që kjo ka shku vetëm kontrata kolektive, na ka marrë 10 milionë e 212 mijë euro. Me këto pare besoj që 80% e popullatës së Vitisë ishin të mbuluar me ujë të pijshëm, andaj duhet ta shikojmë edhe në këtë sfond. Megjithatë, kjo ka ndodh jo vetëm për Vitinë, por në përgjithësi në komunat e Kosovës, por ne kemi bë padinë, jemi në gjykatë. Tash qysh të vendos për komuna tjera, kanë me vendos edhe për komunën e Vitisë, besoj se është e njëjta problematikë. A kemi mujt ndoshta me bë ndonjë formulë më të mirë me dalë prej kësaj situate? Tentimet tona kanë qenë, binduni që ka pasë prej kuvendarëve në atë mandat kur është kërku prej neve me hap një kod buxhetor me i shly, kanë thënë "nuk mundeni". E tash vetmja që ka mujt me pasë qenë pak më vigjilent mes gjykatës dhe përmbaruesve, me lidhë një marrëveshje gjyqësore dhe ekzekutimet me i bë, këtë ndoshta ka mujt, se e ka bë Peja në këtë formë. Përndryshe tjetër shpëtim nuk ke pasë prej kësaj, se çdo marrëveshje e nënshkruar nga palët është ligj, dhe nuk e kemi nënshkru, e ka nënshkru Qeveria, por megjithatë ai ligj na obligon edhe neve me e zbatu.

z.Basri Aliu: Unë qëndroj pas asaj që të zbatohet rregullorja, sepse këtu edhe shfrytëzohet për me diskutu pak kohë edhe prap jemi prap kështu. Andaj thashë që të zbatohet rregullorja si në Kuvendin e Kosovës: a e ke pa atje? Veç ia ndalë edhe më nuk ia jep fjalën, edhe këta vetë kanë me e respektu.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Kjo pikë nuk votohet, pasi që është veç informatë, edhe jashtë Kuvendit për çdo informatë që keni interes bën me shkru ndonjë e-mail te Drejtoria e Financave, e kanë për obligim me jua kthy informatat që ju vyejnë.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Raportin për vlerësimin e dëmëve nga fatkeqësitë natyrore dhe dëmeve tjera në territorin e Komunës së Vitisë**

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Kemi një propozim vendim, një raport të komisionit. Hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Komisioni që është formuar për vlerësimin e dëmeve ka qenë miks, i përzier. Edhe dy rastet e fundit që kanë qenë dy stuhive të fundit, komisioni i ka operuar ato, po kemi pasë një rast e cila ka ndodh para këtyre, që ka qenë ai vërshimi që ka ardhur prej fshatrave Zllatar, Dardani etj., e që iu ka rrënuar shtëpi. Prandaj, i vetmi që nuk ka hyrë në atë raport i cili ka ardhur në Kuvendin e kaluar është ky rasti, dhe e kemi prurë këtë tash që në mënyrë komisioni me ia bashkangjit si material me e dërgu Qeverisë, që sipas informacioneve të mbrëmshme e kishin në mend me i kompenzu, që do të ishte një ndihmesë e të gjithë atyre që kanë pësuar në nivel të Kosovës.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Ne e dimë që vlerësimin e dëmeve vendimi i Kuvendit i dërgohet Qeverisë së Kosovës për emergjenca. Ne kemi miratuar për dëmet në bujqësi që kanë ndodhur me njëren fatkeqësi, me njëren kemi... edhe një pjesë të pavlerësuar të dëmeve në fatkeqësinë e dytë, apo janë kry krejt? Por ky rasti është i veçantë, ky është para fatkeqësisë së parë që kanë qenë. Kemi edhe familjarë këtu që kanë ardhur me dëgju në këtë rast: e keni materialin të gjithë me fotografi dhe dëmet që janë bërë.

z.Basri Aliu: Në emër të grupit të LDK-së, ne e përkrahim që të futet edhe kjo pikë, dhe na vjen keq që ka mbetur më vonë.

z.Elham Emërllahu: Te çështja e rastit në fjalë, unë personalisht kam taku pronarin e shtëpisë dhe nuk kam pas boll informatë të mjaftueshme se pse nuk ka ardhur në raportin që kemi miratuar në seancën e kaluar. Sidoqoftë, rasti është i rëndë dhe shpresoj që ka me u futë bashkë me atë raport ose me ndonjë raport të veçantë, që niveli qendror me e kompenzu, se shtëpia e tij është e pabanueshme dhe është rasti i rëndë. Uroj që të kompenzohet.

zn.Liridona Bislimi: Siç edhe jemi të njoftuar të gjithë prej dëmeve të shkaktuara prej korrikut të vitit 2026, kanë prekur drejtpërdrejt jetën e qytetarëve dhe mirëqenien e shumë të tyre. Mirëpo, si e përmende dhe ju, Elham, ky është rast më specifik. Kemi qenë të njoftum për këtë rast si familje që e ka preket, andaj është shumë e rëndësishme që si institucion me reagu me kohë dhe me bë gjithçka që organet kompetente me e kry sa më shpejt punën e tyre. Prej dokumentacionit që kemi pa, komisioni e ka kry vlerësimin e dëmeve, domethënë me kuotën e ndërtimit dhe me inventarët e pajisjet e shtëpisë, dhe kemi parë vlerën e përgjithshme. Unë e kuptoj që përmes këtij vendimi synohet që dokumentacioni me u procesu te ministria përkatëse për shqyrtimin e kërkesës dhe mbështetjen financiare. Nuk duhet me harru që pas këtyre shifrave kemi një familje që ka pësuar për dëmet dhe pret mbështetje konkrete nga institucionet. Andaj, nënkryetar, si përfaqësues për këtë arsye kërkoj që, natyrisht përpos edhe miratimit të projektit, me pasë edhe informacione të vazhdueshme dhe të qarta për pjesën e financimit, afatin e realizimit dhe mbikëqyrjen e projektit, që besoj që ka me u bë edhe prej anës së juaj.

z.Ekrem Abazi: Ky propozim-vendim besoj që duhet të përkrahet nga të gjithë, por kisha një kërkesë: a ka ndonjë rast tjetër sikur këtij rasti, për shtëpinë e pabanueshme, që gjatë vërshimeve i është bërë shtëpia e pabanueshme dhe ai duhet me bë zgjidhje? Dhe nëse ka, a jeni mundu me ju bë zgjidhje, bile banim të përkohshëm?

z.Naim Pira, drejtori: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Meqenëse në seancën e kaluar keni miratuar një raport të vlerësimit të dëmeve të punuar nga ana e komisionit, i cili ka bërë një punë jashtëzakonisht vëllimore, por për shkak se ka shumë lëndë dhe ndonjëherë mundet me t'u përvjedh ndonjë gabim – dhe një nga ato ka ndodhur me një fermer, të cilin nuk ia kanë vlerësuar dëmin në kulturën e pjeprit, diku 37 ari.Andaj, meqë komisioni është i njëjtë, unë kisha dashtë që edhe këtë vlerë të këtij dëmi ta përfshijmë në kuadër të këtij vendimi. Por është në pyetje vlera prej 5,121.91 euro. Kisha dashtë mirëkuptimin tuaj, sepse fermeri, kur është bërë publike lista, e ka pa dhe na ka ardhur, edhe komisioni më vonë e ka pa që e kanë harruar dhe iu ka shmangur me e përfshi këtë, se kanë qenë në pyetje 150 fermerë, pothuajse edhe parcela ka pasur shumë. Për këtë kërkoj mirëkuptimin tuaj në mënyrë që ta fusim këtë, sepse nga sekretaria e konfirmojnë se e kanë marrë ligjshmërinë e akteve, por në dërgimin e listave të përfshihet edhe ky fermer.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ekrem, komisioni që është i formuar nga ana e kryetarit – që ta thashë – është komision miks, ka vepruar në bazë të kërkesave që janë drejtuar, ata të cilët kanë pasur kërkesa në adresë të komunës dhe komisionit. Nuk ka pasur rast, nuk ka që këta nuk kanë dalë në vend të ngjarjes. Informacion tjetër të cilin nuk kam pasur për shtëpi, përveç rastit në fjalë.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Para se ta qes në votim: a jeni që këtij propozim-vendimi t'i bashkangjitet edhe kërkesa që është nga drejtori? Pra, jeni pro? Dhe tani: a jeni që të miratohet ky propozim-vendim? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet edhe ky vendim.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien e pëlqimit institucional dhe mbështetjen komunale për zhvillimin e projektit investues në fushën e teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturës së të dhënave në lokalitetin e Sllatinës, Komuna e Vitisë**

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Lidhur me këtë pike, materialin e keni marrë me kohë, dhe hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Para jush keni një propozim-vendim për dhënien e pëlqimit institucional dhe mbështetjen komunale për zhvillimin e projektit investues në fushën e teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturës së të dhënave në lokalitetin e Sllatinës, Komuna e Vitisë, aty afër kampit Bondsteel. Këtu i keni të paraqitura dhe parcelat, qëllimin e vendimit, dhënien e pëlqimit institucional, obligimet e organeve komunale, trajtimin në kuadër të Ligjit mbi Investimet e Qëndrueshme që i ka ndaj me kapituj, trajtimin e projektit në dokumentet e planifikimit hapësinor, vlerësimin e ndikimit dhe kushtet për realizim, zbatimi dhe raportimi, dhe e keni arsyeshmërinë e vendimit. Prandaj, nuk po ju lexoj vendimin se e keni marrë materialin me kohë. Këtu bëhet fjalë për vendosjen e serverëve për inteligjencën artificiale, aty afër kampit Bondsteel.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Zakonisht ne në Kuvend nuk kemi pasur raste në Kuvend me dhënë pëlqim, se zakonisht jepet prej drejtorive, por është rast më i komplikuar, ndërsa kompania pas pëlqimit vazhdon me leje. Ajo procedurë është në vete, që nuk ka të bëjë me neve, me leje që i takojnë drejtorive të caktuara. Përfaqësuesit e kompanive që janë këtu, janë në material.

z.Basri Aliu: Në emër të grupit të LDK-së e përkrahim çdo iniciativë dhe investim i cili bëhet në kuadër të komunës sonë, por edhe në Republikën e Kosovës. Andaj, ju mbetet vetëm drejtorive përkatëse që ta shqyrtojnë lëndën ligjore, ndërsa ne jemi pro këtij propozim-vendimi.

z.Ekram Abazi: Unë personalisht dy herë e kam lexu, por nuk e kam kuptu, dhe nuk besoj këshilltarët tjerë e kanë kuptu se çka është duke ndodh me këtë pikë. A ka ndonjë mundësi ndonjë sqarim më të thjeshtë me na dhënë, që me kuptu edhe ne edhe qytetarët?

z.Beqiri, përfaqësues i Dardania AI për Kosovë: "Dardania AI" është një kompani e inteligjencës artificiale që është formuar në San Francisko. Founder themeluesi i saj është Albian Qalaj, që është amerikan me shtetësi kosovare dhe amerikane, kështu që projekti ka me qenë një fabrikë e inteligjencës artificiale që ka me u vendos në atë pjesën e Sllatinës, lidhje me Bondsteel. Fati i krejt kësaj ane të Vitisë është që është një projekt gjigant në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane dhe Departamentin Amerikan, dhe ka me qenë një

projekt që diku vlera e investimit në katër vitet e para kanë me u kriju mbi 3 mijë vende pune. Ka me pasë shumë përparësi ajo pjesë me fuqi punëtore, dhe prioritetin e ka me pasë komuna e Vitisë. Inteligjenca artificiale për momentin është kryesorja në krejt botën, gjithë janë duke shku rreth asaj ruge, duke i përfshirë të gjitha sektoret. Fabrika e inteligjencës artificiale që ka me u ndërtu në atë pjesë ka me ruajt të dhëna për kompanitë botërore. Një sqarim të vogël shtesë ua dhashë, për çdo informatë shtesë që dëshironi jam në dispozicionin tuaj.

zn.Liridona Bislimi: Një prej pikave gjatë mbledhjes së Kuvendit të KPF-së [Komitetit për Politikë dhe Financa] që kemi diskutu më së shumti ka qenë kjo, dhe aty kemi marrë një sqarim. Mua më intereson me ditë afati kohor: kur fillojnë punimet, kur priten me u përfundu?

z.Beqiri, përfaqësues i "Dardania AI" për Kosovë: Për momentin jemi duke e pritë një përgjigje prej anës tuaj si komunë, kemi me vazhdu me Qeverinë qendrore. Punimet janë vetëm të gatshme, në atë moment që marrim të gjitha lejet ne kemi me vazhdu menjëherë. Faza e parë është ndërtimi, që besojmë deri në çerekun e dytë të vitit të ardhshëm mundemi me përfundu me ndërtimin, mandej kemi me vazhdu me pjesët tjera. Por është një projekt afatgjatë që ndoshta duhen vite për të përfunduar, për atë arsye nuk mundem me të dhënë përgjigjje të saktë për kohën e saktë.

z.Remzi Salihu: Të shihet kjo, se kjo është një marrëveshje që është një marrëveshje mes kësaj organizate dhe Qeverisë dhe komunës: a keni pasur takim me persona përgjegjës nga Qeveria dhe nga komuna, sepse po përflitet këtu që komuna nuk është përfillur fare? Dhe konkretisht, çka përfiton komuna e Vitisë nga ky projekt?

z.Beqiri, përfaqësues i "Dardania AI" për Kosovë: Ne kemi përcaktuar parcelën ku kemi me vendos fabrikën, mandej kemi pasur takime me ministren Rizvanolli, ministren Kusari-Lila dhe me ministra të tjerë, dhe kemi pasur koordinim. Pastaj kemi ardhur te Komuna e Vitisë, ia kemi shpjeguar se këto kanë qenë procedurat; gjatë gjithë kohës kemi qenë në koordinim me Ambasadën e Amerikës, Qeverinë e Kosovës dhe Komunën e Vitisë.

z.Remzi Salihu: Domethënë ka koordinim edhe me Komunën e Vitisë, edhe pse kanë thënë që "ne nuk dimë kurrgjë çka me thënë", së paku kështu kam dëgjuar që është flitur në KPF.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Jo, nuk është e vërtetë! Në KPF kjo çështje u diskutua dhe në aspektin profesional ne nuk kemi mujtë me diskutu, se s'kemi qenë asnjëri të lamisë përkatëse të asaj fushe me informata. Të gjitha që i kemi pasur, edhe unë, edhe nënkryetari, i kemi diskutuar, i kemi njoftuar. Absolutisht nuk ka pasur diçka që ka qenë kontest. Kjo ka qenë që neve na ka duhur informatë më shumë, me qenë dikush prej kompanisë, dhe ka qenë shumë i mirëpritur, sepse për një investim të tillë jemi përfitues të gjithë. Mirëpo, në këtë rast nuk është kërkuar prej Komunës së Vitisë tokë; ne vetëm pëlqim me ia dhanë, në tokën e vet që e ka blerë kompania, aty me fillu me punimet. Ne vetëm pëlqimet i kemi me ia dhanë, ndërsa gjërat tjera i ka prej Ministrisë. Më shumë ka punë me Qeverinë sesa me neve, se është projekt që kalon nivelin lokal.

z.Elham Emërllahu: Po besoj që këtu nuk paska shumë vend për me diskutu. Edhe kur e kam lexu në shtëpi më ka ardhur mirë që një kompani gjigante me ardhur me bë investim në komunën e Vitisë, dhe komuna me ia dhanë pëlqimin. Këta pronën e paskan të veten, investimi qenka i madh, me sa kuptova 17 miliardë euro, ndoshta nuk është veç për Kosovë, por sidoqoftë ne duhet me iu dhanë mbështetje kësaj dhe me procedu më tutje.

z.Hajdin Ademi: Edhe ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe jemi pro kësaj.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet ky propozim-vendim? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e pestë:

5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ngritjen e obeliskut "Dëshmorët dhe Martirët" e Verbanit**

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Para jush keni një iniciativë nga qytetarët e Verbanit, e cila ka ardhur për ngritjen e obeliskut për dëshmorët dhe martirët e Verbanit. Andaj, e keni këtë [kërkesë/iniciativë]

para jush: ne në KPF dhe me kryesuesin i bëmë disa ndryshime, për shkak se parcela që ata kanë kërkuar evidentohet si rrugë, që të mos e qitim kuvendin në pozitë të palakmueshme. Në koordinim me kryetarin, kemi ardhur në përfundim se duhet të jetë e titulluar për ngritjen e obeliskut dhe më vonë gjendet hapësira për ngritjen e atij obeliskut.

z.Arton Musliu, drejtori: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kërkesa për ndërtimin e një obelisku në fshatin Verban, që pasqyron organizimin e luftës së UÇK-së, Brigadës 173 "Gursel e Bajram Sylejmani", por edhe historinë që ka ndodhur aty, besoj fuqimisht që e meriton një trajtim të veçantë në kuptimin e ndërtimit të një obelisku i cili shpërfaq historinë që ka ndodhur aty, por lë edhe një vepër që shërben jo vetëm për brezin e tanishëm, por edhe për brezat e ardhshëm. Ideja është kjo: ndërtimi i një obelisku në hyrje të fshatit Verban, i cili do të pasqyrojë aty rënien e dëshmorit të kombit Kemajl Azizi dhe rënien e 3 martirëve të luftës Rexhep Emerllahu, Rrahim Rrahmani dhe Qerim Rrahmani. Besoj se ju e dini që fshati Verban ka qenë i boshatisur gjatë luftës i tërë, dhe gjithashtu janë 2 shtëpi të djegura. Kjo është përmbledhje e shkurtër e asaj që ka ndodhur gjatë luftës në Verban, dhe kërkoj nga ju që ta përkrahni këtë, i cili është në të mirë të komunitetit në përgjithësi dhe të vlerave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në veçanti.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Kësaj pjese është dashur t'i bashkohet edhe propozim-vendimi, sepse kur vijnë kërkesat në Kuvend duhet me qenë të caktuar edhe periudha, edhe dëshmorët, edhe martirët – nëse i keni këto. Mirëpo, në këtë formë që keni bërë nuk përcaktohet. Unë mendoj që me një... duhet me i përcaktu këto që the ti, sepse plotësohet vendimi.

z.Elham Emërllahu: Edhe si asamblist nga Verbani, të cilën para disa muajve e kam parashtruar si kërkesë sepse ka qenë një peticion i nënshkruar dehe nga bashkëfshatarët... Ajo që tha drejtori dhe nënkryetari – unë veç e falënderoj ekzekutivin, kryetarin e Komunës, juve kryesues dhe drejtorin që e kanë pru në Kuvend që ajo pronë me u legjitimu si pronë për shfrytëzim për obeliskun e dëshmorit (sepse është veç një dëshmor) dhe martirëve të Verbanit. Mandej, çështja e ndertimit edhe e investimit aty, e rregullimit të obeliskut, është çështje e fshatit, andaj kërkoj nga të gjithë asamblistët ta përkrahin

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Gjithë herë, kur ka qenë për dëshmorë dhe martirë, kanë qenë unifikues, mirëpo është kërkuar gjithherë që të bëhen më mirë, por gjithmonë Kuvendi ka qenë në përkrahje.

zn.Liridona Bislimi: Në mbledhjen e KPF-së ky material na ka ardhur edhe me pjesën e parcelës, mirëpo, siç e keni sqaruar, është dashur me u bë disa ndryshime në atë pjesë. Unë veç po shpresoj që mandej nuk ka me ju sjellë telashe kur ka me u dërgu te ministria përkatëse. Dhe gjithashtu, siç e ceke dhe ti, mendoj që është dashur me u paraqit dhe propozim-vendimi me na ardhur këtu në Kuvend Komunal dhe me u specifiku që pjesa që na ka ardhur neve është për dëshmorët dhe martirët e Verbanit, e që në fakt është veç një dëshmor. Ndoshat është më mirë me pas pak kujdes në harmonizim dhe formulim të materialit që po na u sjellet këtu. Siç e përmendi dhe kryesuesi, sa i përket ndërrimit [nderimit] të dëshmorëve dhe martirëve është obligim i secilit prej neve dhe ne e kemi bërë çdo herë në mënyrë institucionale, në mënyrën më të mirë të mundshme.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Një duhet me pas parasysh: vendimet për caktim të lokacionit të tilla, ky rasti ka qenë kontest, ka qenë në rrugë; nëse i vendosim këto, nëse nuk është në plan zhvillimor, ministria gjithherë na e kthen negativ dhe na duhet me e shfuqizu.

z.Ekrem Abazi: Unë këtë e përkrah plotësisht, por e pashë që investimi bëhet me të hyrat vetanake të qytetarëve. Është mirë që, në kësi rastesh, komuna me dhanë një përqindje për me i nderu ata dëshmorë e martirë. Kisha propozu që një përqindje të vogël të hollave, aq sa ka mundësi komuna, me ia bashkangjitë shumës së atyre qytetarëve që po financojnë.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Në të gjitha rastet, unë mendoj që komuna, në fund, i ka rregullu ato hapësira, të cilat prapë ka me i rregullu, pa asnjë diskutim. Mirëpo, si vendim, kjo është kërkesë dhe besoj që komuna gjithqysh ka me gjetë formën me marrë pjesë. Pasi që nuk ka më për debat, e qes në miratim. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Tani shkojmë në pauzë dhe në orën 13:30 fillon pjesa e dytë. Pas një pauze, vazhdojmë me pjesën e dytë.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vitisë 2026-2028

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Planin e integrimit e keni marrë me kohë. Është plan i miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me ekipet punuese që kanë qenë nga komunat. Shumica e komunave e kanë miratuar këtë plan. Unë, në muajin gusht, kam pasur kërkesë nga Ministria që ky plan nuk është miratuar nga Komuna e Vitisë. Jam konsultuar me nënkryetarin dhe zyrtarët që janë përgjegjës, dhe këtë plan sot e kemi proceduar për Kuvend. Ky plan nuk është hartuar nga ne si Kuvend, por është i njëjti plan që vlen në nivel vendi.

z.Halil Musliu, drejtor: Në bazë të Rregullores për Integrimin e të Huajve, Nr.09/2019, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Strategjisë për Migrim 2021–2025 të Qeverisë së Kosovës, veçanërisht për riintegrimin e personave të riatdhesuar, dalin detyrat për formimin e mekanizmave për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Kryetari i Komunës e ka themeluar Komisionin Komunal për Riatdhesim, të cilit, në bazë të pozitës, i prij unë. Ky komision e ka hartuar planin e veprimit dhe, siç tha kryesuesi, ky plan është dashur të aprovohet brenda vitit, por ka pasur vonesa, për shkak se personi që është dashur të merret me këto punë ka dalë në pension. Aktualisht, është hapur konkursi për këtë pozitë. Sot, para jush e keni Planin për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vitisë. Qëndresën po e shoh këtu, e cila ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në hartimin e këtij plani. Ky plan i ka objektivat e veta, siç janë: avancimi i sistemit të riintegrimit të personave të riatdhesuar; avancimi i masave dhe veprimeve për riintegrim ekonomik e social; përfshirja në sistemin arsimor dhe në programet e mirëqenies sociale. Po ashtu, parasheh krijimin e mekanizmave dhe koordinimin e ndihmave financiare e teknike në nivel të komunës për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Në këtë plan i keni të parapara veprimet dhe aksionet që duhet të ndërmerren për t'i ndihmuar këta persona. Janë përcaktuar akterët përgjegjës, afatet kohore, ekziston plani dinamik dhe gjithçka tjetër që është paraparë, në përputhje me instruksionet që kanë ardhur nga ministria përkatëse. Kërkoj nga ju që ta përkrahni këtë plan, sepse është obligim që rrjedh nga kjo rregullore dhe nga strategjia për migrim. Ju kisha kërkuar që ta votoni.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Pra, pasi që nuk ka për debat, a jeni që të miratohet edhe kjo pikë? Me të gjitha votat për, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nismën e kryetarit të Komunës se Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtarë me Komunën e San Cosmo Albanese

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Të nderuar këshilltarë, me siguri keni pasur rastin që edhe në këtë përbërje të kemi pasur iniciativa për bashkëpunim me komunën e Saint-Julien. Tash e kemi një komunë italiane, e cila kryesisht është e banuar nga arbëreshët, prandaj kemi një iniciativë të tillë. Është mirë që dy propozim-vendimet e para, përkatësisht: Propozim-vendimi për miratimin e nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e San Cosmo Albanese; Propozim-vendimi për dhënien e autorizimit kryetarit për t'i zhvilluar procedurat e mëtejshme, të shqyrtohen dhe të miratohen, me qëllim që Komuna e Vitisë të ketë bashkëpunim me komunat e vendeve perëndimore. Prandaj, si të tilla i kemi sjellë para Kuvendit dhe pres nga ju që t'i përkrahni.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Ju e dini që zakonisht, nga komunat arbëreshe, kemi pasur pjesëmarrës nëpër festivale dhe në aspektin kulturor kemi pasur një lloj bashkëpunimi. Mirëpo, parimisht, është mirë të kemi një marrëveshje ndërkombëtare për bashkëpunim më të mirë, pasi bëhet fjalë për komuna që janë në shtete të tjera. Pasi që nuk ka të interesuar për debat, a jeni që të miratohet ky propozim-vendim? Me të gjitha votat për, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e tetë e rendit të ditës:

8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për autorizimin e Kryetarit të Komunës se Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunën e San Cosmo Albanese

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Domethënë, tash autorizohet kjo nismë dhe njëkohësisht bëhet autorizimi i kryetarit të Komunës për të vazhduar me iniciativën për bashkëpunim. Pra, pasi që nuk ka për debat, a jeni që të miratohet ky propozim-vendim? Me të gjitha votat për, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e nëntë e rendit të ditës:

9. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve në DKRS gjate vitit 2026

z.Valmir Sahiti, drejtor: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Duke u bazuar në ndarjet buxhetore për DKRS-në gjatë vitit 2026, Komuna e Vitisë ka hapur thirrjet publike për OJQ-të në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Në përputhje me Rregulloren 04/2017, kemi përzgjedhur komisionin vlerësues, në përbërjen e të cilit ka marrë pjesë edhe një anëtar nga shoqëria civile. Komisioni vlerësues ka nxjerrë rezultatet preliminare, ku nga 38 OJQ aplikuese, si përfituese janë përzgjedhur 35 OJQ, ndërsa 3 OJQ janë refuzuar për shkak të mungesës së dokumentacionit, në përputhje me kërkesat e thirrjes publike. Pas përfundimit të afatit për ankesa në Komisionin e Ankesave, komisioni vlerësues ka dalë me rezultatet përfundimtare, ku janë përzgjedhur 35 OJQ përfituese, në vlerë prej 112 mijë e 300 eurosh. Nga 35 OJQ-të përfituese, 3 OJQ nuk e kanë nënshkruar kontratën me Komunën e Vitisë. Sipas informatave nga Drejtoria e Financave, deri tani janë proceduar për pagesë mbi 80% e subvencioneve në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. Secila nga këto 35 OJQ përfituese është e obliguar që në fund të vitit t'i dorëzojë raportet narrative dhe financiare te Komisioni për Monitorimin e Projekteve dhe Raporteve. Bashkëngjitur e keni vendimin përfundimtar për subvencionet, së bashku me listën e të gjitha OJQ-ve përfituese në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit gjatë vitit 2026.

z.Elham Emërllahu: Informatat për përzgjedhjen e OJQ-ve kanë qenë publike. E kemi parë shumicën e informacioneve, se kush ka fituar dhe sa është shuma, po ashtu edhe konkursin. Por, për mua, do të ishte më e rrugës që ndoshta drejtori, dikur gjatë kësaj periudhe, të na informojë më shumë për këto OJQ, sepse është një numër jashtëzakonisht i madh i OJQ-ve në Viti. Nuk e di sa i njohim aktivitetet dhe veprimtarinë e tyre. Këtu nuk po flas për shoqëritë kulturo-artistike, klubet sportive, ansamblet etj., sepse të gjithë i dimë, i njohim dhe e shohim aktivitetin e tyre. Por, për disa OJQ të tjera, unë jam marrë pak me shoqërinë civile dhe kam udhëhequr projekte, kryesisht nga Ministria e Kulturës, në të kaluarën, edhe atë kryesisht për parandalimin e dukurive negative. Prandaj, për një numër të OJQ-ve që po i shoh këtu, shtrohet pyetja: a do të ketë përcjellje të aktiviteteve të tyre dhe cili është interesi i qytetarëve të Vitisë nga implementimi i këtyre projekteve nga këto OJQ? Për mua, disa prej tyre nuk janë shumë të njohura. Nuk po dua të them se janë OJQ fiktive, sepse, përderisa kanë aplikuar për atë subvencion, ato janë të regjistruara. Por qëllimi është që për ato mjete që po jepen, ku shuma po del mbi 100 mijë euro subvencione për OJQ, cili do të jetë raportimi i tyre dhe cilat do të jenë veprimtaritë dhe aktivitetet që do t'i realizojnë? Ose, nëse i kanë realizuar, unë deri tash nuk kam parë ndonjë aktivitet të tillë. Po them, ky subvencion është për vitin 2026, drejtor, apo jo? Deri tash po them, edhe prej kureshtjes, sepse kam një përvojë në këtë drejtim. Edhe drejtoresha e QKMF-së e di, sepse në të kaluarën kemi pasur aktivitete si përfaqësues të OJQ-ve për parandalimin e dukurive negative te të rinjtë. Unë nuk i kam parë këto aktivitete, por uroj që të ketë pasur të tilla. Megjithatë, është mirë që ky institucion, Kuvendi dhe Ekzekutivi, pak a shumë të kenë njohuri për punën, aktivitetet dhe veprimtarinë që organizojnë këto OJQ. Unë nuk kam informata se si i dorëzojnë raportet në fund dhe çfarë përmbajnë raportet e tyre. Për këtë arsye po them se do të ishte mirë që, në përfundim të kësaj periudhe, drejtori të vijë dhe të na japë më shumë sqarime se cila ka qenë puna, aktiviteti dhe kontributi që këto OJQ kanë dhënë gjatë kësaj periudhe. Po flas për këto OJQ që për mua nuk janë shumë të njohura në Komunën e Vitisë. Nuk po flas për ato që janë më të rregullta dhe që i njohim, si shoqëritë kulturo-artistike, klubet sportive etj.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Kuvendi, kur e miraton buxhetin, i ndan edhe subvencionet. Domethënë, sa e di unë, 110 mijë euro kanë qenë të ndara për vitin 2026, të cilat i kemi miratuar ne si Kuvend.

Drejtoria e ka për detyrë që këto subvencione t'i shpërndajë dhe t'i realizojë mjetet që janë planifikuar me buxhet. Në bazë të kësaj, drejtoria është duke e dhënë raportin për mjetet që ne i kemi ndarë si Kuvend. Sa i përket mbikëqyrjes së këtyre mjeteve, ata e kanë obligim këtë, mirëpo ne duhet të kërkojmë informata dhe të kemi njohuri se çfarë përmbajnë raportet që dorëzohen. Besoj se zakonisht, pasi ta dorëzojnë raportin në fund të vitit, ata do të na përgjigjen dhe do të na japin informatat përkatëse. Pra, atëherë do të kemi mundësi të njihemi më shumë me realizimin e aktiviteteve dhe me mënyrën se si janë shpenzuar këto mjete.

zn.Liridona Bislimi: Atë që u diskutua paraprakisht prej kolegut Elhamit, veçse e kemi bërë si diskutim në KPF. Në parim, edhe unë pajtohem. Si komunë që bëjmë pjesë te komunat e mesme, në bazë të numrit të banorëve, e kemi një numër të fryrë të OJQ-ve që funksionojnë. E kemi përmendur edhe te pjesa e Komitetit, por drejtori ka dhënë sqarimin e vet. Prapë është kërkesë e njëjtë që ndoshta është mirë me pas pak më shumë vëmendje në aktivitetet dhe angazhimet që i bëjnë këto OJQ, për shkak se unë e përmenda edhe te pjesa e Komitetit, sa kam qenë në mandatin e kaluar kryesuese e Grupit të Grave, por edhe si këshilltare komunale, kam mbajtë aktivitete të ndryshme, tryeza e ngjarje të ngjashme, ku në theks të veçantë kanë qenë temat për rininë dhe gratë, me ministritë përkatëse, me organizata të ndryshme të nivelit qeverisës ose nacional. Edhe shumë shpesh kam pasë nevojë që me pasë ndonjë mbështetje, qoftë vetëm me pjesëmarrje të ndonjë organizate të Komunës së Vitisë, dhe asnjëherë nuk janë përgjigjur pozitivisht për me qenë pjesëmarrëse në këto aktivitete. Prandaj, unë konsideroj që ndoshta është më mirë me pasë një vëmendje ose një kujdes më të shtuar rreth aktiviteteve që zhvillojnë këto OJQ, për shkak se, sinqerisht, meqenëse paguhen prej taksave të qytetarëve, duhet me qenë edhe në dispozicion për shërbimet dhe aktivitetet që bëhen ndaj tyre.

z.Elham Emërllahu: Kryesues, unë e kuptoj që komuna me buxhetin e ka paraparë edhe subvencionimin për OJQ-të. Nuk jam kundër, por unë po kërkoj që ky komisioni vlerësues, që i ka vlerësuar këto OJQ, me i përcjellë aktivitetet e tyre dhe punët që ata i bëjnë. Nuk po them që janë vlera shumë të mëdha, por, pa marrë parasysh, edhe 1 mijë edhe 1.500 euro janë mjete të qytetarëve të Vitisë. Prandaj po them që një aktivitet, sado i vogël qoftë, të paktën të jetë publik dhe informues, në mënyrë që ne si institucion, si komunë dhe si Kuvend, të kemi njohuri që këto OJQ po e bëjnë një punë, po e kryejnë një aktivitet dhe ai aktivitet po u shërben të rinjve ose qytetarëve të Komunës së Vitisë.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Faleminderit dy këshilltarëve për kontributin e tyre dhe për vërejtjet, pa dyshim me qëllim të mira. Më lejoni t'ju njoftoj rreth procesit të subvencioneve. Drejtoria për Kulturë e ka një plan vjetor të mbështetjes financiare, të cilin çdo fillim të vitit e dorëzon te Zyra e Kryeministrit, më saktësisht te Departamenti për Qeverisje të Mirë. Pikërisht edhe sa i përket numrit të OJQ-ve, jemi brenda planit vjetor që e ka paraparë.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Falënderoj dy këshilltaret për kontributin e tyre dhe për vërejtjet, pa dyshim me qëllim të mirë. Më lejoni t'ju njoftoj rreth procesit të subvencioneve. Drejtoria për Kulturë e ka një plan vjetor për mbështetjet financiare, të cilin në fillim të çdo viti e dorëzon te Zyra e Kryeministrit, më saktësisht te Departamenti për Qeverisje të Mirë, pikërisht edhe sa i përket numrit të OJQ-ve. Jemi brenda planit vjetor që e ka parapa Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Të gjitha OJQ-të aplikojnë me projekte në kuadër të një thirrjeje publike, e cila i përcakton qartë kriteret dhe mënyrat e financimit publik, ashtu siç derivon nga Ligji për OJQ-të dhe Rregullorja 04/2017 e Ministrisë së Financave. Mandej, komisioni, duke e pa planin dhe aktivitetet e OJQ-ve, disa prej tyre i ka renditë dhe u ka dhënë buxhet më shumë, ndërsa atyre që janë më pak aktive u ka dhënë buxhet më pak. Por, për një gjë të jeni të bindur: secila prej këtyre OJQ-ve, në fund të vitit, është e detyrume që para Komisionit për Monitorim dhe Pranim të Raporteve, të cilin e formon kryetari i komunës, me i sjellë raportet narrative dhe financiare. Te raportet narrative përfshihen fotografitë, përshkrimi i projektit dhe dëshmitë e realizimit të tij, ndërsa në raportet financiare paraqitet pjesa buxhetore dhe financiare për secilën OJQ. Duke u bazu në këto parime, edhe në vitet e tjera komisioni për monitorimin e projekteve i ka futë në listën e zezë OJQ-të të cilat nuk kanë raportu para komisionit për raportet dhe projektet e realizuara. Prandaj, jam gjithmonë për transparencë dhe kontroll. Por, në këtë rast, për secilin këshilltar komunal dhe për secilën OJQ që është pjesë e këtij vendimi për subvencione, veç e veç, nëse ju intereson, mundeni me ardhë në Drejtorinë e Kulturës me protokoll. Është krejt dokumentacioni për atë OJQ.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Nëse një OJQ hyn në listën e zezë, sa është periudha që qëndron në atë listë?

z.Valmir Sahiti, drejtor: Është neni 25 i Rregullores 04/2017, ku përcaktohet që për dy vitet e ardhshme i pamundësohet përfitimi nga subvencionimi.

z.Elham Emërllahu: Unë jam gjithmonë në parim me i mbështet krejt ato OJQ që janë serioze, sepse kam punu vetë. Po bashkë kisha dashtë me ditë në sa aktivitete të një OJQ-je drejtori ka qenë prezent. Unë e kam parë, si një shembull të vogël, raportin e QKMF-së për muajin Roz, ose QKMF-ja, për shembull, herë pas here, gjithmonë bën aktivitete për data të rëndësishme në shëndetësi. Por unë nuk shoh OJQ të Komunës së Vitisë, se 30 OJQ po figurojnë këtu. Nuk po them që janë 30 krejt, se janë edhe klubet e shoqëritë që dihen, por kisha dashtë me ditë cili prej drejtorëve ose nënkryetari ka marrë pjesë në ndonjë aktivitet që e ka bërë një OJQ, ose në ndonjë punëtori, qoftë me të rinj, qoftë me të moshuar, qoftë për ambient. Unë jam shumë kureshtar me i pa dhe ndoshta me marrë pjesë në ato aktivitete, andaj po e bëj këtë pyetje.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Sa herë ka pasë promovim të librave që i kanë bërë këto OJQ, ne kemi marrë pjesë, edhe unë edhe nënkryetari. Te basketbolli, futbolli dhe disa aktivitete të tjera të OJQ-ve, ku më kanë thirrë, kam qenë, ndërsa kur nuk më kanë thirrë, as nuk e kam ditë që janë mbajtë.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Elham, një gjë po ta them me bindje: nuk jam drejtor i zyrave, por i terrenit. Nuk ka aktivitet të OJQ-ve që nuk jam mundu maksimalisht me e ndjekë. Edhe nëse në mesin e 35 OJQ-ve që janë këtu e gjen veç një OJQ që unë nuk e kam vizitu dhe nuk kam bashkëpunim me ta, publikisht jap llogari para teje dhe para secilit kuvend. Jo veç gjatë orarit të punës, të hënën e të premten, por edhe të shtunën e të dielën. Në secilën kohë jam në kontakt në terren dhe jam në secilin aktivitet ku shfaqen këto OJQ. Dhe po ta them pa modesti, është krenari për Komunën e Vitisë për rininë e jashtëzakonshme që e ka. Është krenari për Komunën e Vitisë për nivelin e jashtëzakonshëm të OJQ-ve. I ke edhe matjet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Krejt, merre Komunën e Vitisë me cilëndo komunë në nivel të Republikës së Kosovës, merre me aktivitete kulturore, sportive, rinore, edhe krahasoji e shihe dallimin. Po ashtu, edhe me mbështetje financiare, klubet duke i karakterizu në bazë të elitave dhe ligave. Merre, për shembull, një klub të Vitisë që është në Ligën e Dytë me një klub tjetër në Gjilan, Ferizaj apo Kamenicë, kqyre sa është mbështetja financiare. Merre një ansambël të qytetit të Vitisë, krahasoje me Gjilanin e Ferizajn, kqyre dallimin. Veç një krahasim ta bëj: Ansambli "Kastriotët" në Ferizaj 5 mijë euro i ka subvencionet. Merri ansamblet tona, merri organizatat rinore. Dikush mundet me thanë: pse po i mbështetni kaq shumë dhe me relativizu këtë kontekst, por ne e kemi këtë detyrë me i mbështetë ato. E kemi një plan financiar dhe e kemi një shumë buxhetore të subvencioneve me nda për ta.

z.Elham Emërllahu: Drejtor, nuk pate nevojë, pse unë thashë në fillim: ne të gjithë i njohim shoqëritë kulturore-artistike dhe sportive të cilat janë në Komunën e Vitisë, dhe nuk e kam aty. Dikush ndoshta i frigohet kostos politike për me debatu për këtë çështje, unë nuk e kam gajle, po tregoj të drejtën, sepse dikush mundet me thanë se po humb dikush në votë. Unë nuk e thashë për klubin Vllaznia, as për Ansamblin Anamorava, as për Kemajl Azizin, as për klubin e kik-boksit që ka marrë edhe tituj evropianë. Bile, me pasë mundësi, hala më shumë me i mbështetë. Unë kam ngritë tema këtu për klubin Vllaznia, për tribuna. Unë pata fjalën për disa OJQ që për mua janë të panjohura e që shumat janë 1 mijë, 1 500 dhe 500 euro. Qaty e pata problemin. Nuk e kam problemin unë me një ekip të futbollit, ose me Kemajl Azizin, ose me Anamoravën, sepse shumë mirë, nëse shohim, Kastriotët në Ferizaj i paska marrë 5 mijë, ti në Viti 5 mijë, jemi në rregull. Por unë kam fjalën për këto OJQ për të cilat unë nuk kam informata. Nuk jam pa njohuri për OJQ-të dhe që nuk i njoh në Viti, por një pjesë të madhe nuk po i njoh. Dhe sa jam marrë me aktivitete të OJQ-ve, por edhe me aktivitete politike, një pjesë të OJQ-ve, dorën në zemër, nëse dikush i njeh, le të flasë. Ti po thua që i njeh krejt, i ke përcjellë aktivitetet e tyre. Kjo është retorikë. Unë po të them: përcilli mirë, por me i pa të gjithë ne si institucione punën, aktivitetin dhe veprimtarinë e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Nuk besoj që është kriter me e njoft Elhamin, Visarin ose mua. Kriter është me apliku me dokumente dhe projekt, ndërsa ti e ke për detyrë me përcjellë a po e realizon atë

projekt në bazë të të cilit ka fitu. Kjo është, domethënë, që ka afat deri në fund të vitit, a po e realizon projektin që ti e ke subvencionu për me realizu atë projekt.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Elham, faleminderit për krejt shqetësimet, debatet dhe mendimet ndryshe. Gjithmonë prej secilit këshilltar komunal i kam pranu me shumë dëshirë, sepse besoj që veç kështu e zhvillojmë demokracinë dhe, mbi të gjitha, qëllimi ynë i përbashkët është qysh me bë më mirë Vitinë. Edhe të falënderoj për krejt shqetësimet e para. Të respektoj, së pari, si përfaqësues dhe, së dyti, i respektoj krejt ata njerëz që të kanë besu ty dhe të kanë mbështetë ty. Ta thashë edhe më herët, për secilën OJQ është mirë me qenë konkret. Për shembull, kjo OJQ nuk e ka zhvillu projektin, me thanë, mos me na ardhë marre, ose me hy edhe në atë pjesën politike, që kjo OJQ, nëse ke informata ose dëshmi, për shembull, ka lidhje politike, me ia thanë emrin dhe mbiemrin, jo me i relativizu senet me atë shabllonin "shumë OJQ fantome". Edhe unë jam bashkë me ty që secila OJQ që nuk e zhvillon atë projekt, pse jo, se fundi i fundit këto janë taksat dhe paret e krejt qytetarëve. Edhe veç kështu, tu ia pranu gabimet njëri-tjetrit, tu debatu për secilën temë, ne arrijmë me bë më të mirë këtë shoqëri. I inkurajoj secilin këshilltar për secilën vërejtje. Unë nuk e kam asnjë problem aty ku është keq me thanë keq. Ka shumë elemente edhe në Drejtorinë e Kulturës që nuk janë mirë, është e vërtetë ajo, se ne sistemin e përmirësojmë veç tu i pranu defektet dhe tu i pranu gabimet. Por, me kompetencë po ta them që nuk ka OJQ që nuk e zhvillon projektin dhe që nuk i bën në fund raportet narrative dhe financiare, e që kalon tutje. Shtrohet pyetja, nëse dojmë me bë analiza më të thella, ka OJQ që i fryjnë pak faturat e ato, por rolin e inspektorit nuk e bëj unë. Janë disa tema dhe institucione tjera që merren me këtë çështje dhe i inkurajoj me u marrë në vazhdimësi.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Faleminderit për debatin. Kjo pikë është veç informatë, nuk del në votim.

Si pikë e dhjetë e rendit të ditës:

10. Infomratë mbi aktivitet e realizuara gjatë muajit të ndergjegjsimit për kancerin e gjirit tetor 2026

zn.Vjollca Kadolli, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Bazuar në kërkesën që është bërë në KPF për të raportuar për aktivitetet e Muajit Rozë, kemi përgatitur një informacion të shkurtër për aktivitetet e realizuara. Besoj që e keni marrë materialin me kohë. Këto aktivitete Komuna e Vitisë i realizon shumë vite me radhë. Realizohen në mënyra të ndryshme, por ajo që është kryesore është koordinimi i plotë me institucionet komunale, me drejtoritë komunale të arsimit, organizatat partnere dhe komunitetin, me një qëllim të vetëm: për të ngritur vetëdijen qytetare për rëndësinë e parandalimit, të kontrolleve të rregullta shëndetësore dhe zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit. Si rutinë kemi që, para se me i caktu vendet, lokalitetet apo aktivitetet që do t'i realizojmë, ne, Këshilli Drejtues i QKMF-së, në koordinim me drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e përcaktojmë edhe moton për muajin, por në anën tjetër përcaktojmë aktivitetet ku do t'i mbajmë dhe mënyrën se si do t'i realizojmë. Këtë vit janë caktu disa aktivitete, të cilat i keni në material. Që të mos ju marrë kohë, nuk po e bëj leximin për secilën. Për çdo informatë shtesë, jam në dispozicionin tuaj.

zn.Liridona Bislimi: Faleminderit që kërkesën prej mbledhjes së KPF-së e keni marrë në implementim, edhe për përgatitjen e materialit, si dhe për elaborimin më në detaje. Sinqerisht, këtu ka shumëçka me u diskutu, por mënyra se si po bëhen sqarimet, pati përgjigje për gjithçka dhe shumicën e herave po ka përgjigje më se të nevojshme. Po mandej, kur të ndalësh me mendu, prej vitit 2024 mamografi ka ekzistu në komunë, tash jemi në vitin 2026 dhe ende nuk është funksional. Tash, kur po i bëj këto pyetje, po jepni afat kohor shumë të shkurtë. Shembull, e thatë që në nëntor ose dhjetor ka me u kompletu komplet procedura me staf, me krejt, për me qenë funksional. Por mandej lëshohet pyetja: kështu kemi pasë përgjigje konkrete të ngjashme edhe më herët. Dy vjet ka shku deri sa është bërë ky kompletim i stafit, gjersa ende nuk është kryer. Natyrisht se kjo pjesa e këtyre aktiviteteve të fushatës vetëdijesuese është shumë për me u përshëndetë, përgëzu, për shkak se ka efektin e vetë. Unë mendoj që nuk na mjafton veç me ju tregu grave që duhet me shku veç me u kontrollu, po duhet edhe me ua ofru mundësinë. Tash, në mesin e diskutimit, e nderume, e pashë që e përmende që gratë tash janë të vetëdijesuara, munden me shku edhe në Gjilan. Besoj që është shumë vështirë, besoj që është

shumë vështirë me ardhë në Viti për një grua prej fshatrave rurale me bë këtë kontroll. Ende nuk kemi mrri në atë vetëdijesim të përgjithshëm, e lëre më për me shku në Gjilan. Unë ta them vetë personalisht që, nga kontaktet që i kam me gratë, është shumë vështirë me bind një grua, me i bind familjarët e saj për me shku me bë një kontroll veç për qejf, për shëndetin tem, me kqyrë se mos ndoshta ka diçka më shumë. Për në Viti e mos të flasim për Gjilan. Përgjigjet qenë fenomenale, në detaje, por mandej, kur e shikon në praktikë, a janë tu shku gratë në Viti me u kontrollu te mamografi falas? Jo. A është mamografi qe dy vite brenda? Po. Kështu që tash këto marrëveshje që keni bë me Spitalin e Gjilanit janë shumë të mira, po këto po bahen veç brenda muajit tetor dhe e dimë që kanceri nuk i prek gratë veç në muajin tetor, janë edhe 11 muaj tjerë. E pashë shumë kundërthënëse: përgjigje patë, por mandej, kur i shikon në proporcion me realitetin, nuk po korrespondojnë edhe aq shumë. Besoj që e pata një mori pyetjesh me i bë e me diskutu, por qato krejt i dhatë. Por mandej, kur të dalë prej kuvendit e të shihet në realitet se sa janë të zbatueshme, kjo len shumë për të dëshiruar. Prandaj, unë të falënderoj për sqarimin dhe aktivitetet. Vitin e kaluar kam qenë në të gjitha aktivitetet pjesëmarrëse, e kuptoj rëndësinë që jeni tu i bë këto aktivitete, por unë mendoj që më e rëndësishme sesa me u thanë grave "shkoni me u kontrollu", është me ua ofru sa më lehtë atë mundësi për me e kry atë shërbim.

z.Basri Aliu: Drejtoreshë, të falënderoj për sqarimet dhe për aktivitetet që bëni në shëndetësi dhe që çdo herë i bëni transparente, domethënë që kemi qenë edhe ne të njoftum me këto aktivitete që po ndodhin në komunën tonë. E di që edhe herave të tjera mamografi ka ardhë edhe prej Prishtinës. Çdo herë janë bërë kërkesa dhe janë dhënë disa mundësi që me ju ardhë qytetarëve në ndihmë, e sidomos gjinisë femërore, që janë më të prekura nga kjo sëmundje. Përveç tjerash, përfitimi i mamografit është edhe një sukses për QKMF-në, kur e dimë se në QKMF kryhen vetëm shërbimet primare. Domethënë, mamografia del në atë sekondare, e që kaniherë edhe disa udhëzime administrative, disa ligje, nuk të lejojnë me i pasë ato shërbime. Por, me aktivitetin që keni bërë, ju keni mrri deri aty saqë ndoshta tani e finalizoni. Në anën tjetër, bashkëpunimin kurrë nuk e keni ndërpre, as me Prishtinën, as me Spitalin Rajonal, kështu që kanë fitu shumë gra. A ka vend për me qenë më mirë? Gjithsesi se ka dhe çdo herë do të ketë. Duhet me u mundu më shumë, gjithashtu, se duhet.

z.Elham Emërllahu: E falënderoj drejtoreshën për informatën. Unë lirisht mundem me thanë që njerëzve nuk duhet me ju hi në hakë, edhe QKMF-ja në Viti është ndoshta një ndër QKMF-të më të rralla në Kosovë që vazhdimisht, jo vetëm për Muajin Rozë, por edhe për datat e rëndësishme që kanë të bëjnë me shëndetin e qytetarëve, bën aktivitete, aksione, sensibilizime etj. Edhe unë faqen e QKMF-së e përcjelli, por edhe publikimet dhe njoftimet që i bëni. Lirisht mundem me thanë që nuk ka ndonjë QKMF në Kosovë që bën kaq shumë aktivitete të tilla. Për këtë i përgëzoj gjithë stafin, drejtoreshën, mjekët dhe infermierët e tjerë. Padyshim që me një pjesë të asaj që tha Liridona edhe unë pajtohem, por tash në detaje nuk mundem me ditë. Por nuk po muj me ditë pse Komuna e Vitisë ende nuk ka radiolog, a nuk ka kuadro. Unë e di që ka për çështje të tjera, normalisht u përmendën edhe në raportim.

zn.Vjollca Kadolli, drejtoreshë: Po nisem prej fjalisë: mamografi nuk është funksional. Mamografi është funksional dhe do të vazhdojë të jetë funksional. Unë e thashë, por me dashtë, nëse keni dyshu, keni mujtë me ardhë ndonjëherë, të paktën prej ditës kur është fitu, me ardhë me vizitu. Mamografi është funksional, është tu punu. Në momentin kur unë e kam bërë kërkesën për mamograf digjital për donacion, kam bërë disa herë kërkesa, por nuk janë realizu. Kur e kam bërë, ka qenë një periudhë shumë e shkurtër prej momentit kur e kemi fitu. Domethënë, në organizatën e fundit kur kam bërë kërkesë, ka qenë shumë shkurtër. Thashë, për me punu me mamograf duhet me qenë teknike bachelor. Nuk ka pasë në Viti, përpos një në Mogillë, sa kemi pasë informacion. E nderuar këshilltare, e përmende që në një takim të grave kam qenë edhe unë prezent, kur e kam sqaru në detaje këtë situatë. Kur e kemi bërë kërkesën, ka qenë një vajzë e Mogillës e licencuar, e cila, kur e kemi fitu mamografin, personalisht e kam ftu për me fillu punën me mamograf, por është martuar në një komunë larg dhe nuk i ka konvenu me ardhë në punë këtu. Për me kry një shërbim bachelor, të paktën duhen 3 vite dhe licencimi 4 vite të plota. Ka qenë një vajzë tjetër që kemi arritë, kam insistuar, sa për informacion, kam thirrë në Prishtinë, kam kërkuar nga Klinika e Radiologjisë të më dërgojë listën e studenteve tona që janë afër diplomimit. Në Komunën e Vitisë nuk ka pasë, përpos një vajze që ma kanë dërguar, të cilën e kam ftuar. Nuk ka qenë afër diplomimit. Në momentin që është diplomu, është licencu, e kemi ftu me fillu punën, mirëpo

nuk është leju për shkak se nuk ka pasë licencë për mamografi, që ishte obligative. Kam bërë kërkesë në QKUK, në Klinikën e Radiologjisë. Më është konfirmuar që mund të fillojë, ma kanë caktu datën kur mundet me fillu trajnimin. Është trajnu, e kemi dërgu për 3-4 muaj, deri sa është licencuar për shërbim të mamografisë, edhe pse ka pasë licencë për ofrim të shërbimeve radiologjike, por jo për mamografi. Ishte, domethënë, licencë e veçantë. Prandaj e kemi kriju këtë procedurë. Për shkak që nuk e kemi pasë radiologun në institucion, nuk kemi insistu me hapë shërbimin. Në anën tjetër, çdo qytetare, me përgjegjësi të plotë e them, ato që janë drejtuar te unë, për shkak të bashkëpunimit që kam me Spitalin e Gjilanit, në të gjitha rastet që janë drejtu te unë, unë ua kam caktu terminin në Radiologjinë në Gjilan, as nuk i kam lanë me shku atje pa termin. Të njëjtën e kemi vepru edhe me ultrazë, nëse kanë kërku. Në anën tjetër, të gjithë qytetarët që kanë kryer mamografi, asnjëherë të vetme nuk kanë shku me marrë rezultatin në Gjilan, por ne i kemi çu rezultatet në CD, ne kemi shku i kemi marrë, i kemi ftu qytetaret me ardhë me i marrë, ua kemi tregu rezultatin aty për aty. Mjekët familjarë tanë ua kanë tregu edhe rezultatin. Domethënë, jemi mundu që qytetarëve me ua ofru të gjitha shërbimet sa më afër. Një gjë po e përmend që po më duket nuk e dini. E tha edhe këshilltari Basri që udhëzimet administrative nuk e lejojnë, dhe unë po e them atë që duhet ta dini: nuk është obligative që kujdesi parësor shëndetësor me ofru shërbime të tilla, të gjitha. Prandaj, kur thoni që ka vend për t'u dëshiruar, nëse s'e kam thënë një herë, tash po e them: e pres një falënderim prej të gjithë qytetarëve, sepse të gjitha këto aktivitete janë vullnetare. Personalisht i kam shfrytëzuar të gjitha lidhjet që i kam edhe në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Lipjan, me ua ofru këtyre grave shërbimet. Kemi mbajtë aktivitete, që është e njëjta, me ua sqaru më lehtë. Ka këshilltarë në Kuvendin Komunal të cilët paguheni njëjtë dhe dikush flet, dikush nuk flet kurrë, por në fund paguheni njëjtë. E njëjta është edhe te ne: dikush bën aktivitete, dikush nuk bën, krejt mbetet në vullnetin e tij që udhëheq institucionin. E njëjta është te na, në udhëzimin administrativ nuk figuron në KPSh mamografia. Prandaj, duke parë këtë aktivitet të kujdesit parësor shëndetësor në shumicën e komunave, jo në të gjitha, Ministria e Shëndetësisë ka bërë Planin Nacional për Kancerin e Gjirit në gusht të këtij viti për herë të parë, sepse e ka parë që aktivitetet që po realizohen në kujdesin parësor shëndetësor po e rrisin ndërgjegjësimin e qytetarëve për me marrë shërbime. E ka bërë Planin Nacional, i cili është bërë në gusht të këtij viti dhe akoma është si draft. Domethënë, tani e ka prezantu ministri i Shëndetësisë. Domethënë, nuk ka pasë as plan. Çdo gjë që kemi bërë, e kemi bërë me vullnetin tonë. Për shembull, para dy viteve kam arritë me i siguru 80 gra që kanë bërë ultrazë falas në QKMF, përmes një marrëveshjeje me Avicenën. E kemi pru këtu një radiolog dhe edhe kjo ka qenë në vullnetin tonë. Domethënë, nuk është që e kemi pasë obligative. Prandaj, çdo aktivitet që mbahet në kujdesin parësor është në bazë të vullnetit për me ju ndihmu qytetarëve. Prandaj, duhet me i falënderu e jo me thanë që s'janë bërë aktivitete. Janë bërë shumë aktivitete, të gjitha janë vullnetare E diskutuam çështjen e OJQ-ve, erdha pak në fund. Fakti që subvencionohen, ne nuk marrim asnjë subvencionim për ato. Të gjitha i bëjmë falas. Shërbimet që ofrohen i bëjmë pa asnjë subvencionim. Të vetmen gjë që e bëjmë, kur i shtypim fletushkat, i shfrytëzojmë kontratat e komunës me operatorët ekonomikë, për shembull, që bëjnë dokumente të ndryshme. Përndryshe, këto të tjerat janë shërbime që i organizojmë në mënyrë vullnetare. I nderuar Elham, te çështja e radiologut, ne kemi pasë një radiolog i cili, në mënyrë vullnetare, e ka lëshu punën këtu në QKMF në Viti dhe është punësu në Spitalin e Ferizajt. Në anën tjetër, për me kry specializimin, një radiologu i duhen 5 vite deri sa të licencohet. Njëri nga mjekët tanë e ka marrë specializimin në radiologji dhe tani është specializu, domethënë janë 5 vite të plota. Kjo është arsyeja. Domethënë, thashë që në momentin që kthejnë përgjigje Ministria e Financave, qoftë me 1 nëntor, qoftë me 1 dhjetor, ne e angazhojmë si radiolog. Mirëpo, pa na kthy ata përgjigje, nëse ata thonë që mundeni me shku me rregulloren për rekrutim, ne automatikisht e shtyjmë prej 1 nëntorit në listë si radiolog. Nëse jo, duhet me iu nënshtru procedurave të rregullta të konkursit, të cilat shkojnë sipas rregullave, sa ditë janë. Kjo është situata. Përndryshe, mamografi është funksional dhe ka me vazhdu me punu tërë vitin, deri sa ta marrim radiologun tonë. Leximi bëhet në Gjilan, qytetaret tona nuk kanë nevojë me shku atje, sepse unë i dërgoj, unë shkoj i marr dhe ua raportojmë rezultatin direkt pacientëve.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Edhe kjo pikë është veç informatë, nuk del në votim.

Si pikë e njëmbëdhjetë e rendit të ditës:

11. Pyetje përgjigje

z.Nuhi Ramadani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë e kam një pyetje për drejtorin e Bujqësisë. Drejtor, i keni përzgjedhë 20 fitues për makina mbjellëse të grurit. Është interesim i qytetarëve se sa fermerë kanë apliku për të njëjtën makinë dhe si e keni bërë përzgjedhjen. Edhe një vërejtje te këto lista të përfituesve: janë emrat dhe mbiemrat, por nuk janë fshatrat. Arsyeja pse dua me qenë edhe fshatrat është se katër janë këtu me mbiemrin Ramadani, dy janë me mbiemra të familjarëve të mi. Ka rastisë emri i familjarëve të mi, por shumë njerëz më kanë shkru dhe tash nuk është e vërtetë që faktikisht në Komunën e Vitisë nja 7-8 fshatra e kanë mbiemrin Ramadani.

z.Basri Aliu: Një pyetje për Administratën. Më intereson gjendja civile, regjistrimi i banorëve të rinj që po na vijnë prej shteteve të tjera, a është tu shku sipas këtij ligji, udhëzimit administrativ ose vendimit? Sa është numri i tyre që e kanë marrë shtetësinë dhe a ka kërkesa ende në pritje?

z.Lulzim Haxhiu: Kam dy kërkesa nga qytetarët. Njëra është nga banorët e rrugës "Hasan Prishtina", të cilët kërkojnë nga Komuna ndarjen e parcelës për vendosjen e një trafoje elektrike, për shkak të tensionit të dobët të rrymës. Sipas banorëve, kjo kërkesë është bërë edhe më herët, por prapë nuk ka pasë ndonjë realizim të kësaj kërkese. Dhe tjetra është nga banorët e rrugës "14 Qershori", të cilët kërkojnë trotuar për këmbësorë, ku sipas banorëve po rrezikohen këmbësorët nga veturat. Rruga është prej Xhamisë, që bashkohet me rrugën e Pozharanit, dhe kjo lagje aty nuk ka trotuar, ndërsa ka lëvizje të shpeshta të komunikacionit.

z.Remzi Salihu: Kam dy pyetje. Njëra është për nënkryetarin. Kam bërë këtë pyetje shpeshherë dhe herën e fundit kur e kam bërë ka qenë në verë, kur kanë qenë të mbjellurat bujqësore, të cilat mund të dëmtohen nëse realizohet një punë në atë terren. Për të cilën është pyetja: rivitalizimi i kanalizimit në lagjen Sejdiu, në fshatin Remnik. A ka avancu kjo çështje apo si është puna? Edhe pyetja e dytë është për drejtorin e Shëndetësisë dhe drejtoreshën e QKMF-së. Te Qendra e Mjekësisë Familjare, sa persona janë të angazhuar? Nuk po i quaj të punësuar, se edhe ashtu nuk i paguani rregullisht. Dhe çfarë bëjnë ata persona në punën e tyre? Është fjala për personat me kontratë mbi vepër.

z.Hajdin Ademi: Dua ta ngre një shqetësim lidhur me vonesat e pagave për punëtorët me kontrata nga kompania Kosova Med e Caritas dhe kompanitë e tjera. Këta punëtorë ka me muaj që nuk i marrin pagat. A pritet që këtyre punëtorëve t'iu mundësohet marrja e pagave sa më shpejt? Është e vërtetë që këta punëtorë ishin në gjendje të rëndë.

zn.Liridona Bislimi: Sa i përket pyetjeve dhe kërkesave nga qytetarët tanë, kam disa çështje. Së pari, kam një kërkesë nga banorët e fshatit Drobesh, te rruga "Naim Frashëri", domethënë është rruga që lidhet prej shkollës së fshatit, prej varrezave të fshatit të Epërm. Ka kërkesë për me u vendosë pengesa në rrugë apo trapa, çka do që e shihni të arsyeshme, për shkak se është një numër i konsiderueshëm i nxënësve që kalojnë nëpër atë rrugë dhe po e shohin si pjesë të rrezikshme. Çështja tjetër ka të bëjë me drejtorin e Arsimit. Drejtoreshë, kisha kërku që këtë kërkesë me trajtu me seriozitet dhe me marrë tepër të ndjeshme te çerdhja e fshatit Drobesh, domethënë te pjesa e parashkollorëve. Gjatë këtij muaji, sidomos, kam pasë ankesa të tmerrshme lidhur me gjendjen e papastërtisë brenda objektit të shkollës. Dhe çka është më e keqja, ka prindër që më kanë shkru në mënyrë anonime, për shkak se ka disa nëna që kanë vendosë vetë, në mënyrë vullnetare, me shku me ju ndihmu me pastrimin e objektit. Edhe unë e kam parë vetë gjendjen se si ka qenë, e tmerrshme. Po flasim për nivelin e fëmijëve, që është mosha më e ndjeshme. Kërkesa konkrete që është prej nënave është që me u vendosë një pastruese, edhe pse shumicën e herave gratë shkojnë e interesohen më shumë për këtë pjesë të moshës së fëmijëve dhe ato po e shohin më të arsyeshme me qenë një pastruese grua. Unë i kam vetë fotografitë, po nuk dua me i bë publike. Nuk kam dashtë me bë të madhe mediatike, por po të lus shumë sinqerisht, po ta përcjell shqetësimin e nënave, të cilin ma kanë bërë në mënyrën më të sinqertë të mundshme. Të lutem, para se me ndodhë diçka më e madhe, mos të shfaqet ndonjë sëmundje, mos të bëhet diçka më e madhe, merre këtë shqetësim shumë me seriozitet. Çështja e papastërtisë te çerdhja në fshatin Drobesh është në proporcion tepër të madh. Edhe një çështje tjetër që desha me diskutu me drejtorin e DKRS-së është stadiumi i qytetit të Vitisë.

E kam diskutu edhe më herët, por po e shoh të arsyeshme që me bisedu prapë, për shkak se e dimë që ka qenë një shumë shumë e madhe që është paraparë për këtë projekt. Nëse nuk gaboj, prej të dhënave që kemi, mbi 800 mijë euro janë pasë dhanë. Nuk e di a është lujtë ndonjë lojë aty apo diçka. Domethënë, një pjesë ka qenë prej Ministrisë dhe një pjesë prej Komunës. Tash, për momentin, dua me pasë një sqarim se çka është tu ndodhë rreth atij stadiumi. A pritet me pasë një riplanifikim të ri? A keni bisedu me Ministrinë, ndoshta me kërku mjete të reja, apo me ndonjë kompani tjetër? Për shkak se është një stadium që në fillim, kur është rregullu me mbi 1 mijë ulëse, ka qenë perfekt dhe qytetit të Vitisë po i mungon një stadium i tillë. Prandaj, ka edhe sportistë të rinj që janë të interesum për këtë pjesë. A keni bërë ndonjë hap konkret për këtë pjesë? A mundemi me pasë informacion?

z.Ilir Zuka: Kam dy pyetje rreth rrugës Pozheran–Viti. Nënkryetar, është mirë me u bë pastrimi i rrugës, se ferrat gati kanë dalë pjesë-pjesë deri në mes të rrugës. Dhe, si çdo fshat tjetër, edhe ne kemi problem me ndriçimin publik. Por po e dimë që kontrata nuk mundet me qenë funksionale kur i kemi borxh atij. Në qoftë se është mundësia, të paktën qendrën me e rregullu ndriçimin publik.

z.Elham Emërllahu: E paskam shënu pyetjen te Drejtoria e Shërbimeve Publike, por në fakt qenka për drejtorin e Inspeksionit. E thashë edhe te pjesa e pasqyrave financiare një problem që këtë vit e ka përcjellë dhe është tu e përcjellë. Nuk e di pse, domethënë, sinjalistika rrugore në qytet, në fshatra, në afërsi të objekteve publike apo shkollave. Më ka ra vetë në sy dhe besoj që e keni pa edhe ju që këtë vit nuk është shtru asnjë vijë. Tash po e kuptoj që paska skadu një kontratë që paska pasë Drejtoria e Inspeksionit. Raporti që na e solli drejtoresha e Financave doli diku mbi 30 mijë euro shpenzime për pajisje të komunikacionit, por me të vërtetë vijat dhe vendkalimet, sidomos në lokalitetet ku ka frekuentim të nxënësve, vijat shenjëzuese nuk janë. Dhe çështja tjetër për DKRS-në: çka është puna me palestrën e sporteve në Drobesh? A ka ndonjë informacion se ku kanë mbërri punimet dhe kur ka me përfundu, se do me na u bë më zi se shkolla në Pozheran që ka qenë para disa viteve.

z.Naim Pira, drejtor: Faleminderit për pyetjet e parashtruara. Numri i aplikuesve rreth makinave për mbjellje të grurit ka qenë 52 dhe janë 20 përfitues. Kryesisht ata që kanë pasë sipërfaqe më të mbjella kanë qenë përfitues. Ndërsa, sa i përket pyetjes pse nuk i publikojmë edhe të dhënat tjera, natyrisht ekziston një ligj mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe, duke pasë parasysh që ligji i kufizon disa gjëra, jemi të kujdesshëm që mos t'i publikojmë. Disa komuna i publikojnë përfituesit vetëm me numrin e NIF-it. Ajo është më problematike, sepse pjesa dërrmuese e fermerëve tanë, e dimë gjendjen e tyre, aspektin e shkollimit të tyre dhe e kanë më problem me i gjetë. Për atë arsye, ne i publikojmë vetëm emrat dhe mbiemrat. Ndoshta mirë kishte me qenë edhe fshati, por në aspektin e kësaj pune nuk kemi pasë asnjëherë probleme. Zyra jonë është e hapur çdo ditë dhe secili mundet me marrë informata. Mundet me ndodhë me qenë 3-4 persona me mbiemra të njëjtë, por nuk kemi pasë probleme të kësaj natyre. Ndoshta mirë është që e dhatë si propozim me ua publiku edhe fshatin. Nuk na qet problem në këtë aspekt.

zn.Vjollca Kadolli, drejtoreshë: Bazuar në pyetjen e z. Remzi Salihu rreth punëtorëve të Caritas Kosova, veç një sqarim: nuk janë punëtorë me kontratë mbi vepër, por janë punëtorë të angazhuar përmes kontratës mes Komunës së Vitisë dhe Caritas Kosova, përmes tenderit të hapur në kuadër të prokurimit publik, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, konkretisht kujdesit shtëpiak dhe paliativ, por edhe në shërbimin ambulantor. Mund ta themi që numri është mbi 100, por çdo muaj është variabil, sepse punëtorët kanë të drejtë me marrë pushim pa pagesë. P.sh., këtë kohë i kemi rreth 24 punëtorë që janë në pushim pa pagesë. Andaj, çdo muaj ndryshon numri; mund të jetë 100, 110, 107, 120, varësisht sa punëtorë angazhohen brenda një muaji.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Për Liridonën rreth Stadiumit të Qytetit të Vitisë: E nderuar këshilltare, Komuna e Vitisë tashmë e ka një memorandum bashkëpunimi me Federatën e Futbollit të Kosovës rreth Stadiumit të Qytetit të Vitisë, ku janë qartë specifikume detyrimet e komunës dhe federatës. Komuna ka për detyrë që ta bëjë gati teren(in) për shtrirjen e tepihut sintetik. Punët kanë fillu, por fatkeqësisht, për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe ekzekutimit të mjeteve të përmbaruesve, kompania i ka ndërpre punimet, se nuk kemi arritë me kohë me i qitë mjetet që janë të specifikume për këtë projekt. Uroj që sa më shpejt komuna të ju kthehet stabilitetit financiar edhe të vazhdojë ky projekt dhe të kthehet në gjendjen si e meriton të jetë një

stadium i qytetit. Për Elham Emerllahun rreth Palestrës Sportive në Drobesh: Ndoshta një prej projekteve me kohëzgjatje më të madhe në Komunë të Vitisë, si Kalaja e Rozafatit. Janë bërë punimet në atë projekt, janë diku rreth 70% që kanë përfundu. Na kanë dalë 3-4 herë gjatë rrugës, ka dalë marrëveshja, memorandumi i mirëkuptimit me ministrin, më herët të Kulturës, tash të Sportit dhe Rinisë. Janë kërkesa të panumërta drejtuar ndaj ministrit të Sportit dhe Rinisë. Edhe sot, për herë të parë, dua ta themë një gjë publikisht, që në vazhdimësi kam zgjedh me u kursy në raport me secilin ministër, sepse për mu ata janë të respektuar, sepse përfaqësojnë institucione të Republikës së Kosovës. P.sh., ministri i kaluar i Kulturës, Hajrullah Çeku, për 1 javë i ka pas dhanë zgjidhje dhe orientim kësaj çështjeje. Ministri i tanishëm, Blerim Gashani, për mendimin tim e ka keqkuptu atë rol. Deri tani janë mbi 15 kërkesa zyrtare, edhe ai nuk e sheh të udhës së paku me na ftu një herë në takim. Kërkesë elementare, minimum janë 40 e-maile që ia kam dërgu atij personi, edhe veç në takim me na prit nuk e sheh të udhës me na ftu. E paramendoni kur institucionet komunale e kanë të pamundur me taku një ministër, paramendoni si e takon një qytetar ose një grup i interesit. Prandaj edhe këtu nga Kuvendi Komunal, të respektuar ministrin dhe krejt institucionet, sepse ato janë institucionet tona, e thërras ministrin e Sportit dhe Rinisë me i kthy sytë nga Vitia edhe një projekt jetik, siç është palestra e sportit, me ju dhanë zgjidhje. Se kam thanë shumë herë dhe po e përsëris prapë: për të rinjtë e Komunës së Vitisë, për klubet sportive, është krejt e parëndësishme cili subjekt politik është ministri, kryetari i komunës, drejtori. Atyre ju vynë ato projekte me qenë në shërbim të tyre dhe me dëshirën më të madhe e kishim ftu ministrin, siç i ka hije, me pre shiritin, sepse sinqerisht është tepru dhe një projekt që meriton me u përfundu dhe me u kthy në shërbim të tyre, që është destinu.

z.Ilir Zuka: Drejtor, mua sa më erdh një video, ka të bëjë me fushën ndihmëse në Pozheran. Jo që e paskan thy, po e paskan demolu të terenin. Tash po ta përcjelli ty videon. Kërkoj nga ti me bë një komision edhe unë si administrator do të vij në vend të ngjarjes. Edhe ky stadium ka mbetë gati se për kurgja. E dimë se shumë shkolla kanë problem për zhvillimin e stërvitjeve. Ne të ulemi me bisedu, ne ta marrim në shfrytëzim. Po të thashë, në çfarë gjendje më ka ardhë një video. Është gjynah një fushë që e kemi ndërtu 330 mijë euro me u demolu kështu. Ne e kemi dërgu në polici që 18 herë është thy rend, gjatë kohës sa kam qenë pjesë e klubit dhe gjatë kohës sa jam administrator. Për fat, i ka zbulu një herë policia dhe i ka marrë.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Ilir, është e vërtetë që në vazhdimësi kemi pas sulme edhe akte vandale ndaj infrastrukturës publike sportive, edhe në Sadovinë, edhe në Stadiumin e Qytetit në Viti, edhe në Pozheran. Fatkeqësisht, jemi këtu ku jemi dhe dikush e zgjedh në atë mënyrë me shfaq arrogancën e vetë. Por natyrisht, në këtë aspekt, ftojmë organet e rendit, Policinë e Kosovës dhe krejt mekanizmat tjerë me bë punën që ju takon, edhe me jau dhanë përgjigjen përfundimtare ndaj krejt atyre që cenojnë dhe godasin infrastrukturën publike të Komunës së Vitisë, sepse sulmi ndaj secilës pjesë të infrastrukturës publike, unë mendoj që është sulm ndaj secilit prej neve, ndaj familjeve tona, sepse ajo është pasuria jonë e përbashkët.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. E nderuara Liridona, pata një kërkesë që ta shqyrtoj me seriozitet për paralelen e ndarë në Drobesh të çerdhes. Liridona, me shumë përgjegjësi të madhe thamë se edhe unë vetë kam punu një kohë të gjatë në çerdhe dhe e di se si shkojnë punët aty. Dhe një dua ta themë, që shumica në objekt jemi të gjinisë femërore, ku e kemi si obligim edhe pastërtinë, kështu që nuk qëndron puna te pastërtia. D.m.th., pastërtia është në nivel. Sa herë e kemi vizitu, mund të ndodhë, p.sh., për arsye se është te fëmijët, është qëndrim ditor nga ora 7 deri në 4:30, varet edhe masdite se sa prindërit përfundojnë punën dhe i marrin fëmijët. Zakonisht kemi dhe një kujdestar masdite, kuptohet aty që është me fjetje, dhe ndodh shpesh që edhe punëtorja teknike mos me mujtë me hi gjatë aktiviteteve, mos me mujtë me hi brenda për pastrim. Zakonisht hin ajo pjesa kur fëmijët janë në gjumë ose zakonisht verës, kur kemi aktivitete jashtë, atëherë pastrohet dhoma. Ndërsa, sa i përket papastërtisë, nuk ekziston.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Po fillojmë prej Basrisë për çështjen e regjistrimit të banorëve të rinj apo fitimit të shtetësisë. Këtë ligj e ka aprovu Kuvendi i Republikës së Kosovës, që i obligon tash krejt zyrtarët e gjendjes civile. Duhet t'i shikojmë dy çështjet që i ngrite rreth çështjes së rrugës Hasan Prishtina për trafo. E di që është bërë një punë bukur e mirë për trafo këto ditë, por a është rruga Hasan Prishtina, atë nuk mundem me ditë. Është fillimisht fitimi i projektit. Në rast se e fitojmë projektin, tani nuk është problem

ndoshta edhe me gjetë lokacionin. Rruga "14 Qershori", tash e kemi inspektorin e komunikacionit, tash punon me kompetencë të plotë. Është mirë edhe këta të rrugës 14 Qershori edhe rrugës Naim Frashëri me u drejtu me kërkesë, deri sa nuk ka trotuar, ekipa e inspektorit del në vend të ngjarjes, i matë në kuadër të ligjit sa lejohen ato, i vendos dhe me i hekë ato problemet të cilat janë në të dy rrugët që shfaqen. Remzi, kam marrë një informacion se unë kam qenë ai që punëkryerësit i kam dhanë edhe adresat se ku me u drejtu në fshatin Remnik. Rreth kësaj, me siguri çështja e kontratës kolektive është ndalë, mjerisht, se e di që është një gjendje shumë e randë, për shkak se jetoj aty dhe sillem shpesh, dhe gjendja është si më parë. Në çështjen e rivitalizimit të kanalizimeve që bjenë dhe çështja e lagjes Sejdiu, po e quajmë rivitalizim, se ai mu ka defekt, të cilët kanë tentu që unë i kam qu 1 herë apo 2 te "Hidromorava", nuk kanë mujtë aty. Sipas inxhinierëve, siç i kam marrë informacionet, aty duhet një pjesë mu vendos kanalizimi i ri. Vonesa e pagesave të Kosova Medit, kjo është mungesë e mjeteve, se përnjëmend jemi bë monoton te kjo kontrata kolektive. Burimi i krejt të këqijave është ajo. Ilir, do t'i them drejtorit nëse ka kontratë aktive, bëne pastrimin e saj. Elham, po të përgjigjet që the janë 30 mijë euro dhe nuk kam parë, përveç shenjave që janë horizontale, janë dhe vertikale. Një prej këtyne po të sugjeroj, se këto shpenzime janë bërë në shenja vertikale. E ki dhe hyrjen në Viti, ajo tabela që lajmëron "Mirë se vini" në aspektin digjital, por janë dhe disa shenja vertikale, jo horizontale, se është investu edhe në atë drejtim.

zn.Liridona Bislimi: Për tek çerdhja në fshatin Drobesh, gjatë tërë muajit kam pas kritika dhe ankesa të njëjta. Tash ju po thuni që nuk ka papastërti. Unë nuk besoj që një nanë qohet një ditë në mëngjes edhe nuk ka çka me bë, e merr telefonin dhe më shkruan mu veç hajt, nuk ka papastërti, por ajo në imagjinatën e vetë po e shfaq. Mandej delë një tjetër dhe një tjetër. Por përpos kësaj, unë çka kam nëpër biseda, ka hala biseda më të zgjerume. Tash, nëse nuk kish ardh puna deri këtu, ato nana kanë qenë të gatshme me i kapë me i la tepihat vetë, qaq ju kanë dokë të papastra. Kam pas një rast tjetër që një nanë më ka thanë me raport të mjekut që çdo 2 javë vajza po më sëmuret në çerdhe edhe kanë kërku, nëse është nevoja, me pagesa të veta me marrë një grua, një pastruese për çerdhe. Nëse ti mendon që nuk është e vërtetë, ne të mbetet në ndërgjegjen tanë. Ky është kapaciteti jem që muj me bë me ta spjegu rastin. Tash ti po thu që nuk ka papastërti, çka me të bë unë? Nuk jam përgjegjëse e institucioneve e lajm ashtu. Për tek çështja e rrugës Naim Frashëri, faleminderit nënkryetar, besoj që është një punë që mundet me u kry shpejt edhe është mirë me u marrë parasysh sa më shpejt, për shkak të rrezikut. Drejtor Valmir, mundesh me gjetë publike në Facebook të deputetit të atëhershëm Njazi Isaku, ku ka bërë pyetjen konkrete në Kuvendin e Republikës së Kosovës rreth temës së palestrës. Është me 6 tetor 2023, ku bën pyetje se çka ka ndodh me punimet e palestrës së fshatit Drobesh. Përgjigja e ministrit Hajrullah Çeku ka qenë kështu: E kemi nënshkru aneks memorandumin që i mbulon mbështetjen e ministrisë për finalizimin e palestrës gjatë viteve 2023-2024 dhe kanë shpreh gatishmëri të vazhdueshme për me u kry shërbimet. Në fund ka thënë që veç komuna dhe operatori duhet me e rritë dinamikën e punës.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Nuk është në rregull me thanë hinë lexoje Facebook-un e dikujt, çka ka postu para 3 vjeteve. Ne jemi këtu persona zyrtarë dhe e dimë që ai investim është përgjegjësi e ministrisë, dhe je tu folë për një postim të vitit 2023.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Kjo palestër, ky projekt ka fillu diku në vitin 2014. I ka fajet qeverisja e PDK-së, ka kalu nëpër atë zingjir qeverisja e LDK-së, tash qeverisja e Vetëvendosjes. Është mirë shumë qartë me i thanë senet dhe mos me u mundu me kthy me një relacion politik dhe me i mbrojt partitë tona. Krejt, secili prej tyre ka përgjegjësi.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: E nderuara Liridona, prapë po të përgjigjem edhe një herë. Nuk e thashë që nuk e marrim rastin, ne çdo rast e marrim me seriozitet, po prapë po të themë, sa i përket pastërtisë për paralelen e ndarë në Drobesh, ajo çështje që the nuk ekziston, sepse ne e dimë që në secilën dhomë janë të vendosura edukatore femra dhe kemi 4 pastruese. Besoj që është mjaftueshëm për atë objekt. Sido që të jetë, unë prapë do ta trajtoj rastin. Nëse kemi kërkesa prej prindërve dhe unë jam përgjegjëse, të lutem adresoji tek unë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Konstatimin nuk e bën një prind, por e bën Inspekcioni Sanitar, që e bën përcaktimin e pastërtisë. Pasi që nuk ka më për debat, me kaq e përfundoj këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:30 min

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA
Pranuar - Pranuemë - Dated: 05-11-2026
Nr. I organit Org. Brej: 02-03 | 5/02-1302

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në pajtim me dispozitat e nenit 58, pika h nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 50, paragrafi 1 pika l e Statutit të Statutit të Komunës, me nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR EMËRTIMIN E SALLËS SË TEATRIT NË VITI ME EMRIN "JAKUP JAHIRI"

Neni 1

Me këtë propozim Vendim Kryetari i komunes së Vitise i propozon Kuvendit te Komunes se Vitise të bëhet emërtimi i sallës së teatrit në Viti me emrin "Jakup Jahiri", në shenjë respekti dhe nderimi për kontributin e tij të dhënë jetës institucionale,përkatësisht Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës, Ish-Kryetar i Kuvendit të Komunës së Vitisë, Ish- Zëvendëskryetar i Komunës së Vitisë, Ish-profesor, Ish- veprimtar politik, Ish-Sportist.

Neni 2

Salla e teatrit në Viti emërtohet me emrin "Jakup Jahiri".

Neni 3

Për zbatimin e këtij propozim Vendimi kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë, në bashkëpunim me organet dhe institucionet përkatëse komunale.

Neni4

Ky propozim vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës, pas vlerësimit të ligjshmërisë nga autoriteti mbikëqyrës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

P r o p o z u e s:

Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Haliti

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA
DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale me nr. 03/L-40 dhe neni 24 të Ligjit Nr..06/L-092 për dhënjen në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme Komunale,neni 29 paragrafi 5 i Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme të Komunës dhe nenit 50 pika l, e Statutit të komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kryetari i Komunës së Vitisë, me daten 11.11.2026, propozon këtë :

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar - Primljeno Me Dat:			12-11-2026
Nr. Lenderit Org. Broj	Numri Bro	Lidhur Pranuar	Vlera Vrednost
02-	035	02-1330	

PROPOZIM – VENDIM
PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHME PUBLIK .

I.

Me këtë propozim vendim , propozohet të bëhet shpallja zonë me interes të përgjithshëm publik për palujtshmerinë, pronën private që evidentohen në emër të Afrim (Latif) Zeneli për pjesën e parcelës kadastrale në sipërfaqe prej 603m^2, nga sipërfaqja e përgjithëshme prej 1500m^2 e ngasteres kadastrale me me nr. P-70101034-00139-4 , në vendin e quajtuar " Xhepa " në zonën kadastrale në Ramnishtë, për arritjen e qellimit të ligjshëme publik për nevojat e banorëve të fshatit Ramnishtë të komunës së Vitisë.

II.

Pas marrjes së këtij Propozim-Vendimit për shpalljen e pronës private si Interes i Ligjshëm Publik, Kryetari i Komunës do të inicojë procedurat e metutjeshme për këmbimin e pronës private me atë publike për arritjen e qellimit të lartcekur duke zbatuar Ligjit për dhënjen në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme Komunale dhe Rregulloren për caktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme të Komunës.

III.

Për zbatimin e këtij propozim - vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës , Drejtoria për Urbanizem, Planifikim dhe Mbrojtjen të Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente dhe Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi.

IV.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101034-00139-4

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	**1029/2026**
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	19.11.2026 - 08:41
Komuna / Opština / Municipality:	VITI / VITINA / VITI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Ramnishtë / Ravnište / Ramnishtë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70101034-00139-4	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna Imovina / Privatelly owned Land	Rural	1500	1-RDPP Në bazë të kërkesës për ndarje fizike nr. 05/2025, dt. 19.08.2024	17.01.2025	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
XHEPA	0		17.01.2025	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullosat/Pašnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 2/Pasnjak 2 Klase/2nd Class Pasture	1500

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhur Ažurir Updat
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	ZENELI AFRIM (LATIF)	1012561802	RAMNISHTË / RAVNIŠTE / RAMNISHTË /			1/1	Ne baze te aktvendimit me nr.1727/2025 dt.06.11.2025	10.11.2(

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Viti

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 139-4,138-0

Zona kadastrale / Katastarska zona: Ramnishtë


Numri i lëndës / Broj predmeta:

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 750

Lista e koordinatave të propozim ndarjes

Nr	Y	X
1	7532068.972	4686876.528
2	7532070.378	4686875.125
3	7532071.296	4686872.653
4	7532072.040	4686869.866
5	7532073.116	4686864.155
6	7532074.403	4686855.449
7	7532074.842	4686851.179
8	7532074.869	4686847.929
9	7532074.318	4686842.407
10	7532073.868	4686838.857
11	7532072.199	4686832.710
12	7532069.196	4686825.477
13	7532065.876	4686819.608
14	7532053.667	4686802.381
15	7532054.144	4686809.875
16	7532044.260	4686810.541



Rilevoi / Snimio: Valton Syla
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 104

Nënshkrimi / Potpis:

V.V.

KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Primljeno Me Datë: 12-11-2026			
Nr. I Organit Org. Brq.	Numri Broj	Shtojca Prilog	Vlera Vrednost
02-	035/02-1329		

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjn lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.28/2008), neni 50 paragrai 1 shkronja l, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011 dhe kërkesa e Përfaqsuesit Ligjor të Komunës me nr.02-070/01-1318, e datës 10.11.2026, Kryetari i Komunës me datën 11.11.2026 bën këtë :

PROPOZIM VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VARREZAT NË FSHATIN KABASH

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim , propozohet të caktohet lokacioni për varreza në zonën kadastrale në Kabash.

Neni 2.

Lokacionin për vendosjen e varrezave katolike , përfshin sipërfaqën prej 2500m^2 dhe për varrezat muslimane sipërfaqja prej 2701m^2, që shtrihet në kuader të parcelës kadastrale me nr. P-70101025-00887-0, në vendin e quajtur „ Ademovi Livadhe “, në zonën kadastrale në Kabash që evidentohet në pronësi të Komunës së Vitisë .

Neni 3.

Caktimi i lokacionin për varrezat e fshatit në zonën kadastrale në Kabash është mbrenda kufive të ndertimit me Planin Zhvillimore Komunal dhe e njejta do të financohet me vetkontributin e bashkfshatarëve të fshatit Kabash.

Neni 4.

Pjesë përbërse të këtij propozim –vendimi është : fleta poseduese , propozim ndarja.

Neni 5

Për zbatimin e këtij propozim-vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Kadaster , Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe drejtorit tjera relevante.

Neni 6.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101025-00887-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	**1020/2026**
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	16.11.2026 - 14:49
Komuna / Opština / Municipality:	VITI / VITINA / VITI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Kabash / Kabaš / Kabash
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70101025-00887-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land		8909			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ADEMOVA LIVA.PRAVOSLAV.GR.	0			

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Shërbimet Publike/Javne Usluge/PublicServices	Varrezë/Groblje/cemetery		8909

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuri Ažurira Updat
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	**Komuna e Vitisë**	600424486	/ / /		28 NËNTORI	**1/1**		

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale/Opštinska katastarska kancelarija: Viti

Nr. i njësisë kadastrale/Br. katastarske jedinice : 887-0


Zona kadastrale/Katastarska zona: Kabash

Numri i lëndës/Broj predmeta:

Lloji i njësisë kadastrale/Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit/Razmera plana 1: 1000

PROPOZIM NDARJE



Nr.	Y	X
1	7528579.011	4685046.6
2	7528571.86	4685006.413
3	7528562.502	4684976.909
4	7528534.806	4684989.643
5	7528590.246	4684992.945
6	7528639.88	4684974.259

Rilevoi/Snimio: Feat SHAQIRI
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës/Br. licence:

Nënshkrimi/Potpis:

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITI
ZYRIA PËR KADASTËR, PRONË DHE G...
KANCELARIJA ZA KATASTAR, IMOVINU I GEO...

Aprovoi/Usvojio:
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi/Potpis:

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

			10-11-2026
02-	070	01-1	318

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti-na

Datë	**10.11.2026**
Për	**Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë**
Nga	**Zyra e Kryetarit-me autorizim, Përfaqësuesi Ligjor Ardian Avdiu**
Lënda	**Kërkesë për inicimin e procedurës së ndarjes së ngastrës nr. P-70101025-00887-0**

Të nderuar,

Duke u bazuar në nevojën për administrimin dhe menaxhimin e pronës komunale, përmes kësaj kërkese ju drejtohemi me qëllim të inicimit të procedurës për ndarjen e ngaastrës kadastrale nr. **P-70101025-00887-0** me sipërfaqe prej 8909 m2, e cila gjendet në Zonën Kadastrale Kabash dhe është në pronësi të Komunës së Vitisë

Për këtë qëllim, kërkojmë që Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, sipas detyrës zyrtare dhe në kuadër të kompetencave të saj ligjore, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative dhe teknike për inicimin dhe zhvillimin e procedurës së ndarjes së parcelës së lartcekur.

Procedura e ndarjes duhet të realizohet në përputhje me gjendjen faktike dhe juridike të pronës, dokumentacionin përkatës dhe dispozitat ligjore në fuqi, duke bërë përcaktimin e sipërfaqeve përkatëse dhe regjistrimin e parcelave të reja kadastrale, pa cenuar të drejtën e pronësisë së Komunës.

Pas përfundimit të procedurës, kërkojmë që kjo drejtori të na njoftojë zyrtarisht dhe të na përcjellë dokumentacionin përkatës kadastral.

Me respekt,

Përfqësuesi Ligjor i Komunës

Ardian Avdiu

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti-na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 të datës 04.06.2008 dhe neneve 50 dhe 51 të Statutit të Komunës së Vitisë 01.nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë më datë 10.11.2026 lëshon këtë:

AUTORIZIM

Në bazë të kompetencave ligjore, autorizohet Përfaqësuesi Ligjor i Komunës së Vitisë, z. Ardian Avdiu, që të veprojë në emër dhe për llogari të Kryetarit të Komunës, lidhur me inicimin dhe zhvillimin e procedurës administrative për ndarjen e parcelës kadastrale nr. **P-70101025-00887-0**, me sipërfaqe prej **8,909 m²**, e cila gjendet në Zonën Kadastrale Kabash dhe është në pronësi të Komunës së Vitisë.

I autorizuari ka të drejtë që, në kuadër të këtij autorizimi, të paraqesë kërkesën për inicimin e procedurës së ndarjes së parcelës kadastrale pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, ta përfaqësojë Komunën pranë organeve dhe institucioneve kompetente lidhur me këtë procedurë, si dhe të pranojë njoftime, akte dhe dokumente që kanë të bëjnë me procedurën e lartcekur.

Ky autorizim vlen vetëm për veprimet dhe procedurën e përshkruar më lart dhe nuk përfshin të drejtën e tjetërsimit, të bartjes së pronësisë apo të disponimit juridik me pronën komunale.

Autorizimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe vlen deri në përfundimin e procedurës për të cilën është lëshuar, përveç nëse revokohet më herët. Ky autorizim nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

Datë 10.11.2026

Me këtë autorizim njoftohen:

1. Zyra e Kryetarit

2.Përfaqësuesi Ligjor i Komunës

3.Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi.

Kryetari i Komunës

z.Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA
Pranuar-Pranjeno Me Date: 09-12-2026
Nr. Protokollit Org. Njes. | Numri Rend. | Shkalla e Prior. | Vlera Vleftsisë
02- | 035 | 02-1312

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 35, paragrafi 2, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KUVEDIT KOMUNAL TË VITISË PËR VITIN 2027

Neni I

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, i PROPOZON Kuvendit, që ta shqyrtoj dhe aprovoj Planin e Punës të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2027.

Neni II

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është Draft Plani i punës i Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2027.

Neni III

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë.

Neni IV

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT
Bekim Azizi

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

DRAFT PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2027

Nëntor, 2026

PASQYRA E PLANIT

Parathënie 2
Përfundim 4
Janar 5
Shkurt 5
Mars 6
Prill 6
Maj 7
Qershor. 8
Korrik 8
Gusht 9
Shtator 10
Tetor 10
Nëntor 11
Dhjetor 11

PARATHËNIE

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësive të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu iu krijon mundësi qytetarëve, që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës, kryen edhe aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të padeleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;

- Miratimin e Planit zhvillimor komunal (PZHK), Planit zhvillimor urban (PZHU), dhe Planeve rregulluese urbane (PRRU), si dhe ndryshimin e tyre; dhe
- Themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit të caktuar të Kuvendit apo Kryetarit të Komunës dhe këtë delegim mund ta tërheqë në çdo kohë.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2027, ku Kuvendi i Komunës së Vitisë planifikon t'i mbaj 12 (dymbëdhjetë) seanca të rregullta, 6 (gjashtë) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2027, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Vitisë, e të cilat janë të proceduara sipas akteve në fuqi:

- Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregullores së punës së Kuvendit;
- Themelon Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete sipas ligjit;
- Funksionalizon komitetet e formuara këshillëdhënëse dhe planifikon raportimin e këtyre komiteteve para Kuvendit së paku një herë në vit.
- Planifikon shqyrtimin e raporteve e rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Inkorporon planin e tubimeve me qytetarë të Kryetarit të Komunës;
- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm, planet rregullative etj.
- Miraton çështje tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores se punës;
- Nxjerr rregullore të reja dhe bënë harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- Inkorporon planin e Kryetarit për festa shtetërore e kombëtare;
- Mbikëqyrë, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit.

PËRFUNDIM

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit. Duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2027, e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me planin e punës janë paraparë 11 seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, siç parashihet me LVL-në dhe Statutin e Komunës. Ndërsa seanca solemne janë parapa 3, si: 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së Kosovës, 05 Maj - Dita e Dëshmorëve të Komunës së Vitisë, 14 Qershori - Dita e Çlirimit të Komunës së Vitisë.

Dinamika e planit të punës së Kuvendit të Komunës do të realizohet në bazë të orarit të mbledhjeve të Kuvendit të miratuar në mbledhjen e parë të Kuvendit në vitin 2027, që përfshin edhe orarin e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Për përmbushjen e Programit të punës, ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizmin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikes të përcaktuar me këtë program, do të përkujdesen kryetari, kryesuesi i Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit.

Realizimi i Programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, e cila duhet t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2027.

Plani i punës së Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshinë: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2027 do të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar;
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore;
- Propozime për raportime dhe informata;
- Peticione; dhe
- Pyetje të anëtarëve të Kuvendit.

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

Viti

Zyrtar i Lartë Profesional i KK-së

Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit

Bekim Azizi

PLANI I PUNES I KUVENDIT TE KOMUNES SE VITISE PER VITIN 2027
JANAR 2027

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informatë për situatën ekonomike - financiarë të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese te komunës për vitin 2026 (Informata për Punën e Kryetarit te Komunës)	Kryetari i Komunës	Kryetari i Komunës	09.01.2027	KPF 16.01.2027	30.01.2027	
2.	Pasqyrat financiare për muajin Tetor - Dhjetor dhe Pasqyrat financiare për periudhën Janar - Dhjetor 2026	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	09.01.2027	KPF 16.01.2027	30.01.2027	
3.	Shqyrtimi I Planit vjetor të Auditorit të Brendshëm 2026	Zyra e auditorit	Kryetari i Komunës	09.01.2027	KPF 16.01.2027		
4.	Miratimi i Planit Vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)	KKSB	Kryetari i Komunës	09.01.2027	KPF 16.01.2027	30.01.2027	
5.	Informata rreth planit vjetor të punës se Kuvendin Komunal	Ekzekutivi komunal	Kryetari i Komunës	09.01.2027	KPF 16.01.2027	30.01.2027	
6.	Shqyrtimi I progresit te adresimit te rekomandimeve te auditorit te përgjithshëm sipas planit te veprimit 2026	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	09.01.2027	KPF 16.01.2027	30.01.2027	
7.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi komunal	Kryetari i Komunës	09.01.2027	KPF 16.01.2027	30.01.2027	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2027
SHKURT 2027

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informate mbi përfundimin e gjysmëvjetorit të parë shkollor	DKA	Kryetari i Komunës	12.02.2027	KPF 17.02.2027	28.02.2027	**17 shkurti Dita e pavarësisë**
2.	Shqyrtimi i Planit të prokurimit për vitin 2026	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës	12.02.2027	KPF 17.02.2027		

3.	Informatë mbi kontratat kornizë të Komunës së Vitisë	Drejtoria e shërbimeve publike	Kryetari i Komunës	12.02.2027	KPF 17.02.2027	28.02.2027	
4.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	12.02.2027	KPF 17.02.2027	28.02.2027	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2027
MARS 2027

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Bartja (rialokimi) i buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	11.03.2027	KPF 20.03.2027	27.03.2027	
2.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi komunal	Kryetari i Komunës	11.03.2027	KPF 20.03.2027	27.03.2027	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2027
PRILL 2027

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Pasqyrat financiare të Komunës për periudhën Janar – Mars 2027	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.04.2027	KPF 17.04.2027	29.04.2027	
2.	Informate mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.04.2027	KPF 17.04.2027	29.04.2027	
3.	Informate mbi përgatitjen e te mbjell urave pranverore	Drejtoria e Bujqësisë	Kryetari i Komunës	10.04.2027	KPF 17.04.2027	29.04.2027	
4.	Informate mbi Raportin e Përformancës	MAPL	Kryetari i Komunës	10.04.2027	KPF 17.04.2027	29.04.2027	

5.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.04.2027	KPF 17.04.2026	29.04.2027	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2027
MAJ 2027

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informate mbi Festivalin "Flakadani i Karadakut"	Drejtoria e Kulturës	Kryetari i Komunës	08.05.2027	KPF 20.05.2027	29.05.2027	**05 Maj-Dita e Dëshmorëve të Komunës së Vitisë**
2.	Informate mbi punën e KKSB-se	KKSB	Kryetari i Komunës	08.05.2027	KPF 20.05.2027	29.05.2027	
3.	Informate mbi punën e komiteteve funksionale	Komitetet funksionale	Kryetari i Komunës	08.05.2027	KPF 20.05.2027	29.05.2027	
4.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	08.05.2027	KPF 20.05.2027	29.05.2027	

PLANI I PUNES I KUVENDIT TE KOMUNES SE VITISE PER VITIN 2027
QERSHOR 2027

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028-2030	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.06.2027	KPF 15.06.2027	27.06.2027	**14 Qershori-Dita e Çlirimit të Komunës së Vitisë**
2.	Rishikimi i Buxhetit te Komunës për vitin 2027	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.06.2027	KPF 15.06.2027	27.06.2027	
3.	Shqyrtimi I raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së	KKSB	Kryetari i Komunës	10.06.2027	KPF 15.06.2027	27.06.2027	
4.	Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë	Drejtoria e shërbimeve Publike	Kryetari i Komunës	10.06.2027	KPF 15.06.2027	27.06.2027	
5.	Fillimi i përgatitjes për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2028	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i Kuvendit	10.07.2027	KPF 15.06.2027	27.06.2027	
6.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.06.2027	KPF 15.06.2027	27.06.2027	
7	Informat e Auditort te Brendeshme per vitin 2026	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i komunes	10.06.2027	KPF 15.06.2027	27.06.2027	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2027
KORRIK 2027

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informatë për situatën ekonomike-financiarë te komunës dhe për zbatimin e planeve investuese te komunës janar-qershor 2027, (informata për punën e Kryetarit te komunës)	Zyra e Kryetarit	Kryetari i Komunës	10.07.2027	KPF	29.07.2027	

2.	Pasqyrat financiare periudhën Janar– Qershor 2027	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.07.2027	KPF 22.07.2027	29.07.2027	
3.	Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2027	ZAP	Kryetari i Komunës	10.07.2027	KPF 22.07.2027	29.07.2027	
4.	Informate mbi realizimin e Planit te Prokurimit	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës	10.07.2027	KPF 22.07.2027		
5.	Informate mbi përfundimin e vitit shkollor	Drejtoria e Arsimit	Kryetari i Komunës	10.07.2027	KPF 22.07.2027	29.07.2027	
6.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.07.2026	KPF 22.07.2027	29.07.2027	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2027
GUSHT 2027

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2027
SHTATOR 2027

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2028 dhe projeksionet për vitin 2028-2030	Drejtoria e financave	Kryetari i Komunës	10.09.2027	KPF 21.09.2027	30.09.2027	
2.	Informate mbi fillimin e vitit te ri shkollor	DKA	Kryetari i Komunës	10.09.2027	KPF 21.09.2027	30.09.2027	
3.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.09.2027	KPF 21.09.2027	30.09.2027	
4.	Informate mbi përfundimin e fushatës se korrje-shirjeve	Drejtoria e Bujqësisë	Kryetari i Komunës	10.09.2027	KPF 21.09.2027	30.09.2027	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2027
TETOR 2027

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Pasqyrat financiare të Komunës për periudhën Janar– Shtator 2027	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	09.10.2027	KPF 21.10.2027	30.10.2027	
2.	Informate mbi realizimin e Planit te Prokurimit 2027	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës	09.10.2027	KPF 21.10.2027		
3.	Informate mbi realizimin e projekteve investive kapitale janar-shtator 2027	Zyra e prokurimit	Kryetari i Komunës	09.10.2027	KPF 21.10.2027		
4.	Informate mbi ndarjen e subvencioneve	Drejtoria e Kulturës	Kryetari i Komunës	09.10.2027	KPF 21.10.2027	30.10.2027	
5.	Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Vitisë	Drejtoria e Urbanizmit	Kryetari i Komunës	09.10.2027	KPF 22.10.2027	30.10.2027	
6.	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2028	Grupi punues	Kryesuesi i Kuvendit	09.10.2026	KPF 22.10.2027	30.10.2027	
7.	Shqyrtimi I propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	09.10.2027	KPF 22.10.2027	30.10.2027	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2027
NËNTOR 2027

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informate mbi procesin e legalizimit te objekteve	Drejtoria e Urbanizmit	Kryetari i Komunës	11.11.2027	KPF 20.11.2027	30.11.2027	

2.	Informate e Drejtorisë se Bujqësisë mbi te mbjellat vjeshtore	Drejtoria e Bujqësisë	Kryetari i Komunës	11.11.2027	KPF 20.11.2027	30.11.2027	
3.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	11.11.2027	KPF 20.11.2027	30.11.2027	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2027
DHJETOR 2027

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Harton	Propozon				
1.	Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e listës se pronave komunale për dhënien ne shfrytëzim	Drejtoria e kadastrit	Kryetari i Komunës	10.12.2027	KPF 21.12.2027	24.12.2027	
2.	Shqyrtimi I raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së	KKSB	Kryetari i Komunës	10.12.2027	KPF 21.12.2027	24.12.2027	
3	Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë për ndarjen e subvencioneve për vitin 2027	Drejtoria	Drejtori	10.12.2027	KPF 21.12.2027	24.12.2027	
3.	Shqyrtimi I propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.12.2027	KPF 21.12.2027	24.12.2027	

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA
Pranuar-Pranjeno Me Datë 05-11-2026
Nr. Protokolli Org. Broj 02-035/02-1301

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/1008), dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr.04/L - 076 për Policinë, dispozitave të nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012, MPB-së, 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe nenit 50 paragrafi 50.1 pika l) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

Për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-278, të datës 02.03.2026, për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunë së Vitisë, që të bëhet ndryshim plotësimi i vendimit Nr.01-110/05-278, të datës 02.03.2026, për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Neni 2

Konformë nenit 1 të këtij propozim vendimi, Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë, anëtari z. Branislav Denic, Përfaqësues i Bashkësisë Ortodokse në Viti zëvendësohet me z. Trajko Vlajkovic, Përfaqësues i Bashkësisë Ortodokse në Viti.

Neni 3

Të gjitha pjesët tjera të vendimit Nr.01-110/05-278, të datës 02.03.2026, për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë mbeten në fuqi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

P r o p o z u e s:

Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar-Pranjeno Me Dana 05-11-2026			
Nr. Protokolit Gra. Broj	Numri Broj	Shtojca e Prezent	Vlera Vrednost
02-	035/02-		7303

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në pajtim me dispozitat e nenit 58, pika h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen nr. 03/L-040 dhe nenit 50, paragrafi 1 pika l e Statutit të Statutit të Komunës, me nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 013/5549, TË DATËS 27.11.2006, PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYEZIMIT TË PALUAJTËSHËMERISË TOKËS NË PRONËSI SHOQËRORE OP "AGROMORAVA" NË VITI NË BARTËSIN E RI KEYQI I KUQ KOMUNAL NË VITI

Neni 1

Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë miratimin e Vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr. 013/5549, të datës 27.11.2006, për bartjen e të drejtës së shfrytezimit të paluajtëshmerisë tokës në pronësi shoqërore op "Agromorava" në Viti bartësin e ri kryqi i kuq Komunal në Viti.

Neni 2

Shfuqizimi i këtij vendimi bëhet sepse Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka shitur ngastrën kadastrale nr.2487-4 me sipërfaqe prej 500m², ZK Viti prone e GJI035 NSH "Agromorava"

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

P r o p o z u e s:

Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Haliti

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar-Primljeno Me Datu: 18-11-2026

Nr. Lotorit Org. Brq	Numri Rend.		Vlera Vrednost
02-	035/02-		1430

Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitise
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 të Ligjit mbi Vetqeverisjën Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008 lidhur me nenin 50 shkrona l të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të dates 21.04.2011,lidhur me Kërkesën e Qytetarve dhe Rekomandimin e Kuvendit të Komunës së Vitisë me nr.01-470/05-772 të datës 03.08.2026 si dhe Raportin e Komisionit për Prerjën e Punimeve në rrugën e UCK-së sipas Vnedimit 02-035/02-1277 të datës 02.11.2026,Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore bjen këtë:

Propozim Vendim

Për Heqjën e Kalldermit Egzistues në rrugën e Uck-së si shtrurjën e saj me asfalltë

I.Kryetari i Komunës bazuar në Kërkesën e Qytetarëve dhe Rekomandimin e Kuvendit të Komunës së Vitisë me nr.01-470/05-772 të datës 03.08.2026 që rrugën me kallderm ta harmonizoj konform kërkesës dhe Rekomandimit të Kuvendit të Komunës, ku kërkesa dhe rekomandimi i këshilltarve të Asamblesë komunale ka qenë që rruga e UCK-së të ndryshohet nga kalldermi në asfallt.

II. Kryetari i komunës i propozon kuvendit komunal të zavensohet heqja e kalldermit egzistues në rrugën UÇK-së dhe të bëhet zëvensimi i saj me asfallt, me qëllim të permisimit të infrastrukturës rrugore, sigurisë në komunikacion dhe kushteve më të mira për lëvizjën e qytetarve.

III. Kryetari i komunës i propozon kuvendit për ndrrimin e destinimit të metrave të mbetura(pa shpenzuara) të asfalltimit të parapara sipas projektit dhe ky destinim të bëhet për shtrimin me asfallt të rrugës së UCK-së

IV. Kryetari i komunës i propozon kuvendit për ridestinimin e pozicioneve nga kapitulli 70 Asfaltimi i pllatove, pika 5 e këtij kapitulli Riparimi i rrugëve të këtij kapitulli.

Nga ky kapitull ridestinohen pozicionet si në vijm:

Pozicioni 5.2 mbushja e siperfaqes së demtuar me zhavor guri i thyer 0-31.5mm me ngjeshje 100 MN/m2 në sasi 250 m3x9euro = 2250 euro

Pozicioni 5.3 shtrurja e asfalltit BZH22 në siperfaqe e trasës me trashsi të shtresës t=8 cm në gjendje te ngjeshur, të sillen atestet.

Tek pozicioni 5.3 aprovohet edhe sasia shtesë 1040 m2x10= 10.400euro

Sasia sipas kontratës është 2550 m2 x 10 euro = 25.500 euro .

Pozicioni 5.5 Lyrja me emulzion(sasia minimale e emulzionit të jetë 0.30 litra/m2,sasia 3590m2x1 euro =3590 euro.

Pozicioni 5.6 Shtrurja e asfalltit AB11 me trashsi të shtresës t=5cm në gjendje të ngjeshur, të sillen atestet, sasia 3590m2x10 euro=35.900 euro

V.. Obligohet Organet mbykqyrëse të Komunës së Vitisë dhe Operatori Ekonomik ti ndermarrin te gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e këtij vendimi, duke evidentuar saktë siperfaqën dhe sasinë e punimeve të realizuara.

VI. Ridestinimi i pozicioneve për asfalltimin e rrugës së uck-se është bërë sipas kontratës **Asfalltimi i rrugëve rurale në Komunën e Vitisë me numer të prokurimit 657-24-9543-5-1-1 dhe numrin e mbrenshum VI657-24-023-511 me numer protokolli 02-370/03-1346 të datës 26.11.2024 .**

VII. Materiali i përfituar nga heqja e kalldermit, përfshirë gurët dhe zallin nuk do të trajtohet si mbeturinë po do të ridestinohet pë nevoja të Komunës së Vitisë.

VIII. Materiali do të transportohet nga kompania e cila e ka shtruar kalldermin dhe do të vendoset në lokacionin e përcaktuar pranë projektit Kalaja e Bincës -Masa e Gjelbert

Propozues,Kryetari i Komunës së Vitisë

Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Komuna e Gjilanit

Komuna e Kamenicës

Komuna e Vitisë

Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve "**Liria**", Gjilan

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NË MES TË

KOMUNËS SË GJILANIT

KOMUNËS SË KAMENICËS

KOMUNËS SË VITISË

DHE

QENDRËS PËR MBROJTJEN E GRAVE DHE FËMIJËVE "LIRIA"

Në pajtim me nenin 17.1 (k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28, më 4 qershor 2008), Neni 24 i Ligjit për Parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore Nr.08/L-185 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22 nga 12 tetor 2023) dhe në pajtim me statutet e komunave përkatëse,

Komunat Gjilan, Kamenicë dhe Viti (në tekstin e mëtejmë "komunat") në njërën anë dhe

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Liria" në Gjilan, (në tekstin e mëtejmë "strehimorja"), si palë nënshkruese pajtohen si më poshtë:

Memorandum i Mirëkuptimit (MM)

Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për strehimoren për një periudhë tre (3) vjeçare: 2027, 2028, 2029

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Komunat zotohen të ofrojnë mbështetje financiare për strehimoren që ajo të kryejë funksionin e saj në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe dhunës në baza gjinore.

2. Objekti i strehimores gjendet në komunën e Gjilanit dhe ju shërben të tri (3) komunave të sipërpërmendura.

Neni 2

Obligimet e Komunave

1. Komunat do të kontribuojnë bashkërisht për nevojat financiare të strehimores duke u bazuar në Planin Vjetor Financiar dhe Operacional të strehimores.

2. Kontributi financiar i secilës komunë përbëhet nga dy komponentë:

   2.1 Shuma e barabartë vjetore për secilën komunë për mbulimin e shpenzimeve operacionale dhe të mirëmbajtjes.

   2.2 Shuma e ndryshueshme vjetore, sipas nivelit dhe kostos së shërbimeve të ofruara për viktimat - banorë të komunave përkatëse, gjatë vitit të kaluar kalendarik.

3. Për vitin 2027, kontributi financiar për komunat është si më poshtë:

Komuna e Gjilanit – EUR 10000

Komuna e Kamenicës – EUR 7500

Komuna e Vitisë – EUR 7500

4. Për vitet 2028 dhe 2029, kontributet do të përllogariten sipas nenit 2, paragrafi 2 dhe metodologjisë së përcaktuar në Shtojcën 1.

5. Një grup i përbashkët pune me përfaqësues nga të gjitha komunat e përfshira do të përcaktojë kontributet për 2028 dhe 2029, jo më vonë se 20 janari i vitit përkatëse. Këto vendime do të paraqiten në Shtojcën 1.

6. Nëse disa komuna vendosin ta rrisin kontributin e tyre me vet dëshirë, kjo nuk do të ketë pasoja për obligimet e komunave tjera të përcaktuara në MM.

7. Fondet për kontributet do të ndahen nga kategoritë buxhetore Subvencione dhe Transfere dhe do të transferohen në llogarinë e strehimores në një pagesë të vetme, jo më vonë se data 30 prill e secilit vit fiskal.

8. Komunat mund te mbështesin strehimoren edhe në mënyra tjera sipas nevojës së strehimores (p.sh. pagesa e qirasë mujore, lëndë djegëse për ngrohje, pagesën e shërbimeve si rryma elektrike, mbeturinat, ujit, furnizimin me ushqime apo pajisje për nevoja te viktimave etj).

9. Komunat do të mbajnë takime të rregullta me qëllim informues me strehimoren se paku nje here ne muaj.

Neni 3

Obligimet e strehimores

1. Strehimorja do të dorëzojë një kërkesë zyrtare për ndihmë financiare bashkë me Planin Vjetor Financiar dhe Operacional te komunat, jo më vonë se data 15 janar në vitin për të cilin mbështetja kërkohet.

2. Strehimorja është e obliguar të dorëzojë një raport financiar tre (3) mujor bashkë me faturat përkatëse te komunat.

3. Strehimorja është e obliguar të dorëzojë Komunave një raport financiar vjetor jo më vonë se data 31 Dhjetor. Raporti duhet të përmbajë edhe një pasqyrë statistikore që tregon se sa viktima ka shërbyer strehimorja gjatë vitit dhe nga cilat komuna vijnë ato.

4. Në rast të mosrespektimit të ndonjërit nga paragrafët e nenit 3, komunat kanë të drejtë të mos kryejnë pagesat përkatëse deri sa të zbatohen obligimet.

Neni 4

Dispozitat përfundimtare

1. Kryetarët e komunave do të sigurojnë implementimin e plotë të këtij MM.

2. MM do të nënshkruhet në katër (4) kopje origjinale dhe secila palë do të ketë një kopje.

3. MM hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

4. MM do të publikohet në ueb faqet e komunave.

Neni 5

1. Mosmarrëveshjet mes palëve do të zgjidhen me vullnetin e mirë të palëve.

Nënshkruesit e Memorandumit të Mirëkuptimit

PËR KOMUNAT:

Komuna e Gjilanit

Kryetari

Komuna e Kamenicës

Kryetari

Komuna e Vitisë

Kryetari

PËR STREHIMOREN:

Drejtoresha

Nënshkruar në Gjilan, më 16 nëntor 2026

Shtojcë 1

Metodologjia për përcaktimin e kontributeve për komunat, për vitet 2028 dhe 2029

1. Shpenzimet vjetore të strehimores (sipas Planit Vjetor Financiar dhe Operacional)
2. Kontributet e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve
3. Shuma totale e kontributeve vjetore sipas MM: #1 - #2.
4. Përcaktimi/përllogaritja e kostos së mirëmbajtjes së strehimores (sipas Planit Vjetor Financiar dhe Operacional)
5. Përllogaritja e kontributeve financiare individuale (Komponenta 1): #4 / 6
6. Përcaktimi/përllogaritja e kostos së shërbimeve të ofruara nga ana e strehimores (sipas Planit Vjetor Financiar dhe Operacional)
7. Përcaktimi/përllogaritja e % së viktimave nga secila komunë, në raport me numrin total të viktimave (sipas Raportit Vjetor Financiar).
8. Përllogaritja e kontributeve financiare individuale (Komponenta 2): #6 * #7.
9. Kontributi final vjetor për komunë: #5 + #8.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING
Njësia Org. / Org. Jedinica / Org.Unit: DI
Nr. Prot: / Broj Prot. / Prot.No: 5595-2/26
Nr. Faqeve / Broj stranica / No pages: 2
Data / Datum / Date: 27 / 10 / 2026
PRISHTINË/A

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Bekim Azizi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH Nr. V/219/26 Datë: 22.10.2026
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Arta Krasniqi – Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim Nr.01-110/05-1016 për vënien në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026-2034

I nderuar kryetar Haliti,

I nderuar kryesues Azizi,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 04.03.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), **Vendim Nr.01-110/05-1016 për vënien në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026-2034**

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Vitisë:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendim Nr.01-110/05-1016 për vënien në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026-2034

ARSYETIMI

Lidhur me Vendimin Nr. 01-110/05-1016 për vënien në shqyrtim publik të projekt-Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe sqarimeve të përcjella nga Departamenti i Planifikimit Hapësinor, ju njoftojmë si në vijim:

Lidhur me procesin e shqyrtimit të projekt-Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034, sqarojmë se Ministria ka dhënë fillimisht vlerësimin e saj profesional, duke përcjellë komentet dhe rekomandimet për ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme të dokumentit. Pas ridorëzimit të projekt-HZK-së nga Komuna, departamenti përgjegjës ka kryer vlerësimin e dytë, gjatë të cilit është konstatuar se një pjesë e kërkesave dhe rekomandimeve të mëparshme ende nuk ishin përmbushur, për çka janë kërkuar ndryshime dhe plotësime të mëtejshme.

Ndërkohë, më 20.08.2026, Komuna ka paraqitur ankesë lidhur me heshtjen administrative, ndërsa më 25.09.2026 ka nxjerrë Vendimin për vënien e projekt-HZK-së në shqyrtim publik.

Në arsyetimin e vendimit tuaj, keni theksuar se vazhdimi i procedurave mbështetet në dispozitat për heshtjen administrative, duke iu referuar afatit dhjetëditor të paraparë me nenin 9 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

Në këtë drejtim, sqarojmë se **neni 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3.2** i këtij ligji parasheh afatin prej tridhjetë (30) ditësh për kërkesën për ndryshime dhe plotësime të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës, ndërsa **nën-paragrafi 2.3.3** përcakton afatin prej dhjetë (10) ditësh për miratimin e dokumentit të përmirësuar, që përmban ndryshimet dhe plotësimet e kërkuara.

Në rastin konkret, sipas vlerësimit të departamentit profesional, janë konstatuar mangësi të cilat nuk janë përmirësuar sipas rekomandimeve të mëparshme, për çka janë kërkuar ndryshime dhe plotësime të mëtejshme të projekt-HZK-së. Rrjedhimisht, Ministria nuk ka dhënë miratim për dokumentin, por ka përgatitur një vlerësim të mëtejshëm profesional me kërkesa për ndryshime dhe plotësime, të cilat lidhen me procedurën e paraparë në nenin 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3.2 të ligjit.

Sa i përket **heshtjes administrative**, neni 100 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative rregullon miratimin në heshtje të aktit administrativ të kërkuar, në kushtet e përcaktuara me këtë dispozitë, përveç rasteve kur me ligj parashihet ndryshe.
Në këtë rast, duhet të bëhet dallimi ndërmjet miratimit të projekt-HZK-së nga Ministria, në kuadër të vlerësimit të përputhshmërisë së saj me dokumentet e planifikimit hapësinor dhe normat teknike, dhe vendimit të Komunës për vënien e dokumentit në shqyrtim publik. Këto përbëjnë faza të ndryshme procedurale dhe nuk duhet të barazohen gjatë vlerësimit të efekteve juridike të heshtjes administrative.

Gjithashtu, kemi parasysh se në vetë vendimin tuaj keni përcaktuar që, në rast se para fillimit ose gjatë shqyrtimit publik pranohen akte, komente apo kërkesa zyrtare nga Ministria, gjë do të shqyrtohen pa vonesë nga organet përgjegjëse komunale.

Duke marrë parasysh këtë përcaktim, si dhe faktin se Ministria ka identifikuar mangësi dhe ka kërkuar ndryshime dhe plotësime të mëtejshme, **ju lutem që të merrni parasysh vlerësimin dhe rekomandimet e përcjella nga Ministria dhe të bëni përmirësimet përkatëse në projekt-Hartën Zonale Komunale.**

Konsiderojmë se, përpara vazhdimit të procedurës së shqyrtimit publik, është e nevojshme që dokumenti të plotësohet dhe të harmonizohet me kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga departamenti profesional i Ministrisë, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria e tij me legjislacionin për planifikimin hapësinor dhe normat teknike përkatëse.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPH, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPŠTINA VITINA /
MUNICIPALITY OF VITI

KUVENDI KOMUNAL

Data:	05.11.2026
Për / Za / To:	**Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vitisë**
Përmes / Preko / Through:	**Z. Bekim Azizi** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë
Propozuesi / Predlagač / Proposed by:	**Z. Sokol Haliti** Kryetar i Komunës së Vitisë
Përgatitur nga:	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Komunës së Vitisë
Lënda / Predmet / Subject:	**Raport arsyetues për shqyrtimin e kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për rishqyrtimin e Vendimit nr. 01-110/05-1016.**

RAPORT ARSYETUES

Për shqyrtimin e kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për rishqyrtimin e Vendimit nr. 01-110/05-1016 për vënien në shqyrtim publik të Projekt-Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034.

1. QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport është përgatitur për t'i informuar anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vitisë lidhur me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për rishqyrtimin e Vendimit nr. 01-110/05-1016, me të cilin Kuvendi ka vendosur që Projekt-Harta Zonale Komunale e Vitisë 2026–2034 të vihet në shqyrtim publik.

Raporti paraqet:

- Rrjedhën kronologjike të procedurës së hartimit dhe shqyrtimit të Projekt-Hartës Zonale Komunale;
- Përmbajtjen dhe arsyetimin e kërkesës së Ministrisë;
- Veprimet e Komunës pas ridorëzimit të projekt-dokumentit;
- Kërkesën për vërtetim dhe ankesën formale lidhur me heshtjen administrative;
- Vlerësimin e dokumentacionit dhe të pretendimeve juridike të Komunës;
- Propozimin që i paraqitet Kuvendit për shqyrtim dhe vendimmarrje.

Qëllimi është që anëtarët e Kuvendit të marrin një vendim të informuar mbi kërkesën e Ministrisë, duke pasur parasysh dokumentacionin e plotë të procedurës dhe përgjegjësitë ligjore të Komunës.

2. OBJEKTI I KËRKESËS SË MINISTRISË

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përmes shkresës së Departamentit Ligjor të datës 22.10.2026, të protokolluar nga Ministria më 27.10.2026, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë rishqyrtimin e Vendimit nr. 01-110/05-1016 për vënien në shqyrtim publik të Projekt-Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034.

Sipas arsyetimit të Ministrisë, pas ridorëzimit të projekt-dokumentit nga Komuna është kryer një vlerësim i dytë profesional, gjatë të cilit është konstatuar se një pjesë e kërkesave dhe rekomandimeve të mëparshme nuk janë përmbushur. Ministria konsideron se, para vazhdimit të procedurës së shqyrtimit publik, dokumenti duhet të plotësohet dhe të harmonizohet me kërkesat dhe rekomandimet e departamentit profesional.

Ministria, në vlerësimin e saj, bën dallimin ndërmjet:

1. Miratimit të Projekt-HZK-së nga Ministria në kuadër të vlerësimit të përputhshmërisë; dhe
2. Vendimit të Komunës për vënien e projekt-dokumentit në shqyrtim publik.

Ky dallim procedural duhet të merret parasysh gjatë shqyrtimit të kërkesës. Njëkohësisht, për një vlerësim të plotë të ligjshmërisë së vendimit komunal, duhet të shqyrtohen edhe afatet, njoftimet dhe pretendimet e Komunës lidhur me procedurën e mëhershme pranë Ministrisë.

3. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Në këtë çështje janë relevante, ndër të tjera:

- Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor,
  Veçanërisht dispozitat për kompetencat e Ministrisë dhe të Komunës dhe afatet për shqyrtimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor;
- Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative,
  Veçanërisht dispozitat për bashkëpunimin ndërmjet organeve publike, llogaritjen e afateve, njoftimin, miratimin në heshtje dhe mjetet juridike;
- Ligji nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave;
- Rregullorja QRK nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave;
- Udhëzimi Administrativ MMPH nr. 24/2015 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës;
- Dispozitat përkatëse të Statutit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Komuna është përgjegjëse për hartimin dhe procedimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor në nivel komunal, ndërsa Ministria ushtron kompetencat e saj të shqyrtimit dhe vlerësimit sipas legjislacionit në fuqi. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë nga Kuvendi nuk e përjashton trajtimin profesional të komenteve që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e Projekt-HZK-së me dokumentet e planifikimit dhe me kërkesat ligjore e teknike.

4. KRONOLOGJIA E PROCEDURËS

1. Më datë 15.04.2026

Komuna e Vitisë e ka dorëzuar në Ministri Projekt Hartën Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034, për shqyrtim dhe procedim të mëtejmë.

2. Më datë 08.05.2026

Komuna e Vitisë dhe ekipi profesional e kanë prezantuar Projekt Dokumentin para përfaqësuesve të Ministrisë.

3. Më datë 19.05.2026

Komuna e Vitisë ka pranuar komentet dhe vërejtjet e para të Ministrisë lidhur me Projekt Hartën Zonale Komunale.

4. Më datë 05.06.2026

Është mbajtur takim sqarues dhe koordinues ndërmjet përfaqësuesve të Komunës, ekipit profesional dhe përfaqësuesve të Ministrisë, me qëllim të diskutimit dhe trajtimit të komenteve të dhëna.

5. Më datë 15.06.2026

Komuna e Vitisë e ka ridorëzuar në Ministri Projekt Hartën Zonale Komunale të plotësuar, me **nr. protokolli 3298/26**, duke kërkuar pëlqim për procedimin e dokumentit në shqyrtim publik.

6. Më datë 25.06.2026

Sipas llogaritjes dhe qëndrimit të Komunës, ka përfunduar afati dhjetëditor për veprimin e Ministrisë lidhur me dokumentin e ridorëzuar.

7. Më datë 12.08.2026

Komuna e Vitisë i është drejtuar Ministrisë me kërkesë për sqarim lidhur me statusin e lëndës dhe mosveprimin pas ridorëzimit të projekt-dokumentit, konkretisht U.D. Bajram Kafexholli, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së.

8. Më datë 19.08.2026

Komuna e Vitisë ka paraqitur në Ministri kërkesën për lëshimin e vërtetimit me shkrim të aktit që ajo e konsideron të miratuar në heshtje, si dhe ankesën formale lidhur me heshtjen administrative.

9. Më datë 31.08.2026

Shkresa e Ministrisë nr. **3298-2/26**, e titulluar **"Vlerësimi 2 – para shqyrtimit publik"**, është protokolluar nga Ministria dhe, sipas konfirmimit të Komunës, është pranuar nga Komuna po atë ditë.

10. Më datë 15.09.2026

Komiteti për Politikë dhe Financa e ka shqyrtuar propozimin për vënien në shqyrtim publik të Projekt-Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034 dhe ka votuar që ai të procedohet për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

11. Më datë 25.09.2026

Kuvendi i Komunës së Vitisë ka miratuar Vendimin nr. **01-110/05-1016** për vënien në shqyrtim publik të Projekt-Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034.

12. Më datë 27.10.2026

Komuna ka pranuar kërkesë prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për rishqyrtimin e Vendimit nr. 01-110/05-1016 për vënien në shqyrtim publik të Projekt-Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034.

5. RIDORËZIMI I PROJEKT-HZK-SË MË 15.06.2026

Pas pranimit të komenteve të para të Ministrisë dhe pas takimit sqarues të datës 05.06.2026, Komuna dhe ekipi profesional kanë shqyrtuar komentet, kanë përgatitur përgjigje e arsyetime dhe kanë ndërmarrë ndryshime në projekt-dokument.

Më 15.06.2026, Komuna e ka ridorëzuar Projekt-HZK-në në Ministri me shkresën nr. 3298/26. Në shkresën përcjellëse Komuna ka kërkuar lejimin e procedimit të dokumentit në shqyrtim publik dhe ka deklaruar se janë bashkëngjitur dokumentet me përmirësimet dhe arsyetimet për pjesën tekstuale dhe grafike.

Edhe në faqen e parë të Vlerësimit 2, Ministria e identifikon dokumentin e dorëzuar më 15.06.2026 si Projekt-HZK të plotësuar.

Komuna e ka lidhur këtë ridorëzim me nenin 9, paragrafi 2, nënparagrafin 2.3.3, të Ligjit nr. 04/L-174, i cili parasheh afatin dhjetëditor për miratimin e dokumentit të përmirësuar që përmban ndryshimet dhe plotësimet e kërkuara.

Sipas llogaritjes së paraqitur nga Komuna në kërkesën dhe ankesën e saj, afati ka filluar më 16.06.2026 dhe ka përfunduar më 25.06.2026.

Komuna pretendon se brenda këtij afati nuk është njoftuar nga Ministria me:

- Vendim për miratimin e dokumentit;
- Kërkesë tjetër për ndryshim ose plotësim;
- Vendim procedural për shtyrjen e afatit; ose
- Njoftim tjetër zyrtar që ndikon në përfundimin e procedurës.

Ky pretendim duhet të vlerësohet së bashku me të gjitha dëshmitë e korrespondencës ndërmjet institucioneve.

11. DALLIMI NDËRMJET SHQYRTIMIT PUBLIK DHE MIRATIMIT PËRFUNDIMTAR

Vendimi nr. **01-110/05-1016** ka për objekt vënien në shqyrtim publik të projekt-Hartës Zonale Komunale.

Shqyrtimi publik ka për qëllim informimin, konsultimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve, institucioneve dhe palëve të tjera të interesuara në procesin e hartimit të dokumentit.

Vendimi për vënien e projektit në shqyrtim publik nuk është vetvetiu vendim për miratimin përfundimtar të Hartës Zonale Komunale.

Pas shqyrtimit publik, komentet dhe propozimet duhet të trajtohen sipas legjislacionit dhe procedurave përkatëse.

Ky dallim nuk e heq nevojën për respektimin e kushteve ligjore që zbatohen për hapjen e shqyrtimit publik.

Ai ndihmon që objekti i vendimit komunal të vlerësohet saktë.

12. MOSPËRPUTHJET NË DATAT E SHKRESËS SË MINISTRISË

Në faqen e parë të kërkesës për rishqyrtim, Ministria shënon se e ka pranuar vendimin komunal nga MAPL-ja më **04.03.2026**.

Në arsyetim, Ministria shënon se vendimi është nxjerrë më **25.09.2026**. Edhe në vendimin e Kuvendit, sipas faqes së parë të dokumentit të paraqitur, thuhet se mbledhja është mbajtur më 25.09.2026.

Meqenëse këto data nuk mund të qëndrojnë siç janë shkruar, propozohet që Ministrisë dhe MAPL-së t'u kërkohet konfirmimi i:

- Datës së pranimit të vendimit nga MAPL-ja;
- Datës së përcjelljes së vendimit nga MAPL-ja te Ministria;
- Datës së pranimit nga Ministria;
- Datës së dërgimit dhe pranimit të kërkesës për rishqyrtim nga Komuna.

Mospërputhja mund të jetë gabim material, por duhet të sqarohet për të verifikuar rrjedhën dhe afatet e procedurës.

13. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM PËR KUVENDIN

Nga dokumentacioni i paraqitur në këtë raport rezulton se Komuna ka bazë për t'i kërkuar Ministrisë një shqyrtim të plotë të kronologjisë dhe një përgjigje të individualizuar për pretendimet e saj procedurale.
Në veçanti:

- **Ridorëzimi i Projekt-HZK-së më 15.06.2026 është i dokumentuar.**
- Komuna ka paraqitur **kërkesë për vërtetim dhe ankesë formale më 19.08.2026**, para datës kur, sipas konfirmimit të saj, ka pranuar Vlerësimin 2.
- Vlerësimi 2 mban datën e brendshme 10.07.2026 dhe datën e protokollimit nga Ministria 31.08.2026. Sipas evidencës së Komunës, shkresa është pranuar nga Komuna më 31.08.2026..
- Kërkesa për rishqyrtim nuk e analizon në mënyrë të veçantë pretendimin e Komunës të mbështetur në **nenin 32** të Ligjit nr. 05/L-031.
- Në shkresën e Ministrisë ekziston një mospërputhje e dukshme ndërmjet datës së pretenduar të pranimit të vendimit dhe datës së miratimit të tij nga Kuvendi.
- Komuna ka përgatitur dokumentacion për trajtimin e komenteve, megjithëse për disa çështje mbetet mospajtim me Ministrinë mbi përmbushjen e tyre.

Këto rrethana mbështesin propozimin që Kuvendi ta shqyrtojë kërkesën, të vlerësojë argumentet dhe të vendosë për qëndrimin që do t'i përcillet Ministrisë.

14. PROPOZIMI PËR VENDIMMARRJE

Duke u mbështetur në sa më sipër, **i propozohet Kuvendit të Komunës së Vitisë**:

1. Ta shqyrtojë kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për rishqyrtimin e Vendimit nr. **01-110/05-1016**.
2. Pas shqyrtimit të kërkesës së Ministrisë dhe dokumentacionit përkatës, të propozohet që Kuvendi të mos e pranojë kërkesën për ndryshimin e Vendimit nr. 01-110/05-1016 dhe ta mbështesë vendimin ekzistues, për arsyet e paraqitura në këtë raport..
3. Të kërkojë nga Ministria që të rishikojë qëndrimin e saj mbi bazën e kronologjisë së plotë dhe të trajtojë në mënyrë të individualizuar:
    - Afatin pas ridorëzimit të datës 15.06.2026;
    - Datën e njoftimit të Vlerësimit 2;
    - Kërkesën për vërtetim dhe ankesën formale të datës 19.08.2026;
    - Pretendimet e Komunës të mbështetura në nenet 32, 46 dhe 100 të Ligjit nr. 05/L-031;
    - Mospërputhjet e datave në shkresën e vlerësimit të ligjshmërisë.
4. Ta ngarkojë Kryesuesin e Kuvendit që, pas vendimmarrjes, t'ia përcjellë Ministrisë qëndrimin e miratuar të Kuvendit, arsyetimin dhe dokumentacionin mbështetës, me kopje Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
5. Të kërkojë që çdo koment profesional i Ministrisë dhe i palëve të tjera të interesuara të trajtohet sipas legjislacionit dhe procedurave përkatëse.

Ky është **propozim për shqyrtim dhe votim**.

Qëndrimi që do t'i përcillet Ministrisë [illegible]

Të bashkangjitur gjeni Dokumentet:

1. Shkresa e Departamentit Ligjor të Ministrisë për vlerësimin e ligjshmërisë dhe kërkesën për rishqyrtim.
2. Vendimi i plotë i Kuvendit nr. **01-110/05-1016**.
3. Dëshmia e ridorëzimit të Projekt-HZK-së më **15.06.2026**, nr. **3298/26**.
4. Komentet e para të Ministrisë dhe dëshmia e pranimit të tyre nga Komuna.
5. Dokumentacioni për takimin sqarues të datës **05.06.2026**.
6. Dokumenti i Komunës për trajtimin e komenteve të Ministrisë.
7. Kërkesa ose emaili i datës **12.08.2026** për statusin e lëndës, me dëshminë e dërgimit.
8. Kërkesa për vërtetimin e miratimit në heshtje, e datës **19.08.2026**, me dëshmi të protokollimit.
9. Ankesa formale kundër heshtjes administrative, e datës **19.08.2026**, me dëshmi të protokollimit.
10. Vlerësimi 2 i Ministrisë, nr. **3298-2/26**.
11. Dëshmia e pranimit të Vlerësimit 2 nga Komuna më **31.08.2026**.
12. Konstatimi i ekipit profesional për statusin e trajtimit të komenteve.
13. Dëshmia e dërgimit të vendimit komunal në MAPL dhe dëshmia e pranimit të kërkesës për rishqyrtim nga Komuna.

Përgatiti:

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me Zyrën Ligjore.

Me respekt,

Zyrafete Rama

Drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

6. VLERËSIMI 2 DHE RËNDËSIA E DATËS SË NJOFTIMIT

Shkresa e Ministrisë nr. 3298-2/26, e titulluar "Vlerësimi 2 – para shqyrtimit publik", mban dy data me rëndësi për këtë procedurë:

- 10.07.2026 – data e brendshme e shënuar në shkresë;
- 31.08.2026 – data e shënuar në vulën e protokollit të Ministrisë.

Sipas konfirmimit të Komunës, kjo shkresë është pranuar nga Komuna më 31.08.2026. Dëshmia përkatëse duhet të paraqitet si pjesë e dosjes.

Vlerësimi 2 përmban kërkesa konkrete profesionale për ndryshime dhe plotësime të Projekt-HZK-së. Në të, për çështje të ndryshme, Ministria ka konstatuar se kërkesat janë plotësuar, janë plotësuar pjesërisht ose mbeten të paplotësuara.

Megjithatë, për shqyrtimin e pretendimit të Komunës lidhur me heshtjen administrative, rëndësi ka edhe data kur shkresa i është njoftuar Komunës, si dhe ekzistenca ose jo e ndonjë njoftimi tjetër të mëhershëm.

Në shkresën e vlerësimit të ligjshmërisë, Ministria e përmend Vlerësimin 2, por nuk e specifikon datën kur ai i është njoftuar Komunës. Po ashtu, nuk e trajton shprehimisht faktin se, sipas evidencës së Komunës, njoftimi është bërë pas kërkesës dhe ankesës së datës 19.08.2026.

Për këtë arsye, propozohet që nga Ministria të kërkohen dëshmitë e dërgimit dhe të njoftimit, si dhe sqarimi i dallimit ndërmjet datës së brendshme të shkresës dhe datës së protokollimit.

7. AFATI DHJETËDITOR DHE QËNDRIMI I MINISTRISË

Në kërkesën për rishqyrtim, Ministria i referohet nenit 9, paragrafi 2, nënparagrafit **2.3.2**, të Ligjit nr. 04/L-174 dhe afatit tridhjetëditor për kërkimin e ndryshimeve dhe plotësimeve.

Ministria argumenton se, në rastin konkret, një pjesë e kërkesave të mëparshme nuk janë përmbushur, prandaj janë kërkuar ndryshime dhe plotësime të tjera.

Komuna, nga ana tjetër, konsideron se dokumenti është ridorëzuar pas trajtimit të komenteve dhe se duhet të zbatohet nënparagrafi **2.3.3** për dokumentin e përmirësuar.

Për vlerësimin e kësaj çështjeje janë të rëndësishme:

1. Shkresa e ridorëzimit e datës 15.06.2026;
2. Përmbajtja e dokumentacionit të dorëzuar me të;
3. Tabela e trajtimit të komenteve dhe arsyetimet profesionale;
4. Qëndrimi i Ministrisë në Vlerësimin 2;
5. Çdo njoftim për kërkesa plotësuese ose shtyrje të afatit;
6. Data kur Komuna është njoftuar me qëndrimin e Ministrisë.

Nëse konfirmohet se deri më 31.08.2026 nuk ka pasur njoftim tjetër relevant, Komuna ka argument të kërkojë sqarim për mosnjoftimin edhe në raport me afatin tridhjetëditor që Ministria e përmend në arsyetimin e saj.

Megjithatë, **zbatimi i afatit dhjetëditor dhe pasojat juridike të tij mbeten çështje të interpretimit të dispozitave dhe të vlerësimit të plotë të dokumentacionit**.

Ky raport paraqet qëndrimin e Komunës dhe argumentet në mbështetje të tij.

8. KËRKESA PËR VËRTETIM DHE ANKESA FORMALE E DATËS 19.08.2026

Më 19.08.2026, para pranimit të Vlerësimit 2, Komuna e Vitisë ka paraqitur dy parashtresa të veçanta në Ministri:

8.1. Kërkesa për vërtetim

Përmes kërkesës, Komuna ka kërkuar lëshimin e vërtetimit me shkrim të përmbajtjes së aktit që ajo e konsideron të miratuar në heshtje, lidhur me Projekt-HZK-në e ridorëzuar më 15.06.2026.

Në këtë kërkesë Komuna është mbështetur, ndër të tjera, në nenin 32, nenin 46 dhe nenin 100 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

8.2. Ankesa formale

Përmes ankesës formale, Komuna ka kërkuar shqyrtimin e mosveprimit të Ministrisë dhe të pretendimit për pasojat juridike të kalimit të afatit.

Ankesa e paraqitur nga Komuna mban datën 19.08.2026 dhe vulë të protokollit të Ministrisë. Në shkresën e vlerësimit të ligjshmërisë, Ministria e përmend datën 20.08.2026 për ankesën; për këtë mospërputhje propozohet të kërkohet sqarim.

8.3. Lidhja me Vlerësimin 2

Vlerësimi 2 përmban komente dhe kërkesa profesionale për Projekt-HZK-në. Nga përmbajtja e shkresës së shqyrtuar nuk rezulton se ajo trajton në mënyrë të individualizuar:

- Kërkesën për vërtetim;
- Pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës formale;
- Pretendimin e Komunës për pasojat e heshtjes administrative; ose
- Zbatueshmërinë e nenit 32 në procedurën konkrete.

Kjo nuk përjashton mundësinë që Ministria të ketë nxjerrë ndonjë përgjigje tjetër. Prandaj, para vendimmarrjes, duhet të kontrollohet dosja e korrespondencës së Komunës.

Nëse nuk është pranuar përgjigje tjetër, propozohet që Ministrisë t'i kërkohet të njoftojë nëse këto parashtresa janë shqyrtuar dhe të përcjellë çdo vendim të marrë, së bashku me dëshminë e njoftimit.

9. NENI 32 DHE NENI 100 I LIGJIT PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Komuna e ka mbështetur qëndrimin e saj në nenin 32, paragrafët 4 dhe 5, të Ligjit nr. 05/L-031. Kjo dispozitë trajton rastet kur një organ publik vendos pasi kërkohet mendimi, pëlqimi apo miratimi paraprak i një organi tjetër publik, dhe parashikon pasoja për mosveprimin brenda afatit, në kushtet e përcaktuara me ligj.

Në kërkesën dhe ankesën e saj Komuna është mbështetur edhe në nenin 100, i cili rregullon aktin administrativ të miratuar në heshtje në kushtet që përcakton ligji, si dhe në nenin 46, paragrafi 3, lidhur me vërtetimin me shkrim.

Në vlerësimin e ligjshmërisë, Ministria i referohet nenit 100 dhe dallimit ndërmjet fazës së miratimit të projekt-HZK-së dhe vendimit komunal për shqyrtim publik. Megjithatë, shkresa nuk paraqet arsyetim të veçantë për pretendimin e Komunës të mbështetur në nenin 32.

Prandaj, në përgjigjen që propozohet t'i dërgohet Ministrisë, mund të kërkohet që Ministria të sqarojë:

1. Nëse e konsideron nenin 32 të zbatueshëm në këtë marrëdhënie procedurale;
2. Nëse jo, cilat janë arsyet dhe dispozitat konkrete që, sipas saj, e përjashtojnë;
3. Cili afat është i zbatueshëm pas ridorëzimit;
4. Cilat janë pasojat juridike të datës së njoftimit të Vlerësimit 2;
5. Nëse është dhënë ndonjë përgjigje për kërkesën dhe ankesën e Komunës.

Vlerësim:

Pretendimi i Komunës për miratim të prezumuar përbën një argument juridik që duhet të shqyrtohet. Ai nuk e zëvendëson nevojën për të vlerësuar nëse plotësohen të gjitha kushtet e dispozitave përkatëse, përfshirë natyrën e miratimit të kërkuar, afatin e zbatueshëm, dokumentacionin dhe çdo njoftim relevant.

10. TRAJTIMI I KOMENTEVE TË MINISTRISË

Nga dokumenti "Trajtimi i Komenteve nga Komuna" dhe nga konstatimi i ekipit profesional rezulton se janë përgatitur përgjigje, arsyetime dhe trajtime për çështjet e ngritura nga Ministria.

Dokumentacioni dallon:

- Komente për të cilat janë bërë ndryshime;
- Çështje për të cilat Ministria ka vlerësuar se plotësimi është i pjesshëm;
- Kërkesa që Ministria i konsideron të papërmbushura;
- Çështje për të cilat ekziston mospajtim profesional ose juridik.

Për Kuvendin është me rëndësi të dallohet ndërmjet trajtimit të një komenti dhe pranimit të zgjidhjes nga Ministria. Komuna mund të ketë dhënë përgjigje ose arsyetim për një koment, edhe kur Ministria nuk pajtohet me rezultatin e propozuar.

Njëkohësisht, ekzistenca e përgjigjeve të Komunës nuk e provon vetvetiu se çdo kërkesë e Ministrisë është përmbushur në mënyrën e kërkuar. Për këtë arsye, dokumenti i trajtimit të komenteve dhe Vlerësimi 2 duhet të mbeten pjesë e dosjes që shqyrton Kuvendi.